




Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



“DETI” I KORRUPSIONIT NË KOSOVË:
“Peshqit” e vegjël kapen, të mëdhenjtë lihen të lirë
(Raport vjetor i monitorimit të trajtimit të rasteve të
korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë - 2016)

Prishtinë, mars 2017

Autorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Juristë dhe monitorues: Adem Krasniqi, Valdet Hajdini, Arbelina Dedushaj, Diana Berisha, Lutfi Morina, Verona Kadriu, Syzana Rexhepi, Gzim Shala, Belkize Loshaj, Fjolla Gaxha, Erestina Buja, Gëzim Hasani

Monitoruese: Hyrije Mehmeti, Bukurezë Surdulli, Besa Maliqi

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD
Rr. Rrustem Statovci
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

përkrahur nga:



British Embassy
Pristina

Mars 2017
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2.	METODOLOGJIA	7
3.	MONITORIMI I ZBATIMIT TË POLITIKAVE TË SISTEMIT PROKURORIAL DHE GJYQËSOR NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT	10
	a) Monitorimi i zbatimit të politikave të Këshillit Prokurorial të Kosovës në luftimin e korrupsionit	10
	b) Monitorimi i zbatimit të politikave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në luftimin e korrupsionit	13
	c) Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor dhe prokurorial	15
4.	RASTET E HETIMEVE TË KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL GJATË VITIT 2016	16
5.	HETIMET PRELIMINARE NË RASTET E KORRUPSIONIT GJATË VITIT 2016	19
6.	PROFILI I TË AKUZUARVE PËR KORRUPSION.....	25
7.	PRAKTIKA E TRAJTIMIT TË LËNDËVE TË KORRUPSIONIT: Analizë ligjore e rasteve të veçanta.	27
8.	ANALIZË KRAHASUESE E TRAJTIMIT TË RASTEVE TË KORRUPSIONIT MES VITIT 2014, 2015 DHE 2016	83
9.	LLOGARIDHËNIA E PROKURORËVE	85
	a) Hetimet disiplinore pas gjetjeve të raporteve të IKD-së.....	85
10.	MONITORIMI I PROCESVE GJYQËSORE NË RASTET E KORRUPSIONIT NGA IKD	88
	a) Analiza e rasteve të monitoruara gjatë vitit 2016	89
	b) Vonesat e prokurorive në procedimin e aktakuzave në gjykata	92
	c) Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore	94
	d) Kohëzgjatja e rasteve të korrupsionit deri në shpalljen e aktgjykimit në 181 raste të monitoruara nga IKD.....	101
	e) Monitorimi i rasteve të korrupsionit të kthyer në rigjykim	106
	a) Profili i personave të gjykuar në rastet e korrupsionit të monitoruar nga IKD gjatë vitit 2016.....	108
11.	POLITIKA E DËNIMEVE NË RASTET E KORRUPSIONIT	112
	a) Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit gjatë vitit 2016.....	112
	b) Analizë krahasuese e politikës së dënimeve në rastet e korrupsionit 2014, 2015, 2016	116
12.	KONFISKIMI I PASURIVE TË FITUARA PËRMES VEPRAVE PENALE TË KORRUPSIONIT ...	120
13.	PËRZGJEDHJA E SHËNJESTRAVE TË TOP RASTEVE.....	124
14.	ANEX: DËSHTIMET KONKRETE TË PROKURORËVE NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË KORRUPSIONIT - GJASHTË MUJORI I DYTË 2016	126
15.	REKOMANDIMET.....	177

SHKURTESAT:

AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AKP	Agjencioni Kosovar i Pronës
Doganat	Dogana e Kosovës
EULEX	Misioni i Sundimit të Ligjit
BE	Bashkimi Evropian
GJTh	Gjykatë Themelore
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
IKP	Inspektorati Policor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KKLKE	Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
MD	Ministria e Drejtësisë
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PTTh	Prokurori Themelore
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PA	Prokuroria e Apelit
PK	Policia e Kosovës
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
PP	Lëndë të Prokurorisë me kallëzime penale
PPN	Lëndë të Prokurorisë në fazën e grumbullimit të informatave
UA	Udhëzime Administrative
ZPD	Zyra e Prokurorit Disiplinor
ZKPSH	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përkundër politikave të miratuara dhe shprehjes së vullnetit deklarativ nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial në luftimin e korrupsionit, rezultatet konkrete në luftimin e tij, veçanërisht të korrupsionit të profilit të lartë ende mungojnë.

Viti 2016 ka vazhduar me spektakle, luftë komunikatash dhe statistikash kundër korrupsionit. Prokurori i Shtetit gjatë këtij viti, mbi 60% të rasteve të korrupsionit i ka hudhur kallëzimet penale apo i ka pushuar hetimet.

IKD gjatë vitit të kaluar ka monitoruar 1505 seanca gjyqësore në 383 raste të korrupsionit ku kanë qenë përfshirë 989 persona të pandehur, në të gjitha Gjykatat Themelore në Kosovë.

Të gjeturat e IKD-së përputhen me konstatimet e dala nga Raporti i Progresit për vitin 2016, se ka rritje të numrit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë që hetohen dhe ndiqen penalisht, por që mungojnë rezultatet përfundimtare. Edhe Departamenti i Shtetit Amerikan në Raportin për Kosovën ka konstatuar se korrupsioni endemik qeveritar është i ndërlidhur me mungesën e dënimeve në rastet e korrupsionit.

Numri më i madh i aktakuzave lidhen me vepra penale të korrupsionit të nivelit të ultë, në ato raste kur i takojnë nivelit të lartë, mungojnë aktgjykimet dënuese. Në mbi 60 % të rasteve të korrupsionit, aktakuzat dështojnë në gjykata, duke mos u provuar dhe mbrojtur nga prokurorët.

Analiza statistikore tregon se në krahasim me fillim, në fund të vitit 2016 prokuroritë e kanë ulur numrin e rasteve të pazgjidhura të korrupsionit. Më 1 janar 2016 prokuroritë kanë pasur 538 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 1640 persona. Gjatë vitit 2016 janë pranuar 409 raste me 748 persona, ndërsa janë zgjidhur 409 raste me 1037 persona. Më 31 dhjetor 2016 kanë mbetur 462 raste të pazgjidhura me 1227 persona. Shqetësuese mbetet fakti se 62.87% të rasteve të zgjidhura janë mbyllur.

Përpjekjet për luftën kundër korrupsionit përmes aktakuzave, më tepër po dëshmojnë si arsyesim para publikut dhe faktorit ndërkombëtar se korrupsioni në Kosovë po luftohet. Hulumtimi i IKD-së ka gjetur se në shumë raste të profilit të lartë, prokuroria ka ngritur aktakuza të cilat janë hudhur apo refuzuar nga gjykata në raste të caktuara qysh në seancën e shqyrtimit të parë apo edhe në faza të mëvonshme të procedurës gjyqësore, si rastet kundër Enver Hasanit, Lutfi Hazirit, Agim Bahtirit, Shpresa Bakisë, etj.

Në rastet kur nuk ka luftim të korrupsionit, atëherë ka promovim. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, prokurorëve të identifikuar si shkelës të ligjit ka vazhduar t'iu ndajë mirënjohje për merita në promovimin e sistemit prokurorial.

Kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepra penale të korrupsionit pothuajse nuk ka fare në praktikë, edhe atëherë kur konstatohet se përmes veprimeve korruptive janë shkaktuar dëme me dhjetëra miliona euro. Kjo qasje vërehet njëjtë si te prokurorët vendor dhe ata të EULEX-it.

Të gjeturat e IKD-së janë alarmante sa i përket shkeljes së afateve dhe procedurave ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit në prokurori dhe gjykata. Shkelja e afateve ligjore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale lidhur me trajtimin e rasteve penale në fazën e hetimeve, ndjekjes penale dhe shqyrtimit gjyqësor, vërehen pothuajse në çdo rast të korrupsionit, pa dallim si nga prokurorët dhe gjykatësit vendorë ashtu edhe të EULEX-it. Gjetjet e monitorimit të IKD-së tregojnë se nga 383 rastet e monitoruara vetëm në tri raste kur është ngritur aktakuza për vepra penale të korrupsionit, gjykatësit kanë respektuar afatet e procedurës penale. Kjo përbën një shqetësim serioz për të drejtat e të pandehurve në procedurë penale dhe rrjedhimisht kjo ndikon drejtpërdrejtë në humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Edhe katër vite pas hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurës Penale, prokurorët dhe gjykatësit vendorë dhe ndërkombëtarë nuk po adoptohen me rolin dhe përgjegjësitë e reja sipas ndryshimeve të inkuorporuara në Kode. Gjykata të caktuara, tanimë e kanë shndërruar në praktikë tejkalimin e shqyrtimit të dytë, duke kaluar prej shqyrtimit fillestar drejt në shqyrtim kryesor. Afatet ligjore, lidhur me caktimin e shqyrtimit fillestar në afat prej tridhjetë ditëve nga dita kur është ngritur aktakuza zbatohen shumë rrallë. Praktika e shkeljes së afatit ligjor për caktimin e shqyrtimit fillestar, është evidente pothuajse në shumicën e rasteve që trajtohen nga gjykatësit e EULEX-it.

Rasti Ukë Rugova, Astrit Haraçija dhe të tjerët është ende në fazën e shqyrtimit fillestar, edhe 10 muaj pas ngritjes së aktakuzës. Në rastin kundër Naser Osmanit, deputet në Kuvendin e Kosovës, aktakuza është ngritur më 16 shkurt 2016, ndërsa ky rast ende nuk e ka kaluar as shqyrtimin e dytë edhe një vit pas ngritjes së aktakuzës.

Gjykatat në fillim të vitit 2016 kanë pasur 407 lëndë të pazgjidhura të korrupsionit me 956 persona të përfshirë. Gjatë këtij viti gjykatësit kanë pranuar në punë 232 lëndë të reja me 502 persona, që rezulton se gjykatata gjatë vitit 2016 kanë pasur në punë 639 lëndë të korrupsionit me 1458 persona. Gjatë vitit 2016 gjykatat kanë zgjidhur 284 lëndë 594 persona, ndërsa më 31 dhjetor 2016 kanë mbetur 355 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 864 persona. Gjetjet e monitorimit dëshmojnë se politika e dënimeve në rastet e korrupsionit është e ulët dhe nuk po e arrin qëllimin e dënimit.

Mekanizmat e themeluar nga dy këshillat për të monitoruar zbatimin e planeve nuk i kanë marr seriozisht këto plane dhe obligimet e tyre. Këta mekanizma nuk i kanë përmbushur obligimet për të raportuar para Këshillave në baza periodike. Vlen të theksohet raporti i Komisionit Mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit të miratuar në KPK, i cili është publik.

KGJK dhe KPK në vazhdimësi proklamojnë ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në raport me publikun dhe mediat. Të dy Këshillat gjatë vitit 2016, kanë dëshmuar se transparenca dhe llogaridhënia mbetet politikë e proklamuar vetëm në letër. Përderisa, gjykatat kanë shënuar progres në këtë drejtim, prokuroritë janë mbyllur si asnjëherë më parë. Në gjysmën e dytë të vitit 2016, Prokuroritë Themelore dhe PSRK nuk i kanë ofruar aktet prokuroriale (vendimet për hushje të kallëzimit penal dhe vendimet për pushimin e hetimeve) për t'i monitoruar ekspertët juridikë të IKD-së. Kjo dëshmon mungesën e vullnetit për ta rritur transparencën dhe llogaridhënien e prokurorëve. IKD prej vitit 2013 ka siguruar aktet prokuroriale në përputhje me ligjin. Si rezultat i gjetjeve të IKD-së, Zyra e Prokurorit Disiplinor ka trajtuar mbi 400 raste të hetimeve preliminare për shkelje të ligjit nga prokurorët.

Nga 195 kërkesat për qasje në dokumente publike, sistemit gjyqësor i janë drejtuar 84 kërkesa, prej të cilave IKD ka pranuar 48 përgjigje pozitive, në 36 kërkesa nuk ka përgjigje. Në kuadër të sistemit gjyqësor, vlen të përmendet gatishmëria dhe efikasiteti i Gjykatave Themelore, sidomos GjTh në Prishtinë në trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike në pajtim me afatet dhe obligimet ligjore.

Nga 195 kërkesa për qasje në dokumente publike, sistemit prokurorial i janë adresuar 111 kërkesa, prej të cilave sistemi prokurorial iu është përgjigjur pozitivisht 46 kërkesave, në 63 kërkesa nuk kanë kthyer përgjigje, kurse në 2 kërkesa kanë refuzuar të japin të dhënat e kërkuara.

2. METODOLOGJIA

IKD me qëllim që të përpiloj një raport sa më gjithëpërfshirëse dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit. Kjo për shkak se sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor ende përballen me probleme në unifikimin e të dhënave. Prandaj, hulumtimi trajtimit të rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor bazohet në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve të korrupsionit me prioritet.

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikator të qartë për matjen e progresit në zbatimin e tyre nga sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor. Hulumtimi përfshinë monitorimin e rasteve të korrupsionit në shtatë Prokuroritë Themelore, Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, shtatë Gjykatat Themelore dhe Degët e tyre. Në fokus të monitorimit kanë qenë edhe aktivitetet e Komisioneve Mbikëqyrëse të Këshillave për lëndët e korrupsionit, Prokurori të Shtetit, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës në zbatimin e politikave dhe planeve të veprimit. IKD gjithashtu ka siguruar të dhënat statistikore nga Njësi për

Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive dhe Departamenti i Statistikës në Këshillin Gjyqësor si dhe ka mbledhë të dhënat individualisht përgjatë procesit të monitorimit nëpër të gjitha prokuroritë dhe gjykatat.

Raportet e siguruara nga IKD janë përmbledhë në një bazë të të dhënave, e cila ka përfshirë të gjitha rastet e korrupsionit dhe personat e përfshirë në këto raste në të gjitha fazat e procedurës penale në sistemin prokurorial dhe sistemin gjyqësor.

Baza e të dhënave është shfrytëzuar për të evidentuar çështjet më shqetësuese që ndërlidhen me zbatimin e obligimeve ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit, përkatësisht lidhur me zgjidhjen, mënyrën e zgjidhjes dhe moszgjidhjen e rasteve të korrupsionit nga prokurorët dhe gjykatësit. Përmes statistikave, IKD ka analizuar disa aspekte të cilat janë paraqitur dhe komentuar përmes tabelave dhe grafikave, duke përfshirë të gjitha specifikat e rasteve të korrupsionit për secilën prokurori dhe gjykatë, për secilin parashtrues të rastit të korrupsionit, për vjetërsinë e rasteve të denoncuara për korrupsion dhe për mënyrën e zgjidhjes së rasteve.

IKD ka vazhduar të monitoroj aktet prokuroriale rreth vendimeve për hudhje të kallëzimeve penale dhe vendimeve për pushim të hetimeve. Të njëjtat janë analizuar karshi obligimeve ligjore dhe është bërë identifikimi i shkeljeve ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit në procedurën penale, përfshi identifikimin e rasteve të parashkruara. Vlen të theksohet se për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2016 (1 qershor – 31 dhjetor 2016) aktet prokuroriale nuk i kanë ofruar shumica e prokurorive me përjashtim të PTh në Mitrovicë, PTh në Prizren dhe PTh në Pejë, të cilat i kanë ofruar aktet e kërkuara për periudhën tre mujore korrik, gusht, shtator 2016. IKD ka ndërtuar një praktikë të bashkëpunimit prej vitit 2013 me të gjitha Prokuroritë, të cilat i kanë ofruar aktet prokuroriale (vendimet për hudhjet e kallëzimeve penale dhe vendimet për pushimin e hetimeve, të cilat vazhdimisht janë kërkuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Refuzimi për të ofruar këto akte prokuroriale, prej të cilave një numër i rasteve të shkeljes së prokurorëve janë dërguar në Komision Disiplinor, dëshmon përpjeket maksimale të këtyre prokurorive, që t'i shmanget monitorimit, transparencës dhe llogaridhënies publike rreth trajtimit të rasteve të korrupsionit. IKD të drejtat e garantuara përmes legjislacionit të aplikueshëm për sigurimin e akteve juridike prokuroriale do t'i përmes rrugëve ligjore.

Hulumtuesit e IKD-së, prej 1 janarit deri më 30 dhjetor 2016 kanë monitoruar 1505 seanca gjyqësore, ku përfshihen 383 raste të korrupsionit me 989 persona. IKD tashmë ka krijuar indikatorë të qartë për të bërë matje të sakta të kohëzgjatjes së rasteve të

korrupsionit nëpër të gjitha fazat e procedurës penale, duke përfshi prej ngritjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit në shkallë të parë nga gjykatat. Analiza përfshin të gjitha trendet e trajtimit të këtyre rasteve dhe kohëzgjatjen e procedurave në këto raste të korrupsionit.

Aspekt i rëndësishëm i monitorimit ka qenë performanca e mekanizmave të llogaridhënies për prokurorët dhe gjykatësit, të cilët për shkak të performancës së tyre në rastet e korrupsionit janë bërë subjekt i procedurave disiplinore.

IKD ka monitoruar vazhdimisht aktivitetet e Komisioneve Mbikëqyrëse për lëndët e korrupsionit të KPK-së dhe KGJK-së, Prokurorive Themelore, Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Gjykatave Themelore, Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Me të gjithë bartësit e funksioneve prokuroriale dhe gjyqësore, gjatë gjithë vitit IKD ka zhvilluar intervista të thella, të bazuara në indikatorët e përcaktuar në përputhje me obligimet ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit. Intervistat e zhvilluara janë kodifikuar ashtu që çështjet dhe informatat e dala nga to janë përfshirë në raport. Përgjatë këtu bëjnë Kryeprokurori i PSRK-së, Reshat Millaku dhe Kryeprokurori i PTh në Gjilan, Jetish Maloku, të cilët përkundër kërkesave të vazhdueshme me shkrim për të zhvilluar intervista rreth trajtimit të rasteve të korrupsionit, të njëjtit nuk janë përgjigjur.

Poashtu, për të qenë sa më të saktë në identifikimin e problemeve si dhe propozimin e rekomandimeve për zgjidhje të problemeve në luftimin e korrupsionit, përkatësisht në zbatimin sa më efikas dhe efektiv të obligimeve ligjore dhe obligimeve të planeve të veprimit, IKD ka analizuar bazën ligjore, si dhe analizuar në detaje dokumente relevante vendore dhe ndërkombëtare, të cilat ndërlidhen me luftën kundër korrupsionit në Kosovë.

3. MONITORIMI I ZBATIMIT TË POLITIKAVE TË SISTEMIT PROKURORIAL DHE GJYQËSOR NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT

IKD vazhdimisht ka vlerësuar si pozitive politikat formale të sistemit prokurorial dhe sistemit gjyqësor në luftimin e korrupsionit, me përjashtim të rasteve të caktuara kur janë hartuar në kundërshtim me ligjin.¹ Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)² dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)³ kanë miratuar Planet e Veprimit për të trajtuar me prioritet absolut lëndët e korrupsionit. Problem shqetësues vazhdon të mbetet moszbatimi i këtyre politikave në praktikë. Pavarësisht disa lëvizjeve pozitive, rezultatet konkrete në luftimin e korrupsionit vazhdojnë të mungojnë. Korrupsioni në Kosovë vazhdohet të vlerësohet si endemik.⁴

a) Monitorimi i zbatimit të politikave të Këshillit Prokurorial të Kosovës në luftimin e korrupsionit

KPK më 1 dhjetor 2015, ka miratuar Planin Strategjik (2016-2018) dhe Planin e Veprimit për Ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme (në vazhdim: *Plani i Veprimit*). Ky Plan Strategjik ka përcaktuar disa qëllime si: zvoglimi i lëndëve të pazgjidhura, rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja, rritjen e nivelit të bashkëpunimit me institucione, rritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve të specializuara, llogaridhënien dhe transparencën.⁵ Ky plan vazhdon të mos jetë i qasshëm për publikun, për dallim prej planit të kaluar, i cili gjendej në uebfaqe.⁶

¹ *Shënim:* IKD ka reaguuar ndaj disa dispozitave të kundërligjshme të Planit Strategjik (2016-2018) dhe Planit të Veprimit për Ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme të miratuar nga KPK më 1 dhjetor 2015. Këshilli Prokurorial i Kosovës. 1 dhjetor 2015.

² *Shënim:* KPK më 1 dhjetor 2015, ka miratuar Planin Strategjik (2016-2018) dhe Planin e Veprimit për Ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme. Këshilli Prokurorial i Kosovës. 1 dhjetor 2015.

³ *Shënim:* Me iniciativë të IKD-së për zbatimin e rekomandimeve të publikuara në raportet analitike që ndërlidhen me trajtimin efikas dhe efektiv të rasteve të korrupsionit nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial, IKD ka mbajtur takime me Kryuesin e KGJK-së, z. Enver Peci, i cili ka shprehur vullnetin për bashkëpunim për hartimin e Planit të Veprimit për Zgjidhjen e Rasteve të Korrupsionit. IKD ka hartuar draftin e këtij Plani, i cili me ndryshimet dhe plotësimet e KGJK-së është miratuar më 25 shtator 2015. "Plani i Veprimit për Zgjidhjen e Rasteve të Korrupsionit". Këshilli Gjyqësor i Kosovës. 25 shtator 2015.

⁴ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2015 dhe Raporti i Departamentit të Shtetit Amerikan lidhur me të Drejtat e Njeriut në Kosovë, për vitin 2015.

⁵ Ky Plan Strategjik përmban pothuajse të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Planin e Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit të miratuar më 4 nëntor 2013 nga KPK. KPK për herë të parë ka miratuar Planin e Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit më 4 nëntor 2013.

⁶ IKD ka kërkuar nga KPK dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit qasje në Planin Strategjik të miratuar nga KPK, por ka marrë përgjigje negative lidhur me kërkesën e paraqitur në përputhje me Ligjin mbi Qasjen në Dokumente Publike. Përgjigja e zyrtarit për qasje në dokumente publike i caktuar nga KPK. "Këshilli Prokurorial me datë 1 dhjetor 2015, ka

Sidoqoftë, IKD ka arritur që të sigurojë kopjen e këtij Plani Strategjik dhe Planit të Veprimit.

Dështimi në zbatimin e obligimeve të Planit të Veprimit nga KPK

Gjetjet e IKD-së tregojnë se KPK ka vazhduar me shprehjen e vullnetit të luftimit të korrupsionit përmes politikave, përderisa në praktikë dëshmohet se të njëjtat politika nuk zbatohen. Mekanizmat e themeluar për të përmbushur obligimet apo monitoruar zbatimin e planeve nuk i kanë marr seriozisht këto plane dhe obligimet e tyre. Ende ka probleme serioze në respektimin e Mekanizmit Përcjellës, ku vazhdimisht raportohen të dhënat e rasteve nga prokurorët.⁷ KPK deri më tani nuk ka marr asnjë veprim ndaj askujt për të mbajtur përgjegjës apo llogaridhënës lidhur me dështimet në zbatimin e politikave për luftimin e korrupsionit. Për mos trajtimin efikas dhe efektiv të rasteve të korrupsionit, Kryeprokurorët ankohen në numrin e pamjaftueshëm të prokurorëve dhe faktorëve tjerë objektiv, të cilët sipas tyre, po ndikojnë në moszgjidhjen e këtyre rasteve në kohë.⁸ IKD vlerëson se kjo dëshmon kultivimin e kulturës së pandëshkueshmërisë të instaluar qysh prej Planit të vjetër të Veprimit për trajtimin e rasteve të korrupsionit të miratuar më 4 nëntor 2013.

Zgjidhja e rasteve të korrupsionit sipas afateve të planit të veprimit - Neni 3 i Planit të veprimit ka paraparë që lëndët e pazgjidhur të korrupsionit, krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme të pranuar nga viti 2001 deri 2010, të përfundohen deri më 30 qershor 2016. KPK ka dështuar që këtë obligim ta zbatoj në praktikë. Ky dështim nga Komisioni Mbikëqyrës për zbatimin e Planit Strategjik dhe të Veprimit në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike është raportuar si sukses në KPK. Sipas Komisionit, janë zgjidhur të gjitha lëndët e korrupsionit deri në vitin 2010 me përjashtim të tri lëndëve.⁹ IKD ka gjetur se kjo nuk është e vërtetë për shkak se deri më 31 dhjetor 2016, PSh ka ende në punë 17 raste të

miratuar Planin Strategjik (2016 - 2018) dhe Planin e Veprimit për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme, mirëpo ky plan do të plotësohet me rekomandimet e marra nga anëtarët e Këshillit dhe përfaqësuesit ndërkombëtar që mbështetin punën e Këshillit. Pas plotësimit dhe ndryshimit me këto rekomandime Plani do të publikohet në ueb faqet e Prokurorit të Shtetit dhe të Këshillit Prokurorial”.

⁷ *Shënim:* IKD gjatë monitorimit vazhdimisht ka identifikuar raste të regjistruara me vonesë në Mekanizmin Përcjellës si dhe raste të cilat nuk figurojnë fare në regjistrin e të dhënave në Mekanizmin Përcjellës, edhe pse të njëjtat kanë ekzistuar në regjistrat paraprak.

⁸ IKD intervista me Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Blerim Isufaj dhe me të gjithë Kryeprokurorët e Prokurorive të të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës. 2016, 2017.

⁹ Komisioni Mbikëqyrës gjatë raportimit para KPK-së për raportin e vitit 2016 ka prezantuar vetëm tri raste të pakryera që i takojnë lëndëve të para vitit 2010. Prokurorja Laura Pula, gjatë prezantimit të raportit, ka thënë se prej këtyre tri lëndëve, dy prej tyre nuk janë zgjidhur me arsyetimin se janë pezulluar për shkak të fletëarresteve ndërkombëtare në mungesë të të pandehurve, ndërsa një lëndë është në punë ende në fazën e grumbullimit të informatave. Raporti i Komisionit Mbikëqyrës të KPK-së. 1 shkurt 2017.

pazgjidhura të korrupsionit me 51 persona të përfshirë që i takojnë periudhës nga vitet 2002 deri 2010 dhe jo 3 raste siç është raportuar në KPK. PSRK-së i kanë mbetur 3 raste të pazgjidhura me 7 persona, PTh në Mitrovicë i kanë mbetur 2 raste të pazgjidhura me 4 persona, PTh në Ferizaj i ka mbetur 1 rast i pazgjidhur me 1 person dhe PTh në Prishtinë i kanë mbetur 13 raste të pazgjidhura me 39 persona të para vitit 2010.

Raportimi çdo tre muaj në KPK - Neni 4 i Planit të veprimit kishte paraparë themelimin e Komisionit Mbikëqyrës lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit nga prokuroritë, monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe raportimit në KPK në baza tre mujore. Gjatë vitit 2016, i njëjti Komision ka raportuar vetëm njëherë para KPK-së, më 16 shtator 2016.¹⁰ I njëjti Komision ka qenë i obliguar të raportoj para Këshillit çdo tre muaj lidhur me monitorimin e rasteve të korrupsionit të trajtuara nga Prokuroritë.¹¹ Për herë të dytë ky Komision ka raportuar tek në shkurt 2017.¹² Një qasje e tillë e Komisionit dhe Këshillit dëshmojnë në praktikë mungesën e vullnetit për të përmbushur obligimet e tyre të miratuara nga KPK.

Raportimi për pasuri të sekuestruar dhe konfiskuar për veprat penale kundër korrupsionit - Plani i Veprimit ka përcaktuar se Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike (KKLKE) do të monitoroj rastet që ndërlidhet me krimet ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. KKLKE ka përmbushur obligimet e tij për raportuar para KPK-së lidhur me aktivitetet e tij lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Sidoqoftë, KKLKE ka dështuar të ofroj informacion para KPK-së lidhur me kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar përmes veprave penale kundër korrupsionit. Ende nuk ka informacion nëse nga pasuritë e sekuestruara apo konfiskuara, ka të atillë që i takon veprave penale kundër korrupsionit.

Rishikimi i Planeve dhe harmonizimi i tyre me ligjin - IKD në raportin e publikuar më 27 prill 2016, "Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo Promovimi i korrupsionit", ka gjetur se dispozitat e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit ishin në kundërshtim me ligjet bazike që rregullojnë sistemin prokurorial në Kosovë. IKD i ka rekomanduar KPK-së që

¹⁰ Komisioni Mbikëqyrës për herë të parë ka raportuar para KPK-së gjatë muajit shtator 2016.

¹¹ *Shënim:* IKD i'u është drejtuar me kërkesa për qasje në dokumente publike KPK-së dhe Komisionit Mbikëqyrës lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit, lidhur me aktivitetet e ndërmarra lidhur me rastet e korrupsionit. KPK dhe Komisioni Mbikëqyrës nuk i janë përgjigjur pozitivisht asnjë kërkesë të IKD-së.

¹² *Shënim:* Komisioni Mbikëqyrës lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit i KPK-së, për herë të dytë ka raportuar para anëtarëve të KPK-së më 1 shkurt 2017. Raportimi është bërë nga Kryetarja e këtij Komisioni, znj. Laura Pula. Raporti është bërë publik edhe në uebfaqe. (shih linkun file:///C:/Users/Betimi/Downloads/Raporti%20Vjetor%202016%20Nr.188.2017%20-%20i%20Komisionit%20Mbikëqyrës%20për%20zbatimin%20e%20planit%20strategjik.pdf). (Raportimi i kësaj mbledhje gjithashtu mund të gjendet në portalin betimiperdrejtesi.com në linkun <https://www.youtube.com/watch?v=btvTa4RK20M&feature=youtu.be>)

këto plane të ndryshohen urgjentisht nga KPK për t'i harmonizuar në pajtim me ligjet e aplikueshme dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. IKD ka rekomanduar që kujdes i veçantë duhej kushtuar pavarësisë individuale të prokurorëve dhe Kryeprokurorëve. KPK ka informuar IKD-në se KPK do të bëj ndryshime dhe plotësime të këtyre planeve me rekomandimet e marra nga anëtarët e Këshillit dhe përfaqësuesit ndërkombëtar që mbështetin punën e Këshillit dhe se më pas ato do të publikohen në uebfaqe. KPK ende nuk ka ndërmarr asnjë veprim për të përmirësuar dispozitat e kundërligjshme të këtyre planeve dhe gjithashtu nuk ka bërë publikimin e tyre.

Udhëzimi i kundërligjshëm i Kryeprokurorit të Shtetit për trajtimin e kallëzimeve penale - Kryeprokurori i Shtetit më 29 prill 2016, ka nxjerr Udhëzim me numër A.nr.258/2016, përmes së cilit ka obliguar të gjithë prokurorët e shtetit që brenda afatit prej tre (3) muajve nga dita e pranimit të kallëzimit penal, të nxjerrin Aktvendim për fillim të hetimeve nëse i njëjti kallëzim penal nuk është hudhur.¹³ Ky Udhëzimi ishte nxjerr nga Kryeprokurori nga takimi i kolegjiut të të gjithë Kryeprokurorëve të të gjitha prokurorive të Republikës së Kosovës. Udhëzimi i lartë-përmendur bie në kundërshtim me parimet dhe standardet e përcaktuara me KPPRK. Kjo e fundit, askund nuk e përcakton afatin kohor prej 3 muajve, por e përcakton qartë në nenin 82 afatin tridhjetë (30) ditor për ta trajtuar kallëzimin penal. Ky udhëzim është i kundërligjshëm dhe si i tillë IKD ka rekomanduar të hudhet poshtë.¹⁴

b) Monitorimi i zbatimit të politikave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në luftimin e korrupsionit

KGJK në bashkëpunim me IKD-në, kanë hartuar Planin e Veprimit për KGJK për të trajtuar me prioritet rastet e korrupsionit. Ky plan ishte miratuar më 25 shtator 2015 nga KGJK.¹⁵ Zbatimi i këtij plani vazhdon të sfidohet në praktikë, si rezultat i ngarkesës së gjykatësve me lëndë, por edhe si rezultat i mungesës së vullnetit për t'i trajtuar me prioritet absolut, siç përcaktohet në Planin e Veprimit.

¹³ Udhëzim Nr. 258/2016, i nxjerr nga Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi më 29 prill 2016. (Shih linkun <http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.578.2016-Udhezim-ZKPSH.pdf> (Qasur për herë të fundit me 5 tetor 2016).

¹⁴ Miftaraj E. dhe Musliu B. "RETORIKA NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT: Raport i monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë" (Instituti i Kosovës për Drejtësi: Prishtinë). 27 tetor 2016. Fq. 15, 16 dhe 17.

¹⁵ IKD ka mbështetur KGJK në hartimin e Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Gjyqësor në trajtimin e lëndëve të korrupsionit. IKD kishte hartuar draftin e Planit të Veprimit për KGJK-në, i cili plan me disa plotësime ishte miratuar nga KGJK më 25 shtator 2015.

Dështimi në zbatimin e obligimeve të Planit të Veprimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës

IKD ka monitoruar zbatimin e obligimeve që dalin nga planet e lartë përmendura nga Gjykatat, Komisionet dhe KGJK. Gjetjet tregojnë se KGJK ka vazhduar me shprehjen e vullnetit të luftimit të korrupsionit përmes politikave, përderisa në praktikë dëshmohet se të njëjtat politika nuk zbatohen. IKD vlerëson se mekanizmat e themeluar për të përmbushur obligimet apo monitoruar zbatimin e planeve nuk i kanë marr seriozisht këto plane dhe obligimet e tyre. KGJK deri më tani nuk ka marr asnjë veprim ndaj askujt për të mbajtur përgjegjës apo llogaridhënës lidhur me dështimet në zbatimin e politikave për luftimin e korrupsionit. Për mos trajtimin efikas dhe efektiv të rasteve të korrupsionit, Kryetarët e Gjykatave ankohen në numrin e pamjaftueshëm të gjykatësve dhe faktorëve tjerë objektiv, të cilët sipas tyre, po ndikojnë në moszgjidhjen e këtyre rasteve në kohë.¹⁶

Zgjidhja e rasteve të korrupsionit sipas afateve ligjore – Gjetjet e monitorimit të IKD-së tregojnë se nga 383 rastet e monitoruara vetëm në tri¹⁷ raste kur është ngritur aktakuza për vepra penale të korrupsionit, gjykatësit kanë respektuar afatet e procedurës penale, ndërsa në të gjitha rastet e tjera afatet ligjore janë shkelur nga gjykatësit. Kjo përbën një shqetësim serioz për të drejtat e të pandehurve në procedurë penale dhe rrjedhimisht kjo ndikon drejtpërdrejtë në humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Raportimi sipas afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit - Përmes Planit të Veprimit, KGJK ka përcaktuar aktivitete konkrete dhe afate kohore praktike për rritjen e aktivitetit të trajtimit të lëndëve të korrupsionit. Afatet e parapara gjatë vitit 2015 dhe 2016 nuk janë respektuar nga Komisioni dhe KGJK. Raportet e Komisionit Mbikëqyrës edhe pse janë dërguar çdo tre muaj në KGJK, për të njëjtat gjatë vitit 2016, Komisioni ka raportuar vetëm njëherë para KGJK-së më 6 prill 2016¹⁸.

¹⁶ IKD intervista me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Nehat Idrizi dhe me të gjithë Kryetarët e Gjykatave të të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës. 2016, 2017.

¹⁷ *Shënim:* I vetmi rast i monitoruar nga IKD, në të cilin gjykatësit kanë respektuar afatet e përcaktuara në KPPRK është rasti ndaj të akuzuarit Hajdar Mejzini, i akuzuar për veprën penale të “përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës” nga PTh në Mitrovicë. Në këtë rast kallëzimi penal është parashtruar më 19.06.2015 nga ShPK “Union”, hetimet kanë filluar më 23.06.2016, aktakuza është ngritur më 26.08.2016, shqyrtimi fillestar është mbajtur më 26.09.2016, shqyrtim të dytë gjykata nuk ka mbajtur, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më 05.12.2016 është shpallur edhe aktgjykimi. Gjykata Themelore në Mitrovicë.

<http://betimiperdrejtesi.com/agenti-tregtar-i-akuzuar-per-pervetesim-te-4-950-eurove-nuk-e-pranon-fajesine/>
<http://betimiperdrejtesi.com/4-muaj-burgim-efektiv-ndaj-te-akuzuarit-per-pervetesim-gjate-ushtrimit-te-detyres-zyrtare-denimi-konvertohet-ne-denim-me-gjobe/>

¹⁸ Intervistë me z. Agim Maliqi, Kryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Lëndëve të Korrupsionit në Gjykata. Mars 2017.

c) Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor dhe prokurorial

KGJK dhe KPK në vazhdimësi proklamojnë ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në raport me publikun dhe mediat. Të dy Këshillat kanë miratuar rregullore dhe strategji për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien dhe për të lehtësuar bashkëpunimin me publikun dhe median.

IKD gjatë monitorimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial gjatë vitit 2016, ka adresuar 195 kërkesa për qasje në dokumente publike, lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore, ofrimit të informacioneve, statistikave dhe të dhënave tjera të disponueshme dhe lejueshme sipas Ligjit mbi Qasje në Dokumente Publike.

Nga 195 kërkesat për qasje në dokumente publike, sistemit gjyqësor i janë drejtuar 84 kërkesa, prej të cilave IKD ka pranuar 48 përgjigje pozitive apo në përqindje del të jetë 57%, ndërsa në 36 kërkesa nuk ka pranuar përgjigje, apo në 43%. Në kuadër të sistemit gjyqësor, vlen të përmendet gatishmëria dhe efikasiteti i Gjykatave Themelore, sidomos GjTh në Prishtinë në trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike në pajtim me afatet dhe obligimet ligjore.

Nga 195 kërkesa për qasje në dokumente publike, sistemit prokurorial i janë adresuar 111 kërkesa, prej të cilave sistemi prokurorial iu është përgjigjur pozitivisht 46 kërkesave apo në përqindje del të jetë 41%, në 63 kërkesa nuk kanë kthyer përgjigje, apo në 57%, kurse në 2 kërkesa kanë refuzuar të japin të dhënat e kërkuara, apo në 2%.

Mos zbatimi i obligimeve ligjore dhe politikave të miratuar nga të dy Këshillat, forcon të gjeturat e IKD-së dhe vlerësimet e dala nga raporte ndërkombëtare dhe vendore lidhur me mungesën e vullnetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial për të qenë transparent dhe llogaridhënës para publikut. Mos përmbushja e obligimeve dëshmon se ligji në Kosovë nuk zbatohet njëjtë ndaj të gjithëve. Në rastet kur zyrtarët e lartë nuk përmbushin obligimet dhe përgjegjësitë e tyre, kultura pandëshkueshmërisë vazhdon të kultivohet.

4. RASTET E HETIMEVE TË KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL GJATË VITIT 2016

Prokurori i Shtetit (PSh), në fillim të vitit 2016, ka pasur në punë 538 lëndë me 1640 persona subjekt të procedurave penale të korrupsionit, të pazgjidhura na vitet paraprake, ku numri më i madh i rasteve dhe personave ishte në Prokurorinë Themelore në Prishtinë me 336 raste dhe 1018 persona.

RASTET E KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL NË PERIUDHËN RAPORTUESE (01.07.2016 - 30.09.2016)												
Prokurori i Shtetit												
Prokurori i Shtetit	Të pazgjidhura në fillim (01.01.2016)		Të pranuar (01.01.2016 deri më 31.12.2016)		Të zgjidhura (01.01.2016 deri më 31.12.2016)		Mënyra e zgjidhjes				Të pazgjidhur a në fund (31.12.2016)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Hudhje	Pushim	Aktakuzë	Mënyrë tjetër	Raste	Persona
PSRK	43	263	10	30	25	156	10	50	96		40	162
Prishtinë	336	1,018	153	291	167	470	264	81	125		230	673
Prizren	23	64	35	53	33	62	9	22	31		24	51
Pejë	22	45	58	98	55	103	39	32	32		26	48
Gjilan	10	17	89	172	70	135	64	19	52		25	53
Mitrovicë	71	163	30	48	25	61	20	11	29	1	80	156
Ferizaj	19	40	17	30	20	28	10	3	15		17	47
Gjakovë	14	30	17	26	14	22	9	9	4		20	37
Total:	538	1,640	409	748	409	1,037	425	227	384		462	1,227


Tabela numër 1 - Rastet e korrupsionit në sistemin prokurorial

PSh gjatë vitit 2016, ka pranuar 409 lëndë të reja të korrupsionit me 748 persona. Përderisa, në të njëjtën periudhë kohore prokurorët kanë zgjidhur 409 raste të korrupsionit me 1037 persona. Në rastet ndaj 1037 personave, ndaj 425 personave janë hudhur kallëzimet penale, ndaj 227 personave janë pushuar hetimet dhe ndaj 384 personave janë ngritur aktakuza për vepra penale të korrupsionit. Në fund të vitit 2016, në PSh kanë mbetur 462 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 1227 persona. Për herë të parë vërehet se është ulur numri i rasteve të pazgjidhura dhe numri i personave të përfshirë në këto raste. Numri më i madh i lëndëve të pazgjidhura vazhdon të jetë në PTh në Prishtinë me 230 lëndë dhe 673 persona, pasuar nga PTh në Mitrovicë, me 80 lëndë me 156 persona dhe PSRK me 40 lëndë me 162 persona. IKD vlerëson se ky trend

i rritjes së zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, iu atribuohet rasteve të vjetra, të cilat në masë të madhe deri në vitin 2010 janë zgjidhur dhe ku në një pjesë të madhe të tyre ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale. Në këto raste të parashkrimit, prokurorët kanë pasur punë të lehtë për arsye se është dashur vetëm të konstatojnë dhe të nxjerrin një vendim për parashkrim të veprave penale. Gjithashtu, përgjatë viteve 2015 dhe 2016 numri i prokurorëve është rritur në sistemin prokurorial dhe poashtu në kuadër të PTh në Prishtinë janë krijuar Njësiti të veçanta, të cilat janë marrë ekskluzivisht me këto lëndë.¹⁹

IKD²⁰ si rezultat i monitorimit të punës së PSh në trajtimin e rasteve të korrupsionit ka gjetur se edhe përkundër miratimit të politikave nga KPK lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit nëpër prokurori, PSRK dhe PTh në Prishtinë vazhdojnë të përballen me numër të madh të lëndëve të korrupsionit dhe vonesave në trajtimin e këtyre lëndëve.

Shqetësuese vazhdon të mbetet mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit. Mbi 60 % e rasteve të korrupsionit janë mbyllur nga prokurorët. Shih grafikonin më poshtë.



Grafika 1 - Krahasimi i rasteve të mbyllura dhe ngritjes së aktakuzave

¹⁹ Shënim: Sistemi prokurorial vazhdimisht ka shënuar rritje të numrit të prokurorëve. Gjatë vitit 2014, sistemi prokurorial ka pasur në punë 139 prokurorë, në vitin 2015 ka pasur në punë 149, ndërsa në vitin 2016 i janë shtuar edhe 25 prokurorë të rinj, ndërkohë që ka pasur dorëheqje të një prokurori dhe disa prokurorë të pensionuar, por gjatë vitit 2016 kanë qenë rreth 170 prokurorë.

²⁰ Shënim: Instituti i Kosovës për Drejtësi përmes 12 monitoruesve në teren në mënyrë sistematike monitoron të gjitha rastet e korrupsionit në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës. Për çdo rast të monitoruar të korrupsionit raportohet në kohe reale në www.betimiperdrejtesi.com

Sipas grafikonit të lartë-përmendur, ndaj 1037 personave që janë zgjidhur lëndët, rezulton se ndaj 652 personave ose 62.87 % janë mbyllur rastet e korrupsionit, përkatësisht janë hudhur kallëzimet penale apo janë pushuar hetimet penale, ndërsa ndaj 384 personave apo 37.13% janë ngritur aktakuza.

Grumbullimi i lëndëve të pazgjidhura të korrupsionit nëpër prokurori

Sistemi prokurorial ka shëndërruar në praktikë moszbatimin dhe shkeljen e politikave dhe vendimeve të miratuara nga KPK. IKD gjen se vullneti i sistemit prokurorial në trajtimin e lëndëve të korrupsionit vazhdon të mbetet në hartim të politikave, të cilat nuk po zbatohen në praktikë. KPK ka hartuar Plan Veprimi, Plan Strategjik, ka themeluar Komisionin për Mbikëqyrje të zbatimit të Planit të Veprimit, ka themeluar Njësitet brenda Departamenteve të PTh në Prishtinë për luftimin e korrupsionit. Zbatimi i obligimeve në praktikë, vazhdon të mbetet i mangët.

Kjo dëshmohet me faktin se ende në sistemin prokurorial ka lëndë të pazgjidhura të korrupsionit që datojnë qysh nga viti 2002, respektivisht lëndë të vjetra dhe të pazgjidhura për 15 vite. PSh ka ende në punë 17 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 51 persona të përfshirë që i takojnë periudhës nga vitet 2002 deri 2010. PSRK-së i kanë mbetur 3 raste të pazgjidhura me 7 persona, PTh në Mitrovicë i kanë mbetur 2 raste të pazgjidhura me 4 persona, PTh në Ferizaj i ka mbetur 1 rast i pazgjidhur me 1 person dhe PTh në Prishtinë i kanë mbetur 13 raste të pazgjidhura me 39 persona të para vitit 2010.

Rastet e pazgjidhura me persona sipas prokurorive - PP (31.12.2016)	2002		2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014		2015		2016		Total	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
	PSRK							3	7	2	10	1	20	3	17	7	27	12	41	12	40	40
Prishtinë	1	2	5	25	2	2	4	10	7	66	8	23	15	58	49	133	53	188	86	166	230	673
Prizren																	7	26	17	25	24	51
Pejë														3	4	5	14	18	30	26		48
Gjilan														1	1				24	52	25	53
Mitrovicë					1	2	1	2	1	1	4	6	4	8	16	37	25	48	28	52	80	156
Ferizaj							1	1					1	4	1	1	5	20	9	21	17	47
Gjakovë													4	12			2	3	14	22	20	37
TOTALI	1	2	5	25	3	4	9	20	10	77	13	49	27	99	77	203	109	340	208	408	462	1,227

Tabela numër 2 – Rastet e pazgjidhura të korrupsionit më 31.12.2016

Grumbullimi i lëndëve të pazgjidhura të korrupsionit sipas parashtruesve të rasteve

PSh me 31 dhjetor 2016, ka përfunduar me 462 raste të korrupsionit të pazgjidhura me 1227 persona subjekt të procedurave penale të korrupsionit. Parashtruesi më i madh i kallëzimeve penale në PSh mbetet Policia e Kosovës, e cila ka ngritur kallëzime penale ndaj 450 personave apo me 36.67 %, pasuar nga Agjencia Kundër Korrupsion me kallëzime penale të ngritura ndaj 185 personave apo 15%. Karakteristikë për vitet 2015 dhe 2016, paraqet numri i rasteve të korrupsionit të raportuara nga qytetarët dhe të dëmtuarit e veprave penale të korrupsionit. Këto dy kategori kanë parashtruar kallëzime penale ndaj 302 personave të dyshuar për korrupsion, respektivisht 24.61%. Lëndët e korrupsionit të inicuar me vet-iniciativë nga prokurorët, në fund të vitit 2016 kanë mbetur të pazgjidhura 55 personave apo 4.4%.

PP - Parashtruesit në fund të periudhës raportuese (31.12.2016)	2002	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Total
AKK		16			7	28	36	35	25	38	185
ATK				2			1	7	1	4	15
Doganat							9	1	11		21
EULEX				2	6	1			1		10
IPK						2	1	5	29	15	52
PK	2	8	3	13	6	10	25	110	95	178	450
Qytetari				3	15		14	8	34	65	139
I dëmtuari			1		2		13	20	77	50	163
Titullari i pronës-OP		1				8		4	1	4	18
Prokurori me vetiniciat.					40			4		11	55
Pranuar në kompetencë								8	66	42	116
Administrata Komunale								1		1	2
Paidentifikuar					1						1
Totali	2	25	4	20	77	49	99	203	340	408	1,227

Tabela numër 3 – Rastet e pazgjidhura të korrupsionit sipas parashtruesve

5. HETIMET PRELIMINARE NË RASTET E KORRUPSIONIT GJATË VITIT 2016

PSh në fillim të vitit 2016, ka pasur 398 lëndë të pazgjidhura të korrupsionit të kategorizuara në regjistrin PPN²¹, ku përfshihen 850 persona. Përderisa gjatë vitit 2016, PSh ka pranuar lëndë të reja nga kjo kategori ndaj 557 personave. Kurse gjatë vitit 2016, PSh ka zgjidhur lëndët e korrupsionit nga kjo kategori ndaj 396 personave, që rezultojnë

²¹ Regjistri PPN përfshin informatat e regjistruara në Prokurori lidhur me dyshimin për kryerjen e veprave penale.

se PSh gjatë vitit 2016, ka zgjidhur numër më të vogël të personave subjekt të procedurave penale të korrupsionit në raport me numrin e pranuar. Nëse krahasohet numri i personave të pranuar dhe të zgjidhur gjatë vitit 2016, në përqindje del se PSh ka qenë efikas 71% në trajtimin e rasteve të regjistrit PPN.

Përderisa, numri i personave subjekt të veprave penale të korrupsionit nga kjo kategori në fund të vitit 2015 ka qenë 850 persona, ky numër në fund të vitit 2016, është rritur në 1221.

Nga 1 janari 2016 deri më 31 dhjetor 2016, sipas tabelës më poshtë, rezulton se PTh-të dhe PSRK kanë pranuar gjithsej 384 lëndë të kategorizuara në regjistrin PPN, me 557 persona të përfshirë. Numri më i madh i këtyre lëndëve janë pranuar në PTh në Prishtinë, gjithsej 217 raste me 311 persona të përfshirë, kurse PSRK me 21 raste me 50 persona të përfshirë.

RASTET PPN TË KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL (01.01.2016 - 31.12.2016)									
PROKURORI SHTETIT PPN	Prokurori i Shtetit								
	Të pazgjidhura në fillim (01.01.2016)		Të pranuar (01.01.2016 deri më 31.12.2016)		Rastet e zgjidhura me persona (01.01.2016 deri më 31.12.2016)	Mënyra e zgjidhjes		Të pazgjidhura në fund (31.12.2016)	
	Raste	Persona	Raste	Persona		Persona	Hudhje	Mënyrë tjetër	Raste
					Persona		Persona		
PSRK	53	158	21	50	63	63		57	140
Prishtinë	168	391	217	311	181	175	6	397	698
Prizren	25	47	42	50	56	35	21	43	64
Pejë	39	79	45	63	36	36		70	111
Gjilan	11	18	2	2	18	18		4	4
Mitrovicë	45	66	7	8	2	2		54	77
Ferizaj	43	73	35	54	27	27		57	98
Gjakovë	14	16	15	19	13	13		22	29
Total:	398	850	384	557	396	369	27	704	1221

Tabela numër 4²² - Rastet e korrupsionit në fazën e grumbullimit të informatave

²² Shënim: Informatat nga kjo tabelë janë gjeneruar nga Mekanizmi Përcjellës për Harmonizimin e Raporteve Statistikore. Këshilli Prokurorial i Kosovës.

PSRK gjatë vitit 2016 ka arritur të zgjidhë rastet ndaj 63 personave të përfshirë në regjistrin PPN, përderisa ka pranuar raste të reja të korrupsionit me 50 persona. Gjatë kësaj periudhe kjo prokurori ka zgjidhur më shumë raste me persona se sa ka pranuar në punë gjatë vitit 2016. PTh në Prishtinë gjatë vitit 2016 ka pranuar 217 raste me 311 persona, përderisa ka zgjidhur rastet ndaj 181 personave apo 58% të tyre.

KPK gjatë vitit 2015, ka themeluar Njësitin Antikorrupsion, Krimeve Ekonomike, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme në PTh në Prishtinë, në Departamentin për Krime të Rënda dhe Departamentin e Përgjithshëm. IKD ka vlerësuar se “duke pasur parasysh volumin e madh të lëndëve në PTh në Prishtinë si dhe faktin se afërsisht 60% të lëndëve të korrupsionit apo krimeve ekonomike në tërë Kosovën, janë në punë në këtë prokurori, themelimi i këtij Njësi mund të vlerësohet si objektiv strategjik që do të rezultoj me ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në trajtimin dhe luftimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, nëse ka vullnet dhe përkushtim”.²³

Edhe përkundër themelimit të këtij Njësi dhe caktimit të prokurorëve nga KPK më detyrë të veçantë në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, rezultatet e pritura mungojnë. Edhe përkundër që ky Njësi ishte themeluar në vitin 2015, me qëllim të zvoglimit të rasteve të korrupsionit, në fakt ende nuk ka arritur të zgjidhë as lëndët e vjetra deri në vitin 2010.

Nga rastet e zgjidhura ndaj 396 personave, PSh ndaj 369 personave ka hudhur informatat e pranuar lidhur me dyshimet për korrupsion në këto raste, respektivisht del se PSh në 93% të këtyre rasteve i ka mbyllur.

Tabela e më poshtme paraqet rastet e korrupsionit me persona sipas parashtruesve të kallëzimeve penale, të cilat kanë mbetur të pazgjidhura më 31 dhjetor 2016. Nga rastet e pazgjidhura ndaj 1221 personave, numri më i madh i tyre i takojnë rasteve të parashtruara nga PK me 385 persona, pasuar nga i dëmtuari me 258 persona dhe qytetarët me 180 persona. Deri më 30 qershor 2016, Prokuroritë kanë deleguar në kompetencë gjithsejt rastet e korrupsionit me 132 persona të përfshirë. IKD ka gjetur si karakteristikë numrin e 288 personave subjekt të procedurave penale të korrupsionit, në të cilat raste nuk dihet parashtruesi i raportimit të veprës penale.

²³ Miftaraj E. dhe Musliu B. “Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo Promovimi i Korrupsionit”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prill 2016. Fq. 12. (Shih linkun <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2016/04/01.-Korrupsioni-ne-Kosove-Luftimi-apo-promovimi-i-korrupsionit-27.04.20161.pdf>)

RASTET E KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL NË PERIUdhËN RAPORTUESE (01.01.2016 - 31.12.2016)						
PARASHTRUESIT KALLËZIMEVE PENALE	Të pazgjidhu ra në fillim (01.01.2016)	Të pranuara (01.01.2016 deri më 31.12.2016)	Të zgjidhura(0 1.01.2016 deri më 31.12.2016)	Mënyra e zgjidhjes		Të pazgjidhura në fund (31.12.2016)
	Persona	Persona	Persona	Hudhje Persona	Mënyrë tjetër Persona	
Agjencia Kundër Korrupsionit	59		16	16		21
Agjencioni Kosovar i Pronës	4					1
Administrata Tatimore	4		5	5		
Doganat e Kosovës	3					
EULEX	6		2	2		5
Inspektorari Policor i Kosovës	36	15	6	4	2	48
Policia e Kosovës	287	171	139	128	11	385
Qytetari	112	97	52	50	2	180
I dëmtuari	209	136	116	106	10	258
Administrata Komunale	3	1	4	4		6
Auditori i Përgjithshëm			1	1		
Titullari i Pronës	28	2	1	1		13
Autoriteti Pyjor i Kosovës	9					
Prokurori me Vetëiniciativë	9	3	7	6	1	13
I paidentifikuar	7					
Pranuar në kompetencë	73	132	47	46	1	
Pa parashtrues	1					288
Total:	850	557	396	369	27	1,221

Tabela 5²⁴ - Rastet e korrupsionit në fazën e grumbullimit të informatave sipas parashtruesve

²⁴ Shënim: Informatat nga kjo tabelë janë gjeneruar nga Mekanizmi Përcjellës për Harmonizimin e Raporteve Statistikore. Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Lëndët e vjetra PPN të pazgjidhura sipas parashtruesve të informatave

IKD ka gjetur se edhe tek lëndët e regjistruara PPN, ka raste të vjetra të cilat nuk janë trajtuar nga PSh që datojnë nga viti 2004 dhe 2006 kur janë raportuar. Sipas tabelës së më poshtme, në këto dy lëndë, informatat lidhur me dyshimin e kryerjes së veprës penale janë parashtruar prej të dëmtuarve nga veprat penale të korrupsionit. Mungesa e një sistemi efikas të trajtimit të rasteve të korrupsionit në një kohë të arsyeshme dhe brenda afateve ligjore ndikon drejtpërdrejtë në besimin e qytetarëve në sistemin prokurorial të Kosovës. IKD nga monitorimi irasteve të korrupsionit, ka gjetur se mos trajtimi apo zgjidhja e rasteve të korrupsionit për vite të tëra apo në raste të caktuara edhe mbi 10 vite dëshmon mungesën e vullnetit dhe përgjegjësisë për të trajtuar rastet e korrupsionit me prioritet, dhe vë në pah neglizhencën dhe joseriozitetin e sistemit prokurorial. Në tabelën më poshtë janë paraqitur rastet e pazgjidhura të parashtruesve të informatave për veprat penale të korrupsionit.

PPN Parashtrues të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese (31.12.2016)	2004	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Total
AKK				5			1	1	11	2	1		21
EULEX									4		1		5
Doganat e Kosovës									2		1		3
IPK								1	2	9	23	13	48
PK				1		1	19	26	40	65	107	126	385
Qytetari							2	8	7	31	42	90	180
I dëmtuari	1	1						6	35	13	76	126	258
Adm. Komunale										3	2	1	6
Titullari i Pronës					1			3	2	2	3	2	13
Prokurori me vetëinic.								2	4	1	3	3	13
AKP									1				1
Pranuar në kompet.			4	1				3	2	7	61	210	288
Totali	1	1	4	7	1	1	22	50	110	133	320	571	1,221

Tabela 6 - Rastet e pazgjidhura të korrupsionit sipas parashtruesve më 31.12.2016

Në tabelën më poshtë janë paraqitur rastet e pazgjidhura të informatave për veprat penale të korrupsionit për secilën prokurori.

PPN Rastet e pazgjidhura me persona sipas prokurorive ndër vite- (31.12.2016)	2004		2006		2007		2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014		2015		2016		Total	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
	PSRK													1	2	1	2	4	8	12	34	21	50	18	44	57
Prishtinë	1	1	1	1	1	4	3	7	1	1	1	1	6	17	25	39	34	65	38	48	93	139	193	375	397	698
Prizren																		5	10	10	19	28	35	43	64	
Pejë																	5	10	8	10	18	43	39	48	70	111
Gjilan																					3	3	1	1	4	4
Mitrovicë													1	3	5	9	7	12	11	11	19	29	11	13	54	77
Ferizaj																	9	15	7	15	15	27	26	41	57	98
Gjakovë																			5	5	7	10	10	14	22	29
TOTAL	1	1	1	1	1	4	3	7	1	1	1	1	8	22	31	50	59	110	86	133	186	320	326	571	704	1221

Tabela 7 - Rastet e pazgjidhura të korrupsionit sipas prokurorive më 31.12.2016

6. PROFILI I TË AKUZUARVE PËR KORRUPSION

IKD ka vazhduar me monitorimin dhe analizimin e profilit të kryesve të veprave penale të korrupsionit në bazë të informatave të publikuara nga PSh në faqën zyrtare të Prokurorit të Shtetit, lidhur me aktakuzat kundër kryesve të veprave penale të korrupsionit gjatë vitit 2016.

Profili i pozitave të personave ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat, përfshinë: ish-Deputet, ish Kryetar Gjykatës Kushtetuese, Kryetar Komune, ish kryetar gjykate, dhe zyrtarë kryesisht të nivelit të ultë. Sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë del se me këto vepra penale, dëmi i shkaktuar kapë vlerën e mbi **3,077, 151**, përderisa, në këto aktakuza nuk ka informacion nëse prokuroritë kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.

Prokuroritë me efikase gjatë kësaj periudhe kohore janë, PSRK me 14 raste me 167 persona të përfshirë në akte akuzuese, ZKPSH një rast me 64 persona, PTh në Prizren gjatë kësaj periudhe raportuese ka ngritur 12 aktakuza kundër 26 personave të përfshirë.

Data	Pozita/Funksioni	Vlera e dëmit të shkaktuar	Kërkesa për sekuestrim/konfiskim	Numri i personave	Prokuroria
13.01.2016	Ish Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>1</u>	PSRK
1.02.2016	Persona zyrtar në KEDS	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>2</u>	PTh Gjilan
5.02.2016	Inspektor Ndërtimor	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>4</u>	PTh Gjilan
8.02.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>2</u>	PTh Pejë
15.02.2016	Qytetar	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>5</u>	PTh Prizren
25.02.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>1</u>	PTh Prizren
1.03.2016	Kryetar i Komunës, Mitrovicë Drejtor i Prokurimit, Komuna Mitrovicë Drejtor i Operatorit Ekonomik	767,940.00 €	S'ka informacion	<u>3</u>	PSRK
3.03.2016	Ska informacion	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>23</u>	PSRK/EULEX
3.03.2016	Ska informacion	20,310.56€; 2,958€; 1,607.47€ 589.00€	S'ka informacion	<u>4</u>	PTh Prizren
21.03.2016	S'ka informacion	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>1</u>	Pth Prizren
14.04.2016	Zyrtar	150,00	S'ka informacion	<u>1</u>	PTh Pejë
18.05.2016	1 ish Deputetë 1 ish Ministër	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>20</u>	PSRK-EULEX
19.05.2016	Mjek	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>3</u>	PTh Gjilan
20.05.2016	Udhëheqës Divizioni, MPB	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>1</u>	PTh Prishtinë
27.05.2016 2	Kryetar Bordi-ART, ish-anëtar i Bordit të ART-së	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>2</u>	PTh Prishtinë
31.05.2016	Kryetar, Gjykata e Apelit	S'ka informacion	S'ka informacion	4	PSRK
14.06.2016	Drejtor i Shërbimeve Publike, Emergjencës - Komuna Drenas Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	4	PTh Prishtinë

	certifikues në Kuvendin Komunal në Drenas Zyrtar në Kuvendin Komunal në Drenas Pronar i një firme				
15.06.2016.	Aktakuza përfshinë 60 persona fizik dhe 4 persona juridik. Ata janë: një ministër, një sekretar I përgjithshëm I një ministrie, 44 mjekë, një infermierë, 13 punonjës në sektorin privat shëndetësor	S'ka informacion		64	ZKPSH
21.06.2016	S'ka Informacion	35,000.00	S'ka informacion	4	PTh Prizren
01.07.2016	Zyrtar	3,306	S'ka informacion	1	PTh Prizren
01.07.2016	Qytetarë	2,051.644	S'ka informacion	3	PSRK
08.07.1016	Zyrtarë	S'ka informacion	S'ka informacion	2	PTh Prizren
28.07.2016	Shtetas malazes	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PSRK
02.08.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	4	PTh Pejë
04.08.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	4	PSRK
09.08.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Prizren
14.08.2016	3 Zyrtar 1 qytetar	S'ka informacion	S'ka informacion	4	PTh Prizren
26.08.2016	1 zyrtar në 2 qytetarë	S'ka informacion	S'ka informacion	3	PSRK
30.08.2016	Kryetar i Komunës	168.000	S'ka informacion	1	PSRK
16.09.2016	Kryetar Komune dhe 38 personave tjerë	S'ka informacion	S'ka informacion	39	PSRK
26.09.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	2	PTh Gjilan
18.10.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Prizren
25.10.2016	1 ish Deputet i kuvendit të Kosovës dhe 38 të tjerë	S'ka informacion	S'ka informacion	39	PSRK
31.10.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	2	PTh Prizren
01.11.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Prizren
17.11.2016	11 zyrtarë të Shërbimit korrektues 1 mjek	S'ka informacion	S'ka informacion	24	PSRK
12.12.2016	1 Deputet 1 tjetër	25.646	S'ka informacion	2	PSRK
		3,077, 151		282	

Tabela 8 - Profili i të akuzuarve për korrupsion dhe vlera e sekuestrimeve dhe konfiskimeve

7. PRAKTIKA E TRAJTIMIT TË LËNDËVE TË KORRUPSIONIT:

Analizë ligjore e rasteve të veçanta

KPK në dhjetor 2015, ka miratuar Planin Strategjik (2016-2018) dhe Planin e Veprimit²⁵ për trajtimin e rasteve të korrupsionit. Plani ka pasur këto qëllime kryesore: zvogëlimin e lëndëve të pazgjidhura, rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja, rritjen e nivelit të bashkëpunimit me institucione, rritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve të specializuara, llogaridhënien dhe transparencën.

Gjetjet e monitorimit të IKD-së tregojnë se përkundër këtij vullneti formal në trajtimin e rasteve të korrupsionit me prioritet, në aspektin praktik përkundër disa lëvizjeve pozitive, nuk janë arritur qëllimet e planit. Gjatë procesit të monitorimit të seancave gjyqësore në rastet e korrupsionit, IKD ka identifikuar dhe analizuar raste konkrete të trajtimit nga prokuroria dhe gjykata, rreth shkeljes së afateve ligjore dhe paraqitjes së kërkesave për sekuestrim apo konfiskim, etj.

IKD gjatë vitit 2016, ka monitoruar 1505 seanca gjyqësore në 383 raste të korrupsionit ku përfshihen 989 persona, në të gjitha gjykatat themelore në Kosovë. IKD për çdo seancë të monitoruar ka raportuar lidhur me rrjedhën e procesit gjyqësor në rastet e korrupsionit.

Monitoruesit e IKD-së, gjatë procesit të monitorimit kanë gjetur se edhe përkundër vullnetit deklarativ të shprehur nga akterët kryesorë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në trajtimin e rasteve të korrupsionit me prioritet të lartë, praktika dëshmon krejtësisht të kundërtën.

Politikat dhe vendimet e miratuara nga KGJK dhe KPK nuk po gjejnë zbatim në praktikë. Afatet ligjore të përcaktuara me KPPK lidhur me trajtimin e rasteve penale në fazën e hetimeve, ndjekjes penale dhe shqyrtimit gjyqësor shkelen pothuajse në çdo rast të korrupsionit, pa dallim si nga prokurorët dhe gjykatësit vendorë ashtu edhe ata të EULEX-it. Gjetjet e IKD-së lidhur me shkeljet ligjore dhe procedurale gjatë trajtimit të rasteve të korrupsionit dëshmojnë në rastet praktike të elaboruara më poshtë, të cilat janë analizuar dhe hulumtuar nga monitoruesit dhe hulumtuesit e IKD-së.

Prokurorët dhe gjykatësit vendorë dhe ndërkombëtarë ende po e kanë të vështirë të adoptohen me rolin dhe përgjegjësitë e reja sipas ndryshimeve të inkuorporuara në KPPK. Gjykata të caktuara në Kosovë, tanimë e kanë shëndërruar në praktikë tejkalimin

²⁵ *Shënim:* Ky Plan Strategjik përmban pothuajse të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Planin e Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit të miratuar më 4 nëntor 2013 nga KPK.

e shqyrtimit të dytë, duke kaluar prej shqyrtimit fillestar drejt në shqyrtim kryesor. Afatet ligjore, lidhur me caktimin e shqyrtimit fillestar në afat prej tridhjetë ditëve nga dita kur është ngritur aktakuza nuk zbatohet në praktikë pothuajse asnjëherë.

Rasti Ukë Rugova, Astrit Haraqija dhe të tjerët është ende në fazën e shqyrtimit fillestar, edhe 10 muaj pas ngritjes së aktakuzës, duke u shkelur afatet ligjore të përcaktuara në KPPK. Në rastin kundër Naser Osmani, tanimë deputet në Kuvendin e Kosovës, aktakuza është ngritur më 16 shkurt 2016, ndërsa ky rast ende nuk e ka kaluar as shqyrtimin e dytë edhe një vit pas ngritjes së aktakuzës. Shqyrtimi i dytë lidhur me këtë rast është caktuar më 6 maj 2016, por seanca është shtyrë. Prej kësaj date e deri në fund të shkurtit 2017 nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore lidhur me këtë rast. Të dy këto raste janë duke u ndjekur dhe gjykuar nga prokurorët dhe gjykatësit e EULEX-it.

Rasti tjetër që dëshmon se rastet e korrupsionit nuk trajtohen me seriozitet është rasti "Stenta". Karakteristikë e këtij rasti është ngritja e aktakuzës nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit më 15 qershor 2016. Shqyrtimi fillestar në rastin "Stenta" është caktuar më 21 tetor 2016, respektivisht me tre muaj vonesë apo pas afatit të përcaktuar me KPPK. Seanca e fundit në këtë rast është mbajtur më 16 mars 2017. Edhe kjo seancë gjyqësore është shtyrë për arsye se Aktakuza nuk iu është dorëzuar të gjithë personave të akuzuar. Ndërsa, në seancën gjyqësore të 28 shkurtit 2017, në shqyrtim të parë gjyqtarja e rastit, Shadije Gërguri ka sqaruar se prokuroria me shkresë të veçantë ka njoftuar gjykatën se Afrim Bekteshi kishte qenë i përfshirë në hetimet për këtë rast, por ndaj tij nuk janë gjetur elemente të veprës penale dhe i njëjti nuk është pjesë e akuzës, por që është përfshirë në aktakuzë si rezultat i një gabimi teknik.

Rasti i tërëhjekjes nga ndjekja penale ndaj Afrim Bekteshit, dëshmon joseriozitetin dhe jokompetencën e prokurorisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit të nivelit në mënyrë të drejtë dhe profesionale. Po ashtu arsyetimi i prokurorisë për gabim teknik në ngritjen e aktakuzës bie në kundërshtimin me obligimin ligjor që ka Prokurori i Shtetit sipas nenit 48 të KPPK, i cili përcakton se është detyrim i prokurorit të shtetit gjatë hetimit të veprave penale, të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të sigurojë që hetimi të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit. Vet fakti se kjo aktakuzë është ngritur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe arsyetimi për ngritjen e aktakuzës kundër njeriut të gabuar për shkak të gabimit teknik dëshmon joseriozitetin e trajtimit të rasteve të korrupsionit. Rasti "Stenta" është ende në shqyrtim fillestar në GjTh në Prishtinë, edhe përkundër faktit se aktakuza është ngritur në muajin qershor të vitit 2016, respektivisht kanë kaluar 9 muaj nga ngritja e aktakuzës.

IKD gjatë procesit të monitorimit gjen se vetëm një numër i vogël i rasteve të korrupsionit i takojnë luftimit të vërtetë të korrupsionit. Gjetjet IKD-së dëshmojnë se numri më numër i madh i aktakuzave lidhen me vepra penale të korrupsionit të nivelit të ultë, dhe edhe në ato raste kur i takojnë nivelit të lartë, mungojnë aktgjykimet dënuese. Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016, ka konstatuar se Kosova është ende në fazë të hershme në luftën kundër korrupsionit. Sipas Raportit të Progresit ka rritje të numrit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë që hetohen dhe ndiqen penalisht, sidoqoftë, korrupsioni mbetet në shumë fusha dhe vazhdon të mbetet problem serioz. Edhe Departamenti i Shtetit Amerikan në Raportin për Kosovën lidhur me praktikën për të drejtat e njeriut për vitin 2016, ka konstatuar se korrupsioni endemik qeveritar dhe në sektorin privat është i ndërlidhur me mungesën e dënimeve në rastet e korrupsionit.²⁶

IKD po ashtu ka gjetur se në shumë raste të korrupsionit më shumë ka persekutim apo luftë personale kundër individëve të caktuar, duke shfrytëzuar retorikën para publikut dhe faktorit ndërkombëtar se korrupsioni në Kosovë po luftohet. Hulumtimi i IKD-së ka gjetur se në shumë raste edhe të profilit të lartë prokuroria ka ngritur aktakuza të pabaza, të cilat janë hudhur apo refuzuar nga gjykata në raste të caktuara në shqyrtim të parë apo edhe në faza të mëvonshme të procedurës gjyqësore, si rastet kundër Enver Hasanit, Lutfi Hazirit dhe Shpresa Bakisë. Për më tepër Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të njëjtit prokurorë ndaj të cilit ishte ngritur aktakuzë nga vet prokuroria dhe ishte suspenduar nga Komisioni Disiplinor i KPK-së nga të gjitha funksionet prokuroriale, i ka ndarë mirënjohje për meritat në promovimin e sistemit prokurorial. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka ndarë mirënjohje edhe për prokurorë të caktuar të cilët në të kaluarën kishin marr vendime të kundërligjshme.²⁷

Gjetjet e monitorimit dëshmojnë se edhe përkundër faktit se ishin ngritur aktakuza në raste të caktuara ku Prokuroria kishte konstatuar se përmes veprimeve të kundërligjshme korruptive janë shkaktuar dëme me dhjetëra miliona euro, prokurorët në asnjë rast të vetëm nuk kanë paraqitur kërkesa për sekuëstrim apo konfiskim të pasurive të fituara me vepër penale. IKD vlerëson se dispozitat e KPPK apo ligjet tjera të aplikueshme lidhur me sekuëstrimin apo konfiskimin e pasurisë së fituar me vepra penale të korrupsionit pothuajse nuk zbatohen asnjëherë. Ato zbatohen vetëm në rastet kur konfiskohen armë, fishekë apo mjete më të cilat është kryer vepra penale. Elaborimi i rasteve të mëposhtme konfirmon të gjeturat e lartëpërmendura.

²⁶ Bureau of Democracy, Human Rights and Labor, Country Reports on Human Rights Practices for 2016, Kosovo, në: <https://www.state.gov/documents/organization/265648.pdf>

²⁷ Komunikatë për Media e PSh-së rreth Konferencës Vjetore të Prokurorëve. (Shih linkun <http://www.psh-ks.net/sq/lajme/eshte-mbajtur-konferenca-vjetore-e-prokurore-ve-te-kosoves>)



Rasti Ukë Rugova: Ish-Deputet

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.305/16

Vepra penale: “Krim i organizuar”, “kontrabandim të migrantëve”, “posedim i paautorizuar i armëve”, “ushtrim i ndikimit”, “mashtim”, “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Kryetari i Trupit Gjykses: Fillimisht ka qenë Vitor Pardal, tani është Vladimir Mikula
Prokuror: Andrew Hughes

I/E pandehur: Ukë Rugova, Izet Beqiri, Florjan Petani, Qefser Baholli, Astrit Haraçija, Fitim Beqiri, Azad Beqiraj, Liridona Beqiri, Kujtim Avdyli, Ragip Gashi, Visar Beqiri Hamza Beqiri, Azem Koskoviku, Edison Idrizaj, Beg Shaqiri, Hasan Shaqiri, Driton Voca, Valon Selimi, Fadil Ahmeti dhe Haxhi Islami.

PSRK më 18 nëntor 2013 kishte marr Aktvendim për fillimin e hetimeve në rastin kundër Ukë Rugovës dhe të tjerëve. Më 18 maj 2016, PSRK kishte ngritur aktakuzë ndaj Ukë Rugovës, ish-deputet i Kuvendit të Kosovës dhe Astrit Haraçisë, ish-Ministër, lidhur me dyshimin për kryerjen e veprave penale: “krim i organizuar”; “kontrabandim të migrantëve”; “posedim i paautorizuar i armëve”; “ushtrim i ndikimit”; “mashtim”; “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Aktakuza e Prokurorisë Speciale ngarkon Ukë Rugovën se gjatë periudhës maj 2011 deri në shkurt 2014 ka menaxhuar një grupi kriminal, duke furnizuar individë me viza shengen të BE-së, nga Ambasada Italiane në Prishtinë. Të gjitha këto viza dyshohet se janë marrë në mënyrë të paligjshme nëpërmjet shtrembërimit apo korrupsionit.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Rasti Ukë Rugova, Astrit Haraçija dhe të tjerët hyn në kuadër të luftimit të korrupsionit të nivelit të lartë. Ky rast është duke u ndjekur dhe gjykuar nga prokurorë dhe gjykatës të EULEX-it.

Përderisa aktakuza ishte ngritur më 18 maj 2016, në bazë të nenit 242 pika 4 e KPPK-së gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës. Ky afat ligjor është shkelur në mënyrë të vazhdueshme nga ana e trupit gjykues të udhëhequr nga gjykatësi i EULEX-it. Shqyrtimi i parë në këtë rast është caktuar më 25 gusht 2016, apo mbi tre muaj pas ngritjes së aktakuzës. Shqyrtimi i parë i caktuar më 25



gusht 2016, apo mbi tre muaj pas ngritjes së aktakuzës. Shqyrtimi i parë i caktuar më 25 gusht është shtyrë disa herë, respektivisht më 30 gusht, 6 tetor, 29 nëntor 2016 dhe 18 janar 2017. Neni 245 paragrafi 5 i KPPK-së, përcakton se gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar, e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar. Rasti Ukë Rugova, Astrit Haraçija dhe të tjerët ende është në fazën e shqyrtimit fillestar, edhe 10 muaj pas ngritjes së aktakuzës, duke u shkelur afatet ligjore të përcaktuara në KPPK. IKD vlerëson se kjo qasje e gjyqësorit, jo që nuk dëshmon vullnet për të zbatuar politikën e sistemit gjyqësor për trajtim të rasteve të korrupsionit me prioritet absolut, por përkundrazi dëshmon shkelje të vazhdueshme të afateve ligjore të përcaktuara në KPPK-së. Në këto raste, IKD vlerëson se mekanizmat e llogaridhënies duhet të ndër marrin veprime konkrete në drejtim të rritjes së përgjegjësisë në zbatimin e obligimeve ligjore për të ruajtur sigurinë juridike të të pandehurve në trajtimin e rasteve në kohë të arsyeshme në përputhje me ligjin dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Sipas aktakuzës, Ukë Rugova dhe të tjerët kanë marrë 3000 deri në 4000 euro në këmbim të një vize shengen të lëshuar nga Ambasada Italiane në Prishtinë. Grupi dyshohet se ka siguruar 556 viza, që i bie përafërsisht kanë përfituar në mënyrë të kundërligjshme shumën prej 1.668.000 deri 2,224.000 Euro. Neni 241 paragrafi 1.9 i KPPK përcakton se Prokurori i Shtetit në aktakuza duhet të përcakton me saktësi çdo ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, fonde apo pasuri tjera që mund t'i nënshtrohen konfiskimit. Aktakuza po ashtu përshkruan provat e nevojshme që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin nga Kapitulli XVIII i KPRK-së.

Aktakuza e paraqitur nga Prokurori i EULEX-it, nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me veprat penale të ngritura në aktakuzë. Prokurori i EULEX-it në aktakuzë ka listuar sendet e konfiskuara që kryesisht janë armë dhe fishekë të llojeve të ndryshme.



Rasti Naser Osmani: Deputet

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.734/15

Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Kryetari i Trupit Gjykie: Shashivar Hoti

Prokuror: Admir Shala

I/E pandehur: Naser Osmani, Bahri Shabani, Shkelzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Agron Kamberi, Adrian Kelmendi, Agim Deshishkus

Rasti kundër Naser Osmanit kishte filluar sipas kallëzimit penal të parashtruar nga Policia e Kosovës më 28 prill 2014. PSRK më 30 prill 2014, kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve, kurse kjo Prokurori më 16 shkurt 2016, kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë kundër deputetit Naser Osmani, Nënkyetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Bahri Shabani, Shkelzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Agron Kamberi, Adrian Kelmendi, Agim Deshishku, të gjithë zyrtarë në AKP.

Sipas aktakuzës së ngritur nga ana e PSRK-së, të akuzuarit Naser Osmani, si nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Bahri Shabani si Drejtori i Bordit të AKP-së, Shkelzen Lluka si menaxher i AKP-së, Naim Avdiu si zv/drejtor menaxhues i AKP-së dhe Melita Ymeraga, Ardian Kelmendi, Agron Kamberaj si kryesues të Njesisë së Monitorimit në AKP në bashkëpunim me zyrtarët e tjerë si anëtarë ndërkombëtar të AKP-së: Lisa Brodey, Mohammed Omran dhe Hubert Warsmann, i kanë kaluar kompetencat zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë për vete ose për personin tjetër, në vlerë prej 5,400,000,00 euro. Ata akuzohen se kanë shkelur të drejtat e punëtorëve të kësaj ndërmarrje, me çka njëkohësisht i kanë shkaktuar dëm Ndërmarrjes Shoqërore “FAN” e përfaqësuar nga AKP-ja si dhe buxhetit të shtetit, lidhur me çështjen e Ndërmarrjes së Re “FAN-Podujevë”. Kjo e fundit, ishte privatizuar në valën e 7-të të shitjes nga AKM-ja, ku ishte blerë me çmim prej 2,310,000 euro nga blerësi, që më pas i akuzuari Agim Deshishku sipas kontratës së nënshkruar me zotimet e fituara të bëjë investime në vlerë prej 2,800,000 euro dhe të punësoj 236 punëtorë gjatë periudhës dy vjeçare.



Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar lidhur me këtë rast është caktuar më 17 mars 2016. Kjo seancë gjyqësore është shtyrë për 4 prill 2016. Në seancën e 4 prillit 2016, përderisa prokurori special Admir Shala ka lexuar aktakuzën, Naser Osmani dhe Bahri Shabani, pjesë e bordit të drejtorëve të AKP-së, nuk u deklaruan lidhur me fajësinë, me arsyetimin se prezent duhet të jenë të gjithë anëtarët e bordit.²⁸ Shqyrtimi i dytë lidhur me këtë rast është caktuar më 6 maj 2016, por është shtyrë. Që nga 6 maj 2016, deri në fund të shkurtit 2017 nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore lidhur me këtë rast. Naser Osmani aktualisht është deputet i Kuvendit të Kosovës, dhe Kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës. Sekuestrimi dhe konfiskimi: Edhe përkundër faktit se të pandehurit akuzohen për keqpërdorime që kalojnë vlerën e mbi 5 milionë eurove, prokuroria nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Edhe përkundër faktit se të pandehurit akuzohen për keqpërdorime që kalojnë vlerën e mbi 5 milionë eurove, prokuroria nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë.

²⁸ Raport nga monitorimi i seancës gjyqësore kundër Naser Osmani dhe të tjerëve, 4 prill 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/fillon-gjykimi-naser-osmani-dhe-te-tjeret-ne-rastin-e-akp-se-deklarohen-te-pafajshem/>



Rasti "Stenta": Ferid Agani, Ministër i Shëndetësisë bashkë me 62 persona tjerë

Numri i lëndës: PKR.nr.369/16

Vepra penale: "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", "marrje e ryshfetit", "dhënie e ryshfetit", "trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor", "ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike" dhe "shmangia nga tatimi"

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Shadije Gërguri

Prokuror special: Admir Shala

Të pandehur: Ferid Agani, dhe 63 persona tjerë.

Më 15 qershor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kishte ngritur aktakuzë kundër ish-ministrit të Shëndetësisë, Ferid Agani, Sekretarit të Përgjithshëm të MSh-së, Gani Shabani dhe 62 personave të tjerë, për veprat penale "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", "Marrje e ryshfetit", "Dhënie e ryshfetit", "Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor", "Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike" dhe "Shmangia nga tatimi". Në këtë çështje penale hetimet fillimisht janë zhvilluar kundër 116 personave fizik dhe 4 personave juridik. Pas hetimeve, për 56 persona fizik nuk ishin plotësuar kushtet ligjore që të përfshihen në këtë aktakuzë, andaj për të njëjtit edhe kishin pushuar hetimet. Karakteristikë e këtij rasti është ngritja e aktakuzës nga prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, në kundërshtim me ligjin dhe praktikën gjyqësore në Kosovë. Deri më tani kanë qenë të caktuar katër prokurorë të ngarkuar me lëndën "Stenta". Është karakteristikë e rastit se prokurori i shtetit që ka ushtruar aktakuzën nuk e përfaqëson atë dhe nuk e mbron atë. Aktakuza është dorëzuar në muajin qershor 2016, por leximi i saj nuk është bërë ende meqë prokuroria nuk i ka dorëzuar provat për të gjithë të pandehurit në gjuhët që ata e kuptojnë. Kjo ka rezultuar në 5 seanca të shtyra deri më tani. Me ritmin dhe mënyrën që është duke u menaxhuar ky rast, rrezikon se do të jetë rasti më maratonik i gjyqësisë në Kosovë.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Kallëzimi penal në rastin "Stenta" është ngritur më 26 maj 2014, kurse aktvendimi për fillimin e hetimeve më 16 qershor 2014. Aktakuza është ngritur më 14 qershor 2016. Shqyrtimi fillestar në rastin "Stenta" është caktuar më 21 tetor 2016, respektivisht me tre muaj vonesë apo afatit të përcaktuar me KPPK. Seanca e fundit në rastin "Stenta" është mbajtur më 16 mars 2017,²⁹. Edhe kjo seancë gjyqësore është shtyrë për arsye se Aktakuza nuk iu është dorëzuar të gjithë personave të akuzuar. Karakteristikë për këtë rast është edhe seanca e shtyrë më 28 shkurt 2017. Në këtë seancë gjyqësore në shqyrtim të parë gjyqtarja e rastit, Shadije Gërguri ka sqaruar se prokuroria me shkresë të veçantë ka njoftuar gjykatën se Afrim Bekteshi kishte qenë i përfshirë në hetimet për këtë rast, por ndaj tij nuk ishin gjetur elemente të veprës penale dhe i njëjti nuk ishte pjesë e akuzës.

²⁹ Raport nga monitorimi i Shqyrtimit fillestar të rastit Stenta me 16 mars 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/mos-perkthimi-i-provave-ne-gjuhet-amtare-te-te-akuzuarve-shkak-i-shtyrjes-se-seances-ne-rastin-stenta/>



“Prokuroria më ka njoftuar zyrtarisht që ka ndodhur një gabim teknik, duke e përfshirë Afrim Bekteshin në akuzë, por ndaj tij ka një aktvendim për pushim të hetimeve dhe i njëjti nuk është dashur të jetë pjesë e aktakuzës”, ka thënë gjyqtarja Gërguri.³⁰ Rasti i mënyrës së ngritjes së aktakuzës dhe tërheqjes nga ndjekja penale ndaj Afrim Bekteshit, dëshmon joseriozitetin e prokurorisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Po ashtu arsyetimi i prokurorisë për gabim teknik në ngritjen e aktakuzës bie në kundërshtimin me obligimin ligjor që ka Prokurori i Shtetit sipas nenit 48 të KPPK-së, i cili përcakton se është detyrim i prokurorit që gjatë hetimit të veprave penale, të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të sigurojë që hetimi të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit. Rasti “Stenta” është ende në shqyrtim fillestar në GjTh në Prishtinë, edhe përkundër faktit se aktakuza është ngritur në muajin qershor të vitit 2016, respektivisht kanë kaluar 9 muaj nga ngritja e aktakuzës.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Sipas aktakuzës, të pandehurit në rastin “Stenta” kanë përfituar në mënyrë të kundërligjshme apo e kanë dëmtuar buxhetin e Kosovës në shumën prej 5.000.000 deri 10.000.000 Euro. Neni 241 paragrafi 1.9 i KPPK përcakton se Prokurori i Shtetit në Aktakuza duhet të përcakton me saktësi çdo ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, fonde apo pasuri tjera që mund t’i nënshtrohen konfiskimit. Aktakuza po ashtu përshkruan provat e nevojshme që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin nga Kapitulli XVIII i Kodit. Aktakuza e paraqitur nga Prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me veprat penale të ngritura në aktakuzë.

³⁰ Raport nga monitorimi i Shqyrtimit fillestar të rastit Stenta me 28 shkurt 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/perfshihet-gabimisht-ne-aktakuzen-e-rastit-stenta-lirohet-nga-ndjekja-penale-afirim-bekteshi/>



Rasti Salih Mekaj: Kryetar i Gjykatës së Apelit

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.338/16

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”;
“Shtytje në kryerjen e veprës penale” dhe “Dhënia e ryshfetit”

Kryetari i Trupit Gjykses: Shashivar Hoti

Prokurore: Drita Hajdari

I/E pandehur: Salih Mekaj; Vlora Gorani; Mentor Seferaj; Ali Seferaj

Avokat/Mbrojtës: Besnik Berisha; Destan Rukiqi tjerë.

Më 31 maj 2016, PSRK ka ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë, kundër ish-Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe anëtarit të KGJK-së, Sali Mekaj, për “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Sipas aktakuzës Salih Mekaj, në cilësinë e personit zyrtar, (në atë kohë kryetar i Gjykatës së Apelit të Kosovës), ka shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin e tij zyrtar, me qëllim të përfitimit të dobisë për vete dhe për persona të tjerë. Mekaj i ka premtuar të pandehurës Vlora Gorani se do të angazhohet për caktimin e shqyrtimit gjyqësor në dy raste, si dhe ri cilësimin juridik të veprave penale, nga veprat penale më të rënda në ato më të lehta, në mënyrë që dy të pandehur në ato raste të lirohen nga paraburgimi. I pandehuri Mekaj me këtë qëllim ka kërkuar nga gjyqtarja e njërit rast në fjalë që ta caktoj shqyrtimin gjyqësor në atë lëndë, në kundërshtim me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës. E pandehura Vlora Gorani me dashje ka shtyrë të pandehurin Salih Mekaj të kryej veprën penale, me qëllim që përmes tij ta shpejtoj caktimin e shqyrtimit gjyqësor dhe pastaj edhe ricilësimin juridik të veprave penale për të pandehurin Mentor Seferaj dhe një tjetër të pandehur në një tjetër rast penal, që në këtë mënyrë të arrij lirimin e këtyre dy personave nga paraburgimi.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Në rastin kundër Sali Mekaj, shqyrtimi fillestar është caktuar me vonesë prej pesë muaj nga dita e ngritjes së aktakuzës, respektivisht më 20 tetor 2016. Seanca e 20 tetorit 2016 është shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarit Mentor Seferaj i cili gjendet në paraburgim. Gjyqtari i rastit, Shashivar Hoti, ka njoftuar palët se e kanë dërguar ftesën për të akuzuarin Mentor Seferaj, por të njëjtit nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Mbrojtësi i të akuzuarës Vlora Gorani, avokati Besnik Berisha në këtë seancë, ka kërkuar nga gjykata përjashtimin e publikut në këtë rast, dhe mos publikimin e fotografive. Kërkesës së tij iu është bashkangjitur edhe përfaqësuesi i të akuzuarit Salih Mekaj, avokati Ramë Gashi. Edhe prokurorja e kësaj lënde Drita Hajdari është pajtuar për përjashtimin e publikut. Me këtë rast, gjykata duke u bazuar në nenin 294 të KPPRK-së ka marr vendim që shqyrtimi gjyqësor për rastin në fjalë të jetë i mbyllur për publikun.³¹



Shqyrtimi fillestar në këtë rast ka vazhduar në seancën gjyqësore të mbajtur me 30 nëntor 2016.³² Shqyrtimi i dytë gjyqësor i caktuar për datë 10 janar 2017, është shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarës Vlora Gorani.³³ Seanca e dytë gjyqësore lidhur me shqyrtimin e dytë në rastin kundër Sali Mekaj është mbajtur tek më 30 janar 2017.³⁴

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka informacion.

³¹ Raport nga monitorimi i shqyrtimit fillestar në rastin kundër Sali Mekaj, 20 tetor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-gjykimi-ndaj-ish-kryetarit-te-gjykates-se-apelit-salih-mekaj-dhe-tre-te-akuzuarve-tjere-perjashtohet-publiku/>

³² Raport nga monitorimi në rastin kundër Sali Mekaj, 30 nëntor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-ish-kryetari-i-gjykates-se-apelit-salih-mekaj-dhe-tre-te-akuzuarit-e-tjere/>

³³ Raport nga monitorimi i shqyrtimit të dytë në rastin kundër Sali Mekaj, 10 janar 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-shqyrtimi-dytesor-ndaj-ish-kryetarit-te-gjykates-se-apelit-salih-mekaj-dhe-tre-te-akuzuarve-tjere/>

³⁴ Raport nga monitorimi në rastin kundër Sali Mekaj, 30 janar 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/kerkohet-hudhja-e-aktakuzes-ndaj-ish-kryetarit-te-gjykates-se-apelit-dhe-tre-te-akuzuarve-tjere/>



Rasti Fatmir Limaj: Ish-Ministër i MTPT-së

Numri i lëndës: PKR.nr.8/13

Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”,
“Marrje e ryshfetit”, “Dhënie e ryshfetit”

Kryetari i Trupit Gjykses: Marie Tuma

Prokuror special: Charles Hardaway

Të pandehur: Fatmir Limaj, Nexhat Krasniqi, Endrit Shala, Shpëtim Telaku dhe Florim Zuka

Avokat/Mbrojtës: Tahir Rrecaj, Florent Latifaj, Dijamant Zeka, Nysret Islami, Blerim Prestreshi, Naser Sopjani

Prokurori i EULEX-it më 23 prill 2010, kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve në rastin kundër Fatmir Limaj, ish-Ministër i Ministrisë së Transportit Postës dhe Telekomit (“MTPT”) dhe të tjerëve. Prokuroria lidhur me këtë rast më 5 dhjetor 2012, kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë kundër Fatmir Limaj, Nexhat Krasniqi, Endrit Shala, Shpëtim Telaku dhe Florim Zuka për veprate penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Marrje e ryshfetit”, “Dhënie e ryshfetit”. Aktakuza e 5 dhjetorit 2012, kundër grupit Limaj në publik njihet edhe si rasti MTPT 1, pasi që prokurori i EULEX-it më 29 shkurt 2014 kishte ngritur aktakuzën tjetër i njohur si MTPT2. Përderisa më 31 gusht 2015, është ngritë një aktakuzë e cila është cilësuar si “aktakuzë e konsoliduar”.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Rasti MTPT 1: Shqyrtimi fillestar lidhur me rastin MTPT 1, ishte mbajtur më 26 mars 2014, apo mbi 15 muaj pas afatit ligjor të përcaktuar me KPPK.

fillestar lidhur me rastin MTPT 2, ishte mbajtur më 10 qershor 2015 dhe 30 tetor 2015, apo **Rasti MTPT 2:** Shqyrtimi fillestar lidhur me rastin MTPT 2, ishte mbajtur më 10 qershor 2015 dhe 30 tetor 2015, apo mbi 14 muaj pas afatit ligjor të përcaktuar me KPPK, apo një muaj me vonesë pas ngritjes së “aktakuzës së konsoliduar” më 31 gusht 2015.

Shqyrtimi kryesor: Nga 18 nëntor 2015 deri më 6 dhjetor 2016, në rastet kundër Fatmir Limaj dhe të tjerëve janë caktuar gjithsejt 33 seanca gjyqësore në shqyrtim kryesor, nga të cilat janë shtyrë 4 seanca gjyqësore.³⁵

³⁵ Raporte nga monitorimi i seancave gjyqësore kundër Fatmir Limaj dhe të tjerëve, në:

<http://betimiperdrejtesi.com/vjollca-kelmendi-deshmon-sot-ne-rastin-limaj-te-mtpt-se/>

<http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-serish-rasti-i-mtpt-se/>

<http://betimiperdrejtesi.com/deshmon-vjollca-kelmendi-ne-rastin-e-mtpt-se/>

<http://betimiperdrejtesi.com/qemajl-mustafa-pritet-te-jap-deshmine-e-tij-ne-rastin-e-njohur-mtpt/>

<http://betimiperdrejtesi.com/qemajl-mustafa-vazhdon-deshmine-e-tij-ne-rastin-mtpt/>

<http://betimiperdrejtesi.com/qemajl-mustafa-nuk-ka-pasur-nderhyrje-ne-tendere/>

<http://betimiperdrejtesi.com/vazhdon-ri-marrja-ne-pyetje-e-deshmitarit-qemajl-mustafa-ne-rastin-e-mtpt-se/>



Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Prokurori në aktakuza nuk ka paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.

<http://betimiperdrejtesi.com/hasan-preteni-akk-ka-qene-urelid-hese-mes-prokurorise-dhe-deshmitarit-mehmet-shkodra-ne-rastin-e-mtpt-se/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-zukri-carolli-ne-rastin-e-mtpt-se-shkodra-gjithmone-ka-thene-se-njeh-njerez-ne-qeveri/>
<http://betimiperdrejtesi.com/prokurori-propozon-deshmitar-te-ri-ne-rastin-mtpt/>
<http://betimiperdrejtesi.com/prokurori-hardaway-florent-lati-faj-avokat-i-nexhat-krasnqiit-dhe-adem-grabovcit-te-perjashtohet-nga-rasti-mtpt-per-shkak-te-konfliktit-te-interesit-latifaj-thote-se-kjo-e/>
<http://betimiperdrejtesi.com/per-te-treten-here-deshton-marrja-ne-pyetje-e-deshmitarit-ekrem-demolli-ne-rastin-e-mtpt-se/>
<http://betimiperdrejtesi.com/prokurori-hardaway-pajto-het-me-disa-propozime-te-avokatit-nderkombetar-karim-khan-ne-rastin-mtpt-te-njejtat-propozime-i-kishte-injoruar-vazhdimisht-nga-a-vokatet-vendes/>
<http://betimiperdrejtesi.com/rasti-i-mtpt-se-avokati-khan-kerkon-perjashtimin-e-kryetares-se-trupit-gjykues/>
<http://betimiperdrejtesi.com/rasti-mtpt-jep-deshmine-e-tij-zyrtari-i-agjencionit-kunder-korrupcion-ekrem-demolli/>
<http://betimiperdrejtesi.com/perfundon-deshmine-e-tij-zyrtari-i-agjencionit-kunder-korrupcion-ekrem-demolli-rasti-mtpt-se/>
<http://betimiperdrejtesi.com/mungon-i-akuzuari-shtyhet-deshmia-e-bekim-shkodres-ne-rastin-e-mtpt-se/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmon-djali-i-te-ndjerit-mehmet-shkodra-ne-rastin-e-mtpt-se/>
<http://betimiperdrejtesi.com/perfundon-deshmia-e-deshmitarit-bekim-shkodra-ne-rastin-e-mtpt-se/>
<http://betimiperdrejtesi.com/ngritje-zeri-mes-prokurorit-dhe-endrit-shales-ne-rastin-mtpt-mbrojtja-respektojani-vendimin-e-apelit-per-sms-te/>
<http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-gjyqesore-ne-rastin-e-mtpt-se/>
<http://betimiperdrejtesi.com/vazhdon-deshmia-e-deshmitarit-mevludin-krasnqi-ne-rastin-e-mtpt-se/>
<http://betimiperdrejtesi.com/vazhdon-deshmia-e-deshmitarit-mevludin-krasnqi-ne-rastin-e-mtpt-se-2/>
<http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-edhe-nje-seance-gjyqesore-ne-rastin-e-mtpt-se-mungon-avokati-tahir-rrecaj/>
<http://betimiperdrejtesi.com/ne-rastin-mtpt-deshmoi-ish-zevendes-ministri-i-ndjeri-shkodra-ka-pasur-aq-shume-kerkesa-per-tendere-saqe-as-amerika-nuk-kishte-mundur-tia-plotesont-e-deshirat/>
<http://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-e-endrit-shales-nuk-e-ka-pranuar-raportin-e-prokurorise-i-cilesuar-si-pastrimi-i-aktakuzes-shtyhet-seanca-ne-rastin-e-njohur-si-mtpt/>
<http://betimiperdrejtesi.com/pas-dy-ore-pritje-nis-marrja-ne-pyetje-e-adem-grabovcit-ne-rastin-mtpt/>
<http://betimiperdrejtesi.com/adem-grabovcit-i-lexohen-sms-et-sa-ish-te-zv-minister-ne-mtpt-thote-se-nuk-mban-pergjegjesi-kush-i-dergon-sms-ne-numrin-e-tij-zyrtar/>
<http://betimiperdrejtesi.com/rasti-mtpt-perfundon-deshmine-adem-grabovci-sms-et-e-te-ndjerit-shkodra-i-quan-banal-e-idiot/>
<http://betimiperdrejtesi.com/gjykata-vendos-te-mos-perjashtoj-avokatin-florent-latifaj-nga-rasti-limaj-dhe-te-tjeret/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmon-ish-keshilltari-i-ministrit-limaj-prokurori-ti-ndan-ceshtjet-e-ministrise-nga-ato-partiake/>
<http://betimiperdrejtesi.com/ne-rastin-e-njohur-mtpt-perfundoi-deshmia-e-sterzgjatur-e-ish-keshilltarit-politik-te-fatmir-limajt/>
<http://betimiperdrejtesi.com/ne-gjykimin-ndaj-fatmir-limajt-gjykata-ia-ndalon-prokurorise-te-perdore-provat-e-cilesuara-si-te-pa-pranueshme-mbrojtja-akuzon-prokurorin-se-ka-injoruar-vendimin-e-gjykates-se-apelit/>



Rasti Astrit Haraçija dhe Valton Beqiri: Ish-Ministra të Kulturës

Numri i lëndës: PKR.nr.362/16 (Rigjykim)

“Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”,
“Mashtrimi në detyrë”

Kryetari i Trupit Gjykes: Suzana Çerkini;

Prokuror special: Hivzi Bajraktari

Të pandehurë: Astrit Haraçija; Valton Beqiri; Nehat Fejza; Armond Morina

Avokat/Mbrotjës: Teki Bokshi; Destan Rukiqi; Osman Havolli;

Arianit Koci dhe Granit Vokshi

Ministria e Drejtësisë më 21 shkurt 2011 kishte parashtruar kallëzim penal kundër ish-Ministrave të Kulturës, Astrit Haraçija dhe Valton Beqiri. PTh në Prishtinë më 19 dhjetor 2011 kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj tyre, kurse më 20 prill 2012, kjo prokurori kishte ngritur aktakuzë në ish-Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër dy ish-ministrave Astrit Haraçija e Valton Beqiri, dhe dy producentëve Armond Morina e Nehat Fejza, për veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Mashtrimi në detyrë.

Sipas aktakuzës, ish-ministri Astrit Haraçija ka drejtuar Ministrinë e Kulturës në vitet 2004-2007, ndërsa më 27 shkurt 2006 kishte nënshkruar kontratë me Nehat Fejzën, pronar i kompanisë “Concordia Pictures” për filmin “Ndjekja e Larës”, në vlerë prej 220,000 euro. Më 30 janar 2007, i njëjti nënshkroi një kontratë tjetër me Armond Morinën, pronar i kompanisë “Morina Films” për filmin “Mysafir në sofër”, në vlerë prej 350,000 euro. Ndërkaq, ish-ministri Valton Beqiri që drejtoi Ministrinë e Kulturës në vitet 2008-2010, kishte nënshkruar aneks kontratën me “Morina Films”, duke transferuar 100,000 euro si subvencione për realizimin e filmit “Mysafir në Sofër”. Sipas aktakuzës, Ministria e Kulturës nënshkroi kontrata për këta filma në vlerën totale prej 570,000 eurove, në kundërshtim me Ligjet për Prokurim Publik dhe atë për Kinematografinë.



Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Afërsisht tre vite pas ngritjes së aktakuzës, GjTh në Prishtinë, më 1 dhjetor 2015, kishte shpallur aktgjykimin në lidhje me rastin e dy ish-Ministrave të Kulturës, Astrit Haraqija dhe Valton Beqirit, si dhe ndaj Armond Morinës e Nehat Fejzës. Astrit Haraqija është shpallur fajtor në pikën 2 për “Shpërdorim të pozitës zyrtare”, për të cilën është dënuar me 10 muaj me kusht. Ndërkaq, ish-ministri tjetër i Kulturës, Valton Beqiri, është shpallur fajtor në pikën 3 dhe është dënuar me 10 muaj burgim me kusht. Armond Morina, i akuzuari tjetër i këtij rasti, për “Mashtrim në detyrë”, është dënuar me 6 muaj dënim efektiv. Nehat Fejza është shpallur i pafajshëm sepse, sipas Gjykatës, i njëjti ka realizuar projektin filmik.³⁶

Ky rast është kthyer në rigjykim sipas ankesës së avokatëve mbrojtjes të personave të dënuar nga GjTh në Prishtinë, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore. Rasti i kthyer në rigjykim ka kaluar përmes disa seancave gjyqësore të mbajtura më 6 shtator, 3 nëntor, 11 nëntor (është shtyrë), 22 nëntor (është shtyrë) dhe 13 dhjetor 2016.³⁷

Më 15 dhjetor 2016, GjTh në Prishtinë sërish ka shpallur aktgjykim dënues ndaj dy ish-Ministrave Astrit Haraqija dhe Valton Beqiri dhe dy producentëve Armond Morina dhe Nehat Fejza, të akuzuar për korrupsion. Katër të akuzuarit janë dënuar me nga një vit burgim me kusht, dënim ky i cili nuk do të ekzekutohet nëse të njëjtit nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale gjatë dy viteve në vijim. Sipas aktgjykimit, Armond Morina detyrohet që Ministrisë së Kulturës t’ia paguaj shumën në vlerë prej 100 mijë euro. Ndërkaq Nehat Fejza detyrohet që kësaj ministrie t’ia paguaj shumën në vlerë prej 188 mijë euro. Avokatët mbrojtës kanë paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të kësaj gjykate.

³⁶ Haraqija dhe Beqiri dënohen me nga 10 muaj dënim me kusht, 1 dhjetor 2015, në: <http://archive.koha.net/?id=27&l=86897>

³⁷ Raport monitorimi nga i seancave gjyqësore në rastin kundër Astrit Haraqija dhe Valton Beqiri, në: <http://betimiperdrejtesi.com/ish-kryeministri-bajram-kosumi-deshmon-ne-rastin-e-dy-ish-ministrave-te-kultures-per-keqperdorim-te-detyres/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmon-ish-kryeministri-agim-ceku-ne-rigjykimin-e-ish-ministrave-te-kultures-projektin-kinematografik-e-kam-mbeshitetur-por-nuk-di-nese-ky-eshte-implementuar/>
<http://betimiperdrejtesi.com/gjykata-leshon-urdher-per-sjellje-ne-gjykate-per-ish-ministrin-astrit-haraqija/>
<http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-kunder-dy-ish-ministrave-astrit-haraqija-e-valton-beqiri/>
<http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-kunder-dy-ish-ministrave-te-kultures-astrit-haraqija-dhe-valton-beqiri/>

³⁸ Raport nga monitorimi i seancës gjyqësore lidhur me shpalljen e aktgjykimit në rastin kundër Astrit Haraqija dhe Valton Beqiri, me 15 dhjetor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-nga-nje-vit-burgim-me-kusht-dy-ish-ministrat-e-kultures-astrit-haraqija-dhe-valton-beqiri/>



Rasti Muharrem Shabani: Ish-Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.7/09 Vepra penale: “Vjedhje e rëndë”;

“Shmangie nga tatimi”; “Lidhja e kontratës së dëmshme”;

“Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit”; “Shmangie nga tatimi”

Kryetari i Trupit Gjykses: Burim Ademi

Prokuror: Ismet Ujkani

**I pandehur: Muharrem Shabani, Gëzim Ajredinaj, Tefik Maloku dhe Erzen Kavaja.
Ka qenë i akuzuar edhe M.P. mirëpo i njëjti ka ndërruar jetë.**

Më 13 tetor 2006, Policia e Kosovës kishte ngritur kallëzim penal kundër Muharrem Shabanit, ish-Kryetar i Vushtrrisë. Më 21 janar 2009, kjo prokurori kishte ngritur akatakuze kundër Muharrem Shabanit, Gëzim Ajredinaj, Tefik Maloku dhe Erzen Kavaja. Pjesë e aktakuzës ishte edhe tanimë i ndjeri M.P.

Sipas aktakuzës, Gëzim Ajredinaj akuzohet në cilësi të pronarit të kompanisë “Ndërtimi kompani”, për veprat penale “vjedhje e rëndë” dhe “shmangia nga tatimi”. Ajredinaj akuzohet se ka marrë dhe shfrytëzuar gurë gëlqerorë të vendi i quajtur “Guri i madh”, në fshatin Pasomë, komuna e Vushtrrisë, gjithsej në sasi prej 12.445.84m³ në vlerë totale prej 123,952,00 euro. Ajredinaj, si pronar i kompanisë së lartpërmendur, për të ardhurat e fituara nga sasi të shfrytëzuara të gurit gëlqerorë, nuk i ka dhënë informata organit kompetent tatimor dhe nuk e ka paguar tatimin në të ardhura nga këto sasi të shfrytëzuara të gurit gëlqeror, që kap shumën prej 6,754,00 euro. Tefik Maloku akuzohet se si përfaqësues i personit juridik, pa ndonjë autorizim apo vendim të Bordit të Drejtorëve apo kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Vushtrrisë, në emër të kësaj komune lidhë kontratë me Ajredinajn, për shfrytëzimin e shkëmbit gëlqeror në vendin e quajtur “Guri i madh”. Nga moskryerja e obligimeve të kësaj kompanie të dala nga kontrata të fjalë, Komuna e Vushtrrisë është dëmtuar në vlerë prej 200,000 euro, për çka akuzohet Maloku se ka kryer veprën penale “lidhja e kontratës së dëmshme”. Muharrem Shabani ish-Kryetar i Vushtrrisë akuzohet se ka shpërdorë pozitën e tij, dhe duke i ditur parregullsitë dhe shkeljet e Ligjit mbi Prokurimin gjatë lidhjes së kësaj kontrate dhe aneks kontrate, si dhe zbatimin e saj, nuk ka ndërmarrë veprime brenda autorizimeve të veta të parapara me ligj. Ai akuzohet se nuk e ka penguar lidhjen dhe



zbatimin e kontratës në fjalë, duke e ditur më parë se e njëjta është e dëmshme për Komunën e Vushtrrisë, dhe pronarit të kompanisë i ka sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror. Për nxjerrje të gurëve gëlqerorë akuzohet edhe pronari i firmës “Kavaja kompani”, Erzen Kavaja. Sipas aktakuzës, ai akuzohet se ka kryer veprat penale “vjedhje e rëndë” dhe “shmangie nga tatimi”, pasi ka nxjerrë e shfrytëzuar gurë gëlqerorë në sasi prej 17,074 m³ në vlerë prej 170,957 euro. Ai akuzohet se nuk ka paguar tatimet për të ardhurat për këtë sasi të shfrytëzuar të gurit gëlqeror që kap shumën prej 20,562,00 euro. Në këtë rast ka qenë i përfshirë edhe kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Vushtrrisë, M. P., mirëpo ai ka ndërruar jetë. I ndjeri akuzohej për veprën penale “shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit”.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar lidhur me këtë rast ishte caktuar mbi 6 vite pas ngritjes së aktakuzës, respektivisht më 25 maj 2015, kurse shqyrtimi kryesor është caktuar me mbi një vit vonesë apo më 16 qershor 2016, e cila seancë është shtyrë. Deri në fund të vitit 2016, nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore në këtë rast.



Rasti Nenad Cvetković: Ish-Kryetar i Komunës së Parteshit

Gjykata Themelore në Gjilan
Numri i lëndës: PKR.nr.47/14
Vepra penale: "Dhënia e rryshfetit".

Kryetari i Trupit Gjykes: Aziz Shaqiri
Prokuror: Afrim Shefkiu
I pandehur: Nenad Cvetković

Policia e Kosovës më 16 dhjetor 2013, kishte parashtruar kallëzim penal ndaj Nenad Cvetković ish-Kryetarit të Komunës së Parteshit. PTh në Gjilan më 5 shkurt 2014, kishte marr aktvendim për fillim të hetimeve, kurse me datë 27 shkurt 2014, kjo prokurori kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Gjilan, kundër të njëjtit për veprën penale "Dhënie e rryshfetit". Sipas aktakuzës, Nenad Cvetković akuzohet se në kohën e heshtjes parazgjedhore, për kandidat për Kryetar të Komunës së Parteshit, ka shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit Tomisllava Zhivković, dhe nga ai ka kërkuar që me familjen e tij mos të dalin në zgjedhje. Këtë e ka bërë edhe përkundër faktit se e kishte ditur se i ai kishte qenë pjesëtar i subjektit politik GIS, dhe për këtë i ka dorëzuar një kartëmonedhë prej 50 euro, të cilën e kishte lënë mbi kanape. Cvetković kishte kërkuar nga Zhivković që t'ia dorëzoj të gjitha letërnjoftimet, atë të bashkëshortes dhe tre fëmijëve të tij.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar në këtë rast është caktuar më 20 qershor 2016, apo me vonesë prej më shumë se dy viteve nga afati ligjor i përcaktuar me KPPK. Shqyrtimi kryesor në këtë lëndë është caktuar pothuajse pas 5 muajve, respektivisht me 1 dhjetor 2016 dhe 11 janar 2017.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Konfiskimi i kartëmonedhës prej 50 euro

Rasti Emrush Thaçi: Ish-Drejtor i Burgjeve bashkë me 23 persona tjerë



Prokurori i EULEX-it në PSRK më 17 nëntor 2016, ka ngritur aktakuzë ndaj Emrush Thaçit dhe 23 personave të tjerëve, në lidhje me vepra penale të kryera gjatë gjykimit të rastit 'Drenica'. Njëzetë e katër të pandehur akuzohen për një numër veprash që kanë të bëjnë me trajtimin e të burgosurve nga ana e Shërbimit Korrektues të Kosovës, ikjen e të burgosurve nga Spitali i Prishtinës në maj të vitit 2014, kujdesin mjekësor që iu është dhënë disa të burgosurve, dhe kërcënimin e dëshmitarëve gjatë gjykimit të rastit 'Drenica'. Në këtë rast, 11 pjesëtarë të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe një mjek përballen me akuzën e "keqpërdorimit të pozitës apo autorizimit zyrtar" dhe akuzën e "lirimit të paligjshëm të personave të privuar nga liria". Ikja e të burgosurve dhe keqpërdorimi i kujdesit mjekësor që iu është ofruar disa të burgosurve po ashtu janë të përfshira në këtë aktakuzë të ngritur.³⁹

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Edhe pse aktakuza është ngritur më 17 nëntor 2016, edhe katër muaj pas ngritjes së saj, nuk është caktuar shqyrtimi fillestar lidhur me këtë rast që është duke u trajtuar nga EULEX-i. Afatet ligjore lidhur me këtë rast janë shkelur nga EULEX-i për më shumë se tre muaj.

Sekuestrimit dhe Konfiskimi

Nuk ka kërkesa.

³⁹ Komunikatë për media nga Prokurori i Shtetit me 17 nëntor 2016, në: <http://www.psh-ks.net/sq/lajme/psrk-ja-ngrite-aktakuze-per-nje-rast-ku-perfshihen-veprat-keqperdorim-i-pozites-apo-autorizimeve-zyrtare-ikja-e-personave-te-privuar-nga-liria-mundesimi-i-ikjes-se-personave-te-privuar-nga-liria-lirimi-i-paligjshem-i-personave-te-privuar-nga-liria-pengimi-i-deshmive-apo-i-procedurave-zyrtare-kercenimi-gjate-procedurave-penale-dhe-pjesemarrja-ne-grup-te-organizuar-kriminal-apo-organizimi-i-grupit-te-organizuar-kriminal>



Rasti Enver Hasani 1: Ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.14/16

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”
dhe “falsifikim i dokumentit zyrtar”.

Kryetari i Trupit Gjykses: Shashivar Hoti

Prokuror: Abdurrahim Islami

I pandehur: Enver Hasani

Avokat: Bajram Tmava

Më 14 prill 2015, ishte ngritur kallëzim penal kundër Enver Hasanit, ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Në të njëjtën ditë më 14 prill 2015, PSRK kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të njëjtit. Më 13 janar 2016, PSRK ka ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë, kundër Enver Hasanit për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Falsifikim i dokumentit zyrtar”. Enver Hasani akuzohej për vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me Dekretin e Presidentes rreth vazhdimit të mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë. Sipas kësaj aktakuze, në kohën kur ishte Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, Hasani akuzohej se kishte shënuar emrin e gjyqtarit Robert Carolan edhe pse ky i fundit nuk kishte marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje, ngase bëhej fjalë edhe për vazhdimin e mandatit të tij.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Karakteristikë e këtij rasti është ndërrimi i shpeshtë i prokurorëve, respektivisht këtë rast nga fillimi deri në fund e kanë trajtuar tre prokurorë nga PSRK, Blerim Isufaj, Drita Hajdari dhe Abdurrahim Islami. Edhe në këtë rast obligimi ligjor për caktimin e shqyrtimit fillestar brenda 30 dite pas ngritjes së aktakuzës është shkelur. Respektivisht, shqyrtimi fillestar në këtë çështje është caktuar më 1 korrik 2016, apo mbi 5 muaj pas ngritjes së aktakuzës. Seanca e caktuar më 1 korrik 2016, është shtyrë për shkak të mungesës së Prokurorit.⁴⁰ Lidhur me këtë rast janë mbajtur edhe dy seanca gjyqësore lidhur me shqyrtimin fillestar më datat 15 korrik dhe 8 shtator 2016. Në seancën e mbajtur më 8 shtator 2016, Enveri Hasani para trupit gjykses ka deklaruar se rasti ndaj tij është “është hakmarrje ordinere e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi dhe

⁴⁰ Raport nga monitorimi i Shqyrtimit fillestar në rastin kundër Enver Hasani, 1 korrik 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/mungon-prokurori-shtyhet-seanca-ndaj-enver-hasanit/>



shefave të tij, për shkak se Gjykata Kushtetuese e kishte rrëzuar procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit Lumezi”.⁴¹

Shqyrtimi i dytë në rastin kundër Enver Hasanit është mbajtur më 11 tetor 2016. Në këtë seancë gjyqësore, mbrojtësi i të akuzuarit, avokati Bajram Tmava gjatë kundërshtimit të aktakuzës kundër klientit të tij ka bërë të ditur se vendimin të cilin e kishte marrë Hasani në kohën kur ishte kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është vendosur në frymën e Kushtetutës së Kosovës si dhe ligjeve në fuqi.⁴²

Më 10 janar 2017, Gjykata e Apelit e Kosovës ka hudhur poshtë aktakuzën e ngritur ndaj ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani veprat penale “keqpërdorim të detyrës zyrtare” dhe “falsifikim të dokumentit zyrtar”. Përfaqësuesi i ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, avokati Bajram Tmava ka thënë se Gjykata e Apelit e ka aprovuar në tërësi ankesën kundër aktvendimit të GjTh në Prishtinë dhe se pushimi i procedurës penale ndaj klientit të tij është bërë pasi Gjykata e Apelit ka vlerësuar se të gjitha veprimet e ndërmarra nga Hasani kanë qëndruar në kuadër të autorizimeve të tij si kryetar i Gjykatës Kushtetuese.⁴³

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka kërkesa.

⁴¹ Raport nga monitorimi i seancës gjyqësore kundër Enver Hasanit, 8 shtator 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/enver-hasani-kjo-aktakuze-eshte-hakmarrje-e-kryeprokurorit-aleksander-lumezi/>

⁴² Raport nga monitorimi i Shqyrtimit të dytë në rastin kundër Enver Hasanit, 11 tetor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/avokati-i-enver-hasanit-ne-asnje-presje-nuk-kam-gjetur-veprim-antiligjor-te-te-mbrojturit-tim/>

⁴³ Raport nga monitorimi i rastit kundër Enver Hasanit, 10 janar 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/hudhet-aktakuza-ndaj-ish-kryetarit-te-gjykates-kushtetuese-enver-hasani/>



Rasti Enver Hasani 2: Ish-Rektor i Universitetit të Prishtinës

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.432/15

Vepra penale: "Mashtrimi në detyrë"

Kryetari i Trupit Gjykes: Afërdita Bytyqi

Prokurore: Drita Hajdari

I pandehur: Enver Hasani, Hakif Veliu dhe Albert Rakipi

Më 25 korrik 2012, Policia e Kosovës kishte parashtruar kallëzim penal kundër Albert Rakipit dhe Hakif Velikut, lidhur me dyshimet për keqpërdorime në Universitetin e Prishtinës. Më 9 janar 2014, PTh në Prishtinë kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve kundër Albert Rakipit dhe Hakif Velikut. Kjo lëndë ishte hetuar nga një ekipë e prokurorëve të EULEX-it dhe PTh në Prishtinë. EULEX-i më 12 gusht 2014 këtë lëndë e kishte transferuar në PTh në Prishtinë. Ndërsa, PTh në Prishtinë më 21 nëntor 2014 ia kishte transferuar këtë lëndë PSRK-së. Drita Hajdari prokurore e kësaj prokurorie, më 14 prill 2015, kishte nxjerrë vendim për zgjerim të hetimeve, duke e përfshirë edhe Enver Hasanin si ish-Rektor të UP-së. Vlen të theksohet se aso kohe, zhvillohej gara për Kryeprokuror të Shtetit, ku Gjykata Kushtetuese në krye me Enver Hasanin, kishte rrëzuar procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, në të cilin ishte zgjedhur kandidati Aleksandër Lumezi. Aso kohe, një pjesë e anëtarëve të KPK-së kishte zhvilluar "luftë" publike me Gjykatën Kushtetuese për procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit. Dhe posa Gjykata Kushtetuese kishte hapur rrugë për dekretimin e Kryeprokurorit Lumezi, ndaj Enver Hasanit, në të njëjtën ditë, më 14 prill 2015, PSRK kishte nxjerrë dy vendime për fillimin e hetimeve kundër tij. Njëri në rastin kur kishte qenë Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, ndërsa tjetri për kohën sa kishte qenë Rektor i UP-së. Në këtë të fundit, aktakuza kundër Enver Hasanit ishte ngritur më 31 korrik 2015 për vepra penale të korrupsionit. Sipas aktakuzës, Enver Hasani akuzohet se në cilësinë e Rektorit të UP-së, Haki Veliu në cilësi të Shefit të Zyrës së Prokurimit në UP dhe Albert Rakipi në cilësi të Drejtorit të Institutit për Studime Ndërkombëtare (ISN) me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për këtë Institut, kishin falsifikuar kontratën origjinale lidhur me përkthimin e disa librave nga gjuha angleze në atë shqipe dhe kishin hartuar një kontratë të re, duke shfrytëzuar numrin e njëjtë të protokollit nga kontrata origjinale. Sipas kontratës origjinale, vlera e saj kishte qenë 500.000 euro, përkatësisht çmimi i pagesës për njësi 1000 fjalë 12.65 euro e stipuluar me nenin 17, ndërsa në kontratën e re sipas prokurorisë, kjo pjesë është ndryshuar në 1000 karaktere për 12.56 euro.

⁴⁴ Raport nga monitorimi i seancës gjyqësore kundër Enver Hasanit, 8 shtator 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/enver-hasani-kjo-aktakuze-eshte-hakmarrje-e-kryeprokurorit-aleksander-lumezi/>



Shkelja e afateve ligjore:


Edhe në këtë rast, shqyrtimi fillestar në GjTh në Prishtinë është caktuar me vonesë, duke shkelur afatet ligjore të përcaktuara me KPPK. Respektivisht, shqyrtimi fillestar në këtë rast është caktuar afërsisht pesë muaj pas ngritjes së aktakuzës më 27 nëntor 2015. Shqyrtimi i dytë lidhur me këtë rast është mbajtur më 11 janar 2016. Shqyrtimi kryesor në rastin kundër Enver Hasanit dhe të tjerëve është caktuar më 18 shkurt 2016, e cila seancë është shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarit Albert Rakipi.⁴⁵ Në këtë rast trupi gjykues i ka mbajtur katër seanca gjyqësore më 9 mars, 8 prill, 3 maj dhe 20 maj 2016.⁴⁶ Nga 20 maj 2016 deri në fund të muajit mars 2017, trupi gjykues nuk ka mbajtur asnjë seancë gjyqësore lidhur me këtë rast. Një qasje e tillë e trupit gjykues bie në kundërshtim me nenin 314 të KPPK, i cili përcakton se kohën për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. “Përveç në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shtyn shqyrtimin gjyqësor nga neni 310 i këtij Kodi, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda këtyre afateve kohore: nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda njëqindnjëzet (120) ditësh, përveç nëse trupi gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjë prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni. 2. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet me aktvendimin të arsyetuar nga paragrafi 1. i këtij neni kur ekzistojnë rrethana të cilat kërkojnë më shumë kohë”. Nga 20 maji 2016 deri në fund të muajit mars 2017, kanë kaluar afërsisht 300 ditë nga seanca e fundit gjyqësore në këtë rast, që hyn në kuadër të profilit të lartë të korrupsionit. Ky rast dëshmon vullnetin e vërtetë të organeve të drejtësisë për të trajtuar me prioritet rastet e korrupsionit. Po ashtu, mos caktimi i seancave gjyqësore në raste të profilit të lartë në publik perceptohet më shumë si persekutim dhe shantazh ndaj personave subjekt të këtyre procedurave penale të korrupsionit se sa ndjekje dhe gjykim i drejtë, paanshëm dhe i pavarur.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka kërkesa.

⁴⁵ Raport nga monitorimi i rastit nr. 2, kundër Enver Hasanit dhe të tjerëve, 18 shkurt 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-gjykimi-kunder-enver-hasanit/>

⁴⁶ Raportet e monitorimit nga seancat gjyqësore kundër Enver Hasanit dhe të tjerëve, në: <http://betimiperdrejtesi.com/hapet-shqyrtimi-kryesor-per-keqperdorimet-e-pretenduar-ne-up/>
<http://betimiperdrejtesi.com/enver-hasani-do-te-mbrohet-ne-heshtje/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmon-sekretari-i-pergjithshem-i-up-se-ne-rastin-e-enver-hasanit/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmon-ekspertja-ferdeze-tershnjaku-per-rastin-e-enver-hasanit/>



Rasti Mazllum Baraliu: Ish-Rektor i Universitetit Publik të Prizrenit

Gjykata Themelore në Prizren

Numri i lëndës: PKR.nr.195/15

Vepra penale: "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar"

Kryetari i Trupit Gjykses: Skender Çoçaj

Prokuror: Sefer Morina

I pandehur: Mazllum Baraliu, Adem Sallauka dhe Halim Hazëraj

Policia e Kosovës më 4 shkurt 2014 kishte parashtruar kallëzim penal kundër Mazllum Baraliut, Rektor i Universitetit të Prizrenit dhe dy të tjerëve. PTh në Prizren më 1 dhjetor 2014 kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve, kurse më 22 tetor 2015 kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Gjakovë, kundër Mazllum Baraliu, Adem Sallauka dhe Halim Hazëraj, për veprën penale "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar". Sipas aktakuzës, të akuzuarit duke punuar në Universitetin e Prizrenit, i kanë shkelur të drejtat e të dëmtuarit, Enver Sopjani, të cilit ia kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, megjithëse kishte kontratë valide të lëshuar nga UPZ-ja. Sopjani kishte kontratë valide prej datës 10.06.2011, deri më 09.06.2014, në pozitën e Prorektorit të UPZ-së, por në mënyrë të njëanshme, me vendimin të lëshuar nga Rektori i asaj kohe, Mazllum Baraliu, e të nënshkruar nga Adem Sallauka dhe Halim Haziraj, i ishte ndërprerë kontrata e punës në tetor 2011.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar në këtë rast është caktuar me vonesë prej dy muajsh nga dita e ngritjes së aktakuzës, respektivisht më 21 dhjetor 2015, kurse shqyrtimi i dytë është mbajtur më 21 janar 2016. Shqyrtimi kryesor në këtë rast poashtu është caktuar me vonesë prej mbi katër muajsh, më 4 maj 2016, e cila seancë ishte shtyrë. Në rastin kundër Mazllum Baraliut dhe dy të tjerëve gjykata ka mbajtur seancat gjyësore më 6 qershor, 7 qershor, 12 korrik, 3 nëntor, 4 nëntor dhe 15 nëntor 2016.

⁴⁷ Raporte nga monitorimi i seancave gjyqësore në rastin kundër Mazllum Baraliut dhe të tjerëve, në: <http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-gjyqesore-per-rastin-e-ish-rektorit-te-universitetit-publik-te-prizrenit/> <http://betimiperdrejtesi.com/mungon-i-demtuari-shtyhet-gjykimi-ne-rastin-ndaj-ish-rektorit-te-upz-se/> <http://betimiperdrejtesi.com/mbrohet-mazllum-baraliu-nuk-kam-pasur-asnjelidhje-me-kontraten-e-enver-sopjanit/> <http://betimiperdrejtesi.com/halim-haziraj-ka-mbrojtur-vendimin-per-shkarkimin-nga-detyra-te-prorektorit-te-universitetit-te-prizrenit/>



Më 16 nëntor 2016, në GjTh në Prizren, është shpallur aktgjykimi me të cilin janë liruar Baraliu dhe Sallauka, ndërsa është dënuar Haziraj. Ish-Rektori i Universitetit Publik të Prizrenit, Mazllum Baraliu, është liruar nga akuza e keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Poashtu është liruar nga akuza e njëjtë edhe Adem Sallauka. Ndërsa i akuzuari i tretë, Halim Haziraj është shpallur fajtor. Trupi gjykues, ka shpallur fajtor të akuzuarin Halim Haziraj dhe të njëjtin e ka dënuar me një vit burgim. Ky dënim me burgim, nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit të verifikimit prej dy vitesh, i njëjti nuk kryen vepër të re penale. Poashtu ndaj Halim Hazirajt është shqiptuar dënim plotësues – mos ushtrim i funksioneve publike në afat prej dy vitesh.⁴⁸

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka kërkesa.

<http://betimiperdrejtesi.com/adem-sallauka-thote-se-nuk-ka-pasur-njohuri-per-shkarkimin-e-prorektorit-te-universitetit-te-prizrenit/>

<http://betimiperdrejtesi.com/perfundon-shqyrtimi-gjyqesor-ndaj-ish-rektorit-mazllum-baraliu/>

⁴⁸ Raporte nga monitorimi i seancave gjyqësore në rastin kundër Mazllum Baraliut dhe të tjerëve, në <http://betimiperdrejtesi.com/mazllum-baraliu-lirohet-nga-akuza-per-keqperdorim-te-detyres-zyrtare/>



Rasti Shpresa Bakija: Kryeprokurore e Prokurorisë Themelore në Gjakovë

Gjykata Themelore në Gjiilan

Numri i lëndës: PKR.nr.156/15

Vepra penale: "Zbulimi i fshehtësisë zyrtare" dhe "cënimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe bazës së të dhënave kompjuterike"

Kryetari i Trupit Gjykses: Naser Maliqi

Prokurore: Agron Uka

I/E pandehur: Shpresa Bakija dhe Arben Arifi

Më 20 tetor 2014, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të kishte parashtruar kallëzim penal lidhur me dyshimin e kryerjes së veprës penale "Zbulimi i fshehtësisë zyrtare" dhe "Cënimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe bazës së të dhënave kompjuterike", për një rast në Prokurorinë Themelore në Gjakovë. Më 10 nëntor 2014, PTh në Gjiilan kishte nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve, ndërsa më 19 qershor 2015, kjo prokurori kishte ngitur aktakuzë kundër Kryeprokurores së PTh në Gjakovë, Shpresa Bakija dhe Arben Arifit. Sipas aktakuzës, Shpresa Bakija, në muajin qershor 2012, në cilësi të personit zyrtar, pa autorizim i ka vënë në dispozicion personit tjetër informatën që përbën fshehtësi zyrtare. Sipas PTh në Gjiilan, Bakija këtë e ka bërë me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin, apo të shkaktimit të dëmit personit tjetër, të dëmtuarës Xh.K. Sipas aktakuzës, e pandehura këtë e ka bërë në atë mënyrë që avokatit Gëzim Baloku i'a ka dhënë tabulatet e mesazheve (sms) të siguruar në lëndën PPN.5/2012 të nxjerra përmes masave të fshehta, të cilat më pas i njëjti i'a ka përcjellë personit të paautorizuar, në rastin konkret të pandehurit tjetër Arben Arifit, në kompensim prej 250 euro. Në këtë rast pretendohet se është dëmtuar dhe cenuar rëndë integriteti i të dëmtuarës.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Përderisa aktakuza ishte ngritur më 19 qershor 2015, shqyrtimi fillestar në këtë rast është caktuar me vonesë prej më shumë se pesë muajsh, respektivisht më 2 dhjetor 2015. Në ndërkohë KPK, më 5 nëntor 2015, kishte suspenduar Kryeprokuroren Shpresa Bakija nga të gjitha funksionet e saj prokuroriale.⁴⁹

Shqyrtimi i dytë në këtë rast është mbajtur më 12 shkurt 2016. Përderisa, shqyrtimi kryesor është mbajtur përmes seancave gjyqësore më 19 prill dhe 31 maj 2016.

⁴⁹ Suspendohet kryeprokuroerja e Gjakovës, Shpresa Bakija, Koha Ditore, 29 tetor 2016, në: <http://archive.koha.net/?id=8&l=81777>



Më 16 qershor 2016, GjTh në Gjilan ka shpallur aktgjykim lirues kundër Shpresa Bakija, ndërsa në rastin kundër Arben Arifit gjykata ka refuzuar aktakuzën për shkak të parashkrimit.

Më 2 nëntor 2016, Gjykata e Apelit në Prishtinë e ka vërtetuar aktgjykimin lirues të GjTh në Gjilan, ndaj ish-Kryeprokurores Shpresa Bakija, duke liruar atë nga akuzat se ka kryer veprat penale “shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit”, “zbulimi i fshehtësisë zyrtare” dhe “cënimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe bazave të të dhënave kompjuterike”. Në vendimin e Gjykatës së Apelit të marrë më 17 tetor 2016, thuhet se kërkesa e PTh në Gjilan për anulimin e aktgjyimit të marrë më 16 maj, është e pabazuar. Sipas këtij vendimi, pretendimet e kësaj prokurorie lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal nuk qëndrojnë, dhe se aktgjykimi i ankumuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe konkret. Madje, sipas kësaj Gjykate një aktgjykim i tillë as nuk vihet në dyshim.⁵⁰

KPK më 30 nëntor 2016, ka miratuar Vendimin me numër: 470/2016, për kompenzimin e të ardhurave personale për ish-Kryeprokuroren Shpresa Bakija, për kohën sa ka qenë e suspenduar nga të gjitha funksionet prokuroriale me vendim të Komisionit Disiplinor të KPK-së.

Për më tepër në konferencën vjetore të prokurorëve të shtetit për vitin 2016, të organizuar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit më 28 janar 2017, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka ndarë mirënjohje për kontributet e veçanta të dhëna në rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë për kryeprokurorët që kanë kontribuar për sistemin prokurorial gjatë vitit 2016. Mirënjohje iu është ndarë edhe ish-Kryeprokurores së PTh në Gjakovë, Shpresa Bakija e akuzuar pa bazë nga PTh në Gjilan, dhe edhe Kryeprokurorit të PTh në Gjilan, Jetish Malokut.⁵¹

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka kërkesa.

⁵⁰ Raport nga monitorimi i rastit kundër Shpresa Bakija, 2 nëntor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktgjykimin-e-gjykatës-themlore-ne-gjilan-liron-nga-te-gjitha-akuzat-ish-kryeprokuroren-shpresa-bakija/>

⁵¹ Konferenca vjetore e prokurorëve të shtetit, në: <http://www.psh-ks.net/sq/lajme/eshte-mbajtur-konferenca-vjetore-e-prokurorëve-te-kosoves>



Rasti Ilir Tolaj: Ish-Sekretar i Përherëshëm i Ministrisë së Shëndetësisë

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.382/15

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Kryetari i Trupit Gjykses: Valbona Musliu-Selimaj

Prokuror special: Admir Shala

I/E pandehur: Ilir Tolaj, Bekim Fusha, Zenel Kuqi, Valentina Haxhija-Pacolli, Remzije Thaçi, Florije Tahiri. Kanë qenë të përfshirë edhe Arion Lleshi dhe Shpend Agani, por të njëjtit kanë arritur marrëveshje për praninë të fajësisë.

PSRK më 23 prill 2013, kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve në rastin kundër Ilir Tolaj, ish Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të tjerëve. Më 6 korrik 2013, PSRK kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë, kundër Ilir Tolaj, Bekim Fusha, Zenel Kuqi, Valentina Haxhijaj, Remzije Thaçi dhe Florije Tahiri për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Sipas PSRK, Ilir Tolaj si Sekretar i Përherëshëm në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Bekim Fusha si ushtrues i detyrës së Drejtorit të Departamentit Farmaceutik në MSH dhe Zenel Kuqi si menaxher i Prokurimit në MSH, gjatë periudhës kohore 23 maj 2011 deri më 31 dhjetor 2011, në bashkëveprim i kanë sjellë përfitime kompanisë “KMI” SHPK Drenas me pronar Arian Lleshin dhe Shpend Aganin në vlerë prej 400 mijë euro. Valentina Haxhijaj, Remzije Thaçi dhe Florije Tahiri akuzohen se si anëtare të Komisionit për Mbikëqyrjen e Ekzekutimit të kontratës, pretendohet se i kanë mundësuar kompanisë “KMI” të bëjë manipulim me sasinë e barërave. Me këtë në vazhdimësi ato akuzohen se kanë kryer veprën penale të “keqpërdorimit të pozitës zyrtare”. Zenel Kuqi akuzohet se si menaxherit i prokurimit gjatë periudhës ndërmjet 23.05.2011 dhe 31.12.2011 i ka tejkalluar kompetencat me qëllim të përfitimit të dobisë materiale nga kompania “ACG dhe “Standart”, për aktivitetin e prokurimit “Renovimi gjeneral i aneksit të Emergjencës ekzistuese në QKUK”, kompania “Alb Architect” në aktivitetin e prokurimit “Renovimi gjeneral dhe adaptimi i katit përdhes në Klinikën Interne, në repartin e ri për dializë në QKUK”, dhe kompania “Life Farm” për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me infuzione”, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës në vlerën totale 276.307.97 eurove.

Në aktakuzën e njëjtë ishin të përfshirë edhe dy biznesmenët Arion Lleshi dhe Shpend Agani, mirëpo të dy kishin arritur marrëveshje për praninë e fajësisë me prokurorin. Si rrjedhojë, gjykata kishte shpallur fajtor dy biznesmenët, duke i dënuar me nga dy vjet



burg me kusht dhe me nga 1000 euro gjobë. Sipas aktgjykimit të GjTh në Prishtinë, të njëjtit poashtu obligohen që t'i kthejnë shtetit dëmin e shkaktuar prej 400 mijë eurove.

Sipas prokurorisë Lleshi dhe Agani akuzoheshin se kanë bërë paraqitje të rreme apo kanë fshehur fakte, gjë kjo e cila ka rezultuar në dëmtimin e buxhetit të MSH-së si dhe të njëjtit i janë shmangur pagimit të tatimeve dhe kontributeve të tjera për punëtorë të përcaktuara me ligj.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar në rastin kundër Ilir Tolaj dhe të tjerëve ishte caktuar në GjTh në Prishtinë me vonesë prej katër muajsh, respektivisht ishte caktuar më 8 dhjetor 2015. Kjo seancë ishte shtyrë dhe ishte mbajtur vetëm më 20 janar 2016. Shqyrtimi i dytë në këtë rast është mbajtur më 26 shkurt 2016.⁵²

Edhe shqyrtimi kryesor në këtë rast është caktuar me vonesa, respektivisht mbi gjashtë muaj pas shqyrtimit të dytë më 9 shtator 2016. Kjo seancë ishte shtyrë për 15 shtator 2016. Në shqyrtimin kryesor lidhur me këtë lëndë janë mbajtur seancat gjyqësore më 14 tetor dhe 1 dhjetor 2016, 26 janar dhe 21 shkurt 2017. Seanca e caktuar më 20 mars 2017, ish-sekretarit të përhershëm të MSH-së, Ilir Tolajt dhe zyrtarëve tjerë të kësaj Ministrie, është shtyrë me kërkesë të prokurorit special, Abdurrahim Islami.⁵³ Ky rast ende është në procedurë gjyqësore.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Dy biznesmenët Arion Lleshi dhe Shpend Agani, kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sipas aktgjykimit shtetit do t'ia kthejnë dëmin e shkaktuar prej 400 mijë eurove.

⁵² Raport nga monitorimi i rastit kundër Ilir Tolaj dhe të tjerëve, në: <http://betimiperdrejtesi.com/ish-zyrtaret-e-ministrise-se-shendetesise-kundershtojne-akuzat-ndaj-tyre/>

<http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-shqyrtimi-gjyqesor-ndaj-ilir-tolajt-dhe-te-tjereve-per-keqperdorim-te-detyres/>

<http://betimiperdrejtesi.com/rasti-tolaj-dhe-te-tjere-avokati-berisha-ne-nje-sistem-normal-klienti-im-do-duhej-te-ishte-ne-cilesine-e-te-demtuarit/>

<http://betimiperdrejtesi.com/ish-ministri-ferid-agani-deshmon-ne-gjykimin-ndaj-ish-sekretarit-te-msh-se-ilir-tolaj/>

<http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-shqyrtimi-gjyqesor-ndaj-ish-sekretarit-te-msh-se-ilir-tolaj-dhe-te-tjereve/>

<http://betimiperdrejtesi.com/ne-gjykimin-ndaj-ilir-tolajt-drejtori-per-buxhet-dhe-financa-ne-ministrine-e-shendetesise-thote-se-i-gjithe-aktiviteti-i-prokurimit-per-avgjesimin-e-barnave-ishte-zhvilluar-sipas-ligjit/>

⁵³ Raport nga monitorimi i shqyrtimit kryesor në rastin kundër Ilir Tolaj dhe të tjerëve, 20 mars 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-gjykimi-ndaj-ilir-tolajt-dhe-zyrtareve-tjere-te-msh-se/>



Rasti Shyqyri Haxha: Ish-Kryeshef Ekzekutiv i PTK-së

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.666/14

Vepra penale: "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar"

Kryetari i Trupit Gjykses: Valbona Musliu-Selimaj
Prokurore: Fikrije Fejzullahu
I pandehur: Shyqyri Haxha

Rasti kundër Shyqyri Haxha ish-Kryeshefit Ekzekutiv në Postë Telekomunikacionin e Kosovës (PTK), ishte inicuar përmes kallëzimit penal të parashtruar më 19 dhjetor 2012. Aktvendimi për fillimin e hetimeve ishte nxjerr më 14 tetor 2014, ndërsa aktakuza ishte ngritur më 27 nëntor 2014.

Shyqyri Haxha akuzohej se gjatë viteve 2009-2011, si Kryeshef ka zbatuar Rezolutën e Bordit të Drejtorëve të PTK-së, përkatësisht ka mbuluar shpenzimet e qirasë për stafin e PTK-së që jetojnë jashtë Kosovës. Në këtë mënyrë, sipas aktakuzës, kishte përfituar në mënyrë të kundërligjshme pagesën e qirasë si dhe të ngarkesave tjera të cilat kanë një vlerë prej 2000 euro për çdo muaj, e cila në total arrinin shumën prej 53.000 eurove.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar në rastin kundër Shyqyri Haxhës, ishte caktuar më 9 nëntor 2015 dhe 16 dhjetor 2015. Të dy këto seanca gjyqësore ishin shtyrë. Përfundimisht shqyrtimi fillestar ishte mbajtur më 7 mars 2016.⁵⁴ Shqyrtimi i dytë lidhur me këtë rast është mbajtur më 8 prill 2016.

⁵⁴ Raport nga monitorimi i shqyrtimit fillestar në rastin kundër Shyqyri Haxha, 7 mars 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/ish-kryeshefi-ekzekutiv-i-ptk-se-shyqyri-haxha-deklarohet-i-pafajshem/>



Në rastin kundër Shyqyri Haxhës, gjykata ka mbajtur disa seanca gjyqësore gjatë shqyrtimit kryesor, respektivisht më 3 qershor, 6 shtator, 11 tetor, 1 nëntor dhe 2 nëntor 2016.⁵⁵

GjTh në Prishtinë më 4 nëntor 2016, kishte marr Aktgjykim përmes së cilit, Shyqyri Haxha, ishte shpallur i pafajshëm. Haxha u lirua nga akuza për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”, pasi që sipas trupit gjykues, nuk janë gjetur prova se Haxha, me veprimet e veta ka shkaktuar veprën penale siç ceket në aktakuzë.⁵⁶

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka pasur kërkesa.

⁵⁵ Raporte nga monitorimi i rastit kundër Shyqyri Haxha në shqyrtim kryesor, në: <http://betimiperdrejtesi.com/deshmitaret-miratimi-i-kerkeses-se-kryeshefit-te-ptk-se-shyqyri-haxha-ishte-vendim-i-ligjshem/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-nuk-ka-haber-per-rastin-ne-te-cilin-eshte-thirrur-te-deshmoi/>
<http://betimiperdrejtesi.com/ne-rastin-e-ish-drejtorit-te-ptk-se-shyqyri-haxha-deshmon-drejtori-i-zyres-ligjore-sabaudin-ramaxhiu/>
<http://betimiperdrejtesi.com/jepet-fjala-perfundimtare-ne-rastin-e-ish-drejtorit-te-ptk-se-shyqyri-haxha-aktakuza-ndaj-meje-u-ngrite-vetem-tri-dite-para-se-te-shpallet-konkursi-per-drejtor/>

⁵⁶ Raport nga monitorimi i rastit kundër Shyqyri Haxha, shpallja e aktgjykimit, 4 nëntor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-ish-kryeshefi-i-ptk-se-shyqyri-haxha/>



Rasti Ragip Begaj: Kryetar i Komunës së Malishevës

Gjykata Themelore në Gjakovë

Numri i lëndës: PKR.nr.205/15

Vepra penale: "Shpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit"

Kryetari i Trupit Gjykses: Shaqir Zika
Prokuror: Haki Gecaj
I pandehur: Ragip Begaj

Më 16 shkurt 2015, ishte inicuar kallëzim penal ndaj Kryetarit të Malishevës, Ragip Begaj. PSRK më 3 shtator 2015, kishte nxjerr aktvendim për fillim të hetimeve, kurse e njëjta prokurori më 8 dhjetor 2015 kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Gjakovë, kundër Ragip Begaj, për veprën penale "Keqërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar". PSRK e ngarkonte Kryetarin Ragip Begaj, se në periudhën qershor-gusht 2014, kishte shpërdorur pozitën zyrtare apo autorizimet. Sipas aktakuzës kjo ishte bërë me qëllim që t'i shkaktoj dëm dhe t'ia shkelë të drejtat në marrëdhënien e punës të dëmtuarit Shemsi Morina. Sipas aktakuzës, edhe përkundër faktit se i dëmtuari Shemsi Morina, kishte kontratë për punët dhe detyrat e punës si Drejtor në SHFMU "Ganimete Tërbeshi", e vlefshme deri më 1 tetor 2015, i pandehuri me dashje dhe me dijeni kishte shkelur dispozitat e Ligjit të Punës, duke shpallur konkursin për drejtor të shkollës, kurse të dëmtuarit iu kishte ndërprerë marrëdhënia e punës.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar në rastin kundër Kryetarit të Komunës së Malishevës ishte caktuar më 19 janar 2016, kurse shqyrtimi i dytë më 22 shkurt 2016. Shqyrtimi kryesor në këtë rast ishte caktuar më 18 maj 2016, e cila ishte shtyrë për 30 maj 2016. Në shqyrtimin kryesor në këtë rast janë mbajtur seanca gjyqësore edhe 10 qershor, 7 korrik dhe 13



korrik 2016.⁵⁷ GjTh në Gjakovë më 14 korrik 2016, ka shpallur aktgjykim ku Kryetari Ragip Begaj, është shpallur i pafajshëm për veprën penale “shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit. Sipas këtij aktgjykimi, nga provat e administruara dhe deklaratat e dëshmitarëve, nuk është provuar se është kryer vepra penale në fjalë.⁵⁸

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka pasur kërkesa.

⁵⁷ Raporte nga monitorimi i seancave gjyqësore në rastin kundër Ragip Begaj, në: <http://betimiperdrejtesi.com/kundershtohet-hudhja-e-aktakuzes-kunder-kryetarit-te-malisheves-ragip-begaj/>
<http://betimiperdrejtesi.com/drejt-fundit-gjykimi-kunder-kryetarit-te-malisheves-ragip-begaj/>
<http://betimiperdrejtesi.com/jepen-fjalet-perfundimtare-ne-rastin-e-kryetarit-te-malisheves-ragip-begaj-i-akuzuar-per-keqperdorim-te-detyres/>

⁵⁸ Raport nga monitorimi i rastit kundër Ragip Begaj, 14 korrik 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-malisheves-ragip-begaj-lirohet-nga-akuza-per-shperdorim-te-detyres/>



Rasti Sreçko Spasiç: Kryetar i Komunës së Klllokotit

Gjykata Themelore në Gjilan

Numri i lëndës: PKR.nr.186/15

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”,
“cenimi i të drejtave në marrëdhënie të punës” dhe
“mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore”.

Kryetari i Trupit Gjykses: Afrim Shala

Prokuror: Shaban Spahiu

I pandehur: Sreçko Spasiç

Më 28 tetor 2015, është ngritur kallëzim penal kundër Sreçko Spasiç, kryetar i Komunës së Klllokotit, në PTh në Gjilan. Kjo prokurori më 5 nëntor 2015, ka nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve, kurse më 14 dhjetor 2015 ka ngritur aktakuzë kundër Spasiç për veprat penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Cenimi i të drejtave në marrëdhënie të punës”, dhe “Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore”.

Sreçko Spasiç duke qenë në pozitën e kryetarit të Komunës së Klllokotit, me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie pasurore për vete ose tjetrin, ka shkaktuar dëm material të dëmtuarit Trajan Stojanoviç, të cilin pa ndonjë arsye ligjore e ka larguar nga vendi i punës përkatësisht nga pozita e drejtorit të shkollës fillore “Marko Rajkovic” në fshatin Verbovc. Poashtu e kishte larguar nga puna edhe Bozhidar Dejanoviç, i cili kishte qenë drejtor në shkollën ekonomike teknike në fshatin Verbovc. Sipas aktakuzës, Spasiç me dashje ka shkelur të drejtën e punëtorëve Bozhidar Dejanoviç dhe Trajan Stojanoviç. I akuzuari nuk e ka respektuar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për kthimin në punë të dëmtuarve. Sreçko Spasiç është akuzuar edhe për mos ekzekutimin e aktvendimit të GjTh në Gjilan Dega në Viti, me të cilin është obliguar që të dëmtuarit Bozhidar Dejanoviç dhe Trajan Stojanoviç t’i kthej në vendet e punës përkatësisht në pozitë sipas akt emërimit dhe t’ua kompensoj të ardhurat personale.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Në këtë rast, GjTh në Gjilan ka caktuar shqyrtimin fillestar më 29 janar 2016. Shqyrtimi kryesor në rastin kundër Kryetarit të të Klllokotit Sreçko Spasiç, është mbajtur përmes seancave gjyqësore më 26 shkurt 2016 (kjo seancë është shtyrë), 5 maj, 13 qershor, 15 korrik, 19 shtator dhe 24 tetor 2016.⁵⁹

⁵⁹ Raportet nga monitorimi i seancave gjyqësore kundër Sreçko Spasiç, Kryetar i Komunës së Klllokotit, në: <http://betimiperdrejtesi.com/afere-fundit-gjykimi-ndaj-kryetarit-te-komunes-se-klllokotit-per-dallaveret-ne-punesimin-e-sherbyesve-civil/>
<http://betimiperdrejtesi.com/palet-japin-fjalet-perfundimtare-ne-rastin-e-kryetarit-te-komunes-se-klllokotit-srecko-spasic/>



GjTh në Gjiilan me 26 tetor 1016, ka shpallur aktgjykim dënues kundër Sreçko Spasiç dhe e ka dënuar me 10 muaj burg me kusht për “keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar”. Atij i është dhënë dënimi me kusht, që në periudhën kohore brenda dy viteve të mos kryen ndonjë vepër tjetër penale. Ndërkaq për veprat penale “cenimi i të drejtave në marrëdhënien e punës” dhe “mosekzekutimi i vendimit gjyqësor” është liruar nga akuza.⁶⁰

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka pasur kërkesa.

⁶⁰ Raport nga monitorimi i rastit kundër Sreçko Spasiç, në: <http://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-kllkotit-srecko-spasic-denohet-me-10-muaj-burg-me-kusht-per-keqperdorim-te-detyres-zyrtare/>



Rasti Dragan Nikoliç: Kryetar i Komunës së Parteshit

Gjykata Themelore në Gjilan

Numri i lëndës: PKR.nr.43/15

Vepra penale: "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar"
dhe "cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës"

Kryetari i Trupit Gjykses: Naser Maliqi

Prokuror: Shaban Spahiu

I pandehur: Dragan Nikoliç dhe Dragan Stankoviç

Policia e Kosovës më 23 prill 2014 kishte ngritur kallëzim penal kundër Dragan Nikoliç, kryetar i Komunës së Parteshit. PTh në Gjilan më 26 dhjetor 2014, kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve, kurse më 23 mars 2015, kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Gjilan, kundër Dragan Nikoliç dhe Dragan Stankoviç për veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar". Nikoliç dhe Stankoviç, ishin akuzuar se kanë kryer veprën penale "keqpërdorim pozitës apo autoritetit zyrtar" si dhe "cenim i të drejtës në marrëdhëniet e punës". Sipas aktakuzës, Dragan Nikoliç si Kryetar i Parteshit ka vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi që katër zyrtarëve të Komunës së Parteshit u'a kishte ndërprerë marrëdhënien e punës. Ndërkaq, Dragan Stojoviç si Drejtor i Administratës në Komunën e Parteshit nuk kishte vepruar sipas vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Edhe në këtë rast, shqyrtimi fillestar ishte caktuar me vonesë prej 6 muajsh nga ngritja e aktakuzës, respektivisht më 17 shtator 2015, kurse shqyrtimi i dytë ishte caktuar më 23 tetor 2015. Shqyrtimi kryesor në këtë rast kishte kaluar përmes seancave gjyqësore të mbajtur më 17 dhjetor 2015, 15 mars 2016, 3 maj 2016. Më 18 maj 2016, GjTh në Gjilan ka shpallur aktgjykim lirues për të dy të pandehurit.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka pasur kërkesa.

Rasti Hysni Hoxha: Ish-Kryetar i OShP-së

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.625/15

Vepra penale: "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar"



Kryetari i Trupit Gjykses: Beqir Kalludra

Prokuror: Haki Gecaj

I pandehur: Hysni Hoxha

Më 24 shtator 2014 ishte ngritur kallëzim penal ndaj Hysni Hoxhës, ish-Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Më 4 tetor 2015, PSRK kishte ngritur aktakuzë kundër Hysni Hoxhës për "keqpërdorim të detyrës zyrtare", pasi si Kryetar i OSHP-së, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore i kishte tejkalluar kompetencat ligjore. Sipas aktakuzës, Hoxha më 3 dhe 9 tetor 2014 kishte vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik. Vlera e këtij aktiviteti të prokurimit kishte qenë 2,327,240.19 euro.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar në rastin kundër Hysni Hoxhës ishte caktuar dhe mbajtur më 23 dhjetor 2015, afërsisht dy muaj me vonesë në kundërshtim me KPPK. Ndërsa shqyrtimi i dytë është mbajtur më 28 janar 2016.

Me 23 dhjetor 2016, GjTh në Prishtinë ka shpallur aktgjykim dënues ndaj ish-Kryetarit të OSHP-së, Hysni Hoxha, për "keqpërdorim të detyrës zyrtare". Hoxha u dënua me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 3 vitesh si dhe iu ka ndaluar ushtrimi i profesionit për 3 vite me radhë.⁶¹ Rasti ndaj Hysni Hoxhës është ndër rastet e rralla kur mund të konsiderohet se organet e ndjekjes dhe gjykatat e kanë trajtuar në një afat më të shkurër kohor, por që kanë dështuar të zbatojnë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me sekuestrimin apo konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale. Ky rast ende nuk është përfundimtar për shkak se aktgjykimi është ankimuar në instancat më të larta gjyqësore.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka pasur kërkesa.

⁶¹ Raport nga monitorimi i shpalljes së aktgjykimit ndaj Hysni Hoxha, më 23 dhjetor 2016, në: Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykim dënues ndaj ish-kryetarit të Organit shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Hysni Hoxha, për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Hoxha u dënua me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 3 vitesh. Të njëjtit i'u ndalua edhe ushtrimi i profesionit për 3 vite me radhë.



Rasti Lutfi Haziri: Kryetar i Komunës së Gjilanit

Gjykata Themelore në Gjilan

Numri i lëndës: PKR.nr.202/16

Vepra penale: "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar".

Kryetari i Trupit Gjykses: Afrim Shala

Prokuror: Ali Rexha

I pandehur: Lutfi Haziri

PSRK më 1 shkurt 2016 kishte pranuar një kallëzim penal nga Partia Demokratike e Kosovës kundër Kryetarit të të Gjilanit, Lutfi Haziri. PSRK më 14 mars 2016 kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj Lutfi Hazirit, kurse më 30 gusht 2016, e njëjta prokurori kishte ngritur aktakuzë ndaj tij. Lutfi Haziri akuzohej se si Kryetar i Gjilanit i kishte tejkalar kompetencat e tij, me qëllim që për vete ose persona tjerë të përfitojnë çfarëdo dobie pasurore, duke shkelur të drejtat e pjesëmarrësve tjerë në ankandin publik. Më 1 shtator 2014 i pandehuri nga pozita e Kryetarit të Gjilanit, me vendimin numër 551 kishte formuar Komisionin për Verifikimin e pretendimeve të kërkesës së Fitim Hazirit. Më 9 tetor 2014, duke mos i respektuar dispozitat e neneve 4 dhe 5 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të Komunës (Ligjin nr.04/L-144) i pandehuri ka nënshkruar Aneks Kontratën me numër 630 në mes të Komunës së Gjilanit dhe përfaqësuesit – pronarit të NTP "SO. BEZI" Fitim Hazirit. Me këtë aneks kontratë Komuna e Gjilanit është dëmtuar në vlerë prej 168,000.00 euro, (për çdo vit nga 33,600.00 euro) pasi që kontrata është e nënshkruar për 5 vjet. Kjo rrjedh pasi që me kontratën e parë biznesi N.T.P. "S.O.BEZI" ka qenë i obliguar që në emër të qerasë të paguaj vlerën vjetore prej 54,120.00 euro, ndërsa me aneks kontratë është zvogëluar obligimi për biznesin e lartcekur kështu që tani është i obliguar që të paguaj çmimin prej 20,520.00 eurove.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi i parë në këtë rast ishte mbajtur më 4 tetor 2016, afërsisht me një muaj vonesë në kundërshtim me afatet e KPPK-së, ndërsa më 28 tetor 2016, GJTh në Gjilan kishte marr vendim për hudhjen e aktakuzës.⁶²

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka pasur kërkesa.


⁶² Raport nga monitorimi i seancës gjyqësore në rastin kundër Lutfi Haziri, në: <http://betimiperdrejtesi.com/hudhet-aktakuza-ndaj-kryetarit-te-gjilanit-lutfi-haziri/>

Rasti Nexhat Demaku: Ish-Kryetar i Komunës së Drenasit

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.375/15

Vepra penale: "Shpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit"



Kryetari i Trupit Gjykses: Valbona Musliu – Selimaj
Prokuror/e: Feti Tunuzliu
I/E pandehur: Nexhat Demaku, Ajet Demiri, Gani Halilaj.

Më 12 mars 2013 ishte ngritur kallëzim penal kundër Kryetarit të Drenasit, Nexhat Demaku nga Agjencia Kundër Korrupsion. Më 1 dhjetor 2014, PTh në Prishtinë kishte nxjerr aktvendim për fillim të hetimeve, kurse më 29 qershor 2015, kjo prokurori kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë kundër Nexhat Demaku, Ajet Demiri, Gani Halilaj për kryerjen e veprës penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar". Sipas prokurorisë Nexhat Demaku si Kryetar i Drenasit ka tejkalluar kompetencat, meqë si qiradhënës më 2009 kishte lidhur kontratë për qira me Fadil Shishanin, me qëllim që ky të përfitojë të drejtën e shfrytëzimit të banesës së Zejnepe Buzhalës dhe në këtë mënyrë Demaku kishte ushtruar përgjegjësi përtej Ligjit për Qeverisje Lokale. Me këtë rast ai akuzohej se ka penguar të dëmtuarën Buzhala në gëzimin e të drejtës banesore për shfrytëzim të përkohshëm të banesës të dhënë me një vendim të mëparshëm nga Qendra për Edukim dhe Arsim Parashkollor "Ardhmëria".

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Katër muaj e gjysmë pas ngritjes së aktakuzës, GjTh në Prishtinë kishte mbajtur shqyrtimin fillestar më 16 nëntor 2015, ndërsa shqyrtimin e dytë e kishte mbajtur brenda afatit ligjor më 21 dhjetor 2015. Pas kësaj janë mbajtur gjashtë seanca të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit në datat 15.02.2016, 06.04.2016; 23.05.2016; 26.05.2016; 14.06.2016; 24.06.2016. Shpallja e aktgjykimit në këtë rast është bërë më 28 qershor 2016, në të cilin janë shpallur të pafajshëm të akuzuarit, pasi nuk është vërtetuar aktakuza gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor.⁶³

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka pasur kërkesa.

⁶³ Raport nga monitorimi i seancës gjyqësore në rastin kundër Nexhat Demaku, 28 qershor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-kryetari-i-komunes-se-drenasit-nexhat-demaku/>



Rasti Sami Lushtaku: Kryetar i Komunës së Skënderajt

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.18/15

Vepra penale: "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar",
"falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje",
"shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizim",
"mashttrim", "lidhja e kontratës së dëmshme"

Kryetari i Trupit Gjykses: Vladimir Mikula

Prokuror: Paul Flynn

I pandehur: Sami Lushtaku, Esat Tahiri, Milazim Lushtaku, Driton Pruthi,
Arben Gjukaj, Hysni Hoxha dhe Azem Duraku;

Më 2 shtator 2012, ishte ngritur kallëzim penal kundër Sami Lushtakut, Kryetar i Skënderajt. Më 5 tetor 2012, prokurori i EULEX-it kishte nxjerr aktvendim për fillimin e hetimit, kurse më 16 janar 2015 kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë, kundër Sami Lushtakut, Esat Tahiri, Milazim Lushtaku, Driton Pruthi, Arben Gjukaj, Hysni Hoxha dhe Azem Duraku për veprat penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", "Falsifikimi i dokumenteve në bashkëkryerje", "Shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizim", "Mashttrim". Ata akuzohen në lidhje me tenderin e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), ku përfshihen Kryetari i Skënderajt, Sami Lushtaku, Drejtori i KEK-ut, Arben Gjukaj dhe pesë të akuzuar tjerë. Që të shtatë të akuzuarit, akuzohen për tenderin milionësh për sigurimin fizik të objekteve të KEK-ut, ku Sami Lushtaku akuzohet për veprën penale "shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit", Arben Gjukaj e Hysni Hoxha për veprën penale 'keqpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit', Esat Tahiri dhe Milazim Lushtaku për veprat penale të 'mashttrimit' dhe "falsifikimit të dokumenteve" në bashkëkryerje, Driton Pruthi për veprat penale 'keqpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit' dhe lidhja e kontratës së dëmshme dhe Azem Duraku për veprën penale "shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit".



Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Aktakuza në rastin kundër Sami Lushtakut dhe të tjerëve ishte ngritur me 16 janar 2015. Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar dhe mbajtur në kohë rekord, vetëm pas katër ditëve nga ngritja e aktakuzës, respektivisht te 20 janar 2015 dhe shqyrtimi i dytë me 11 shkurt 2015. Përderisa, shqyrtimi i parë dhe i dytë ishte caktuar dhe mbajtur brenda afateve ligjore të përcaktuara me KPPK, mbajtja e shqyrtimit kryesor në këtë rast ishte shtyre për më shumë se një vit, dhe ishte mbajtur vetëm me 24 shkurt 2016. Nga kjo kohë deri me 15 qershor 2016, janë caktuar 22 seanca gjyqësore në shqyrtim kryesor, ku dy prej tyre ishin shtyrë. Seanca e fundit gjyqësore në shqyrtimin kryesor lidhur me këtë rast është mbajtur më 14 qershor 2016.⁶⁴

⁶⁴ Raportet e monitorimit nga seancat gjyqësore në rastin kundër Sami Lushtakut dhe të tjerëve:
<http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-per-rastin-e-kek-ut-rasti-vazhdon-te-procedohet/>
<http://betimiperdrejtesi.com/lushtaku-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem-ne-rastin-kek-2/>
<http://betimiperdrejtesi.com/vazhdon-gjykimi-ne-rastin-kek-2-kunder-sami-lushtakut-dhe-arben-gukajt/>
<http://betimiperdrejtesi.com/ne-rastin-e-kek-ut-deshmon-drejtori-i-pergjithshem-i-besa-security-granit-hasani/>
<http://betimiperdrejtesi.com/mungon-i-akuzuari-hysni-hoxha-shtyhet-seanca-ne-rastin-kek2/>
<http://betimiperdrejtesi.com/vazhdon-deshmine-drejtori-i-besa-security-ne-rastin-kek-2/>
<http://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ankohet-se-mbrojtja-nuk-i-njofton-me-kohe-lidhur-me-provat-e-reja-ne-rastin-kek-2/>
<http://betimiperdrejtesi.com/gjendja-e-perkeqesuar-shendetesore-e-lushtakut-shtyn-seancen/>
<http://betimiperdrejtesi.com/perfundon-marrja-ne-pyetje-e-deshmitarit-granit-hasani-per-rastin-kek-u-ii/>
<http://betimiperdrejtesi.com/alban-rushiti-deshmon-ne-rastin-kek2-ndaj-sami-lushtakut-dhe-te-tjereve/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmon-driton-sejdiu-ne-rastin-kek-2-ndaj-sami-lushtakut-dhe-te-tjereve/>
<http://betimiperdrejtesi.com/tre-punetoret-e-security-code-deshmojne-ne-rastin-kek-2/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmojne-tre-puntore-tjere-te-security-code-ne-rastin-kek-2/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmon-lumjan-tolaj-i-security-code-ne-rastin-kek-2/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmojne-per-rastin-kek-2-hilmi-lushtaku-dhe-agron-jusufi/>



Rasti Mehmet Krasniqi: Ish-Kryetar i Komunës së Obiliqit

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.271/14

Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”,
“Mashtrimi” dhe “Mashtrimi në detyrë”

Kryetari i Trupit Gjykses: Afërdita Bytyqi

Prokuror: Agron Bajrami

I pandehur: Mehmet Krasniqi, Xhavit Krasniqi, Haki Raqi, Emir Sopjani, Sami Kadriu, Nazmi Gashi, Ramadan Hashani, Bajram Paloji, Bujar Alidema, Shpend Kelmendi, Basri Kqiku, Hasie Dushi, Azem Spanca dhe Altin Preniqi.

Policia e Kosovës më 14 prill 2014 kishte ngritur kallëzim penal kundër Nexhat Krasniqit dhe të tjerëve. PSRK më 15 shtator 2014 kishte nxjerr aktvendim për fillim të hetimeve, kurse më 8 maj 2015, kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë për veprat penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” “Mashtrimi” dhe “Mashtrimi në detyrë”, kundër Mehmet Krasniqit ish-Kryetar i Komunës së Obiliqit, Xhavit Krasniqit Gjeodet, Haki Raqit zyrtar komunal, Emir Sopjanit pronar i kompanisë “Delta-ing”, Sami Kadriut menaxher përgjegjës, Nazmi Gashit anëtar i Komisionit për Pranim Teknik, Ramadan Hashanit inspektor i ndërtimit, Bajram Palojit anëtar i Komisionit për Pranim Teknik, Bujar Alidemës pronar i kompanisë “Bas Com”, Shpend Kelmendit inxhinier, Basri Kqikut pronar i kompanisë “Bejta Commerce”, Hasie Dushit zyrtare komunale, Azem Spancës drejtor komunal në Komunën e Obiliqit, Altin Preniqit menaxher i zyrës së Prokurimit. Veprat penale për të cilat akuzohet Mehmet Krasniqi dhe 12 persona tjerë, janë kryer gjatë periudhës kohore 2012-2013, përkatësisht gjatë realizimit të projektit për asfaltimin e disa rrugëve në këtë Komunën e Obiliqit.




Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar në këtë rast është mbajtur më 21 tetor dhe 22 nëntor 2015, gjashtë muaj pas afatit ligjor të përcaktuar në KPPRK, ndërsa shqyrtimi i dytë me 14 dhjetor 2015. Nga kjo kohë gjykatës iu janë dashur mbi shtatë muaj për të caktuar shqyrtimin kryesor i cili është caktuar vetëm me 20 korrik 2016. Gjatë vitit 2016, gjykata ka mbajtur edhe një seancë gjyqësore me 18 nëntor 2016, ndërsa seanca gjyqësore e caktuar për 13 janar 2017, është shtyrë.⁶⁵

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka pasur kërkesa.

⁶⁵ Raportet nga monitorimi i rastit kundër Mehmet Krasniqi dhe të tjerëve, 13 janar 2017: <http://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-komunes-se-obiliqit-mehmet-krasniqi-e-konsideron-aktakuzen-te-qellimshme-dhe-tendencioze/>
<http://betimiperdrejtesi.com/jep-mbrojtjen-e-tij-ish-kryetari-i-obiliqit-i-akuzuar-per-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/>
<http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-gjyqesore-ndaj-ish-kryetarit-te-komunes-se-obiliqit-dhe-zyrtareve-tjere-te-kesaj-komune-shkak-mungesa-e-prokurorit-agron-bajrami/>



Rasti Azem Sylja: Ish-Deputet bashkë me 21 persona tjerë

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.610/16 Vepra penale: “Krim i organizuar”, “Marrje e mitos”, “Pastrim i parave”, “Mashttrim në detyrë”, “Mashttrim i rëndë”, “Keqpërdorim të detyrës zyrtare”, “Nxjerrje të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore”, “Legalizim i përmbajtjes së falsifikuar” dhe “Evazion fiskal”.

Kryetari i Trupit Gjykes: Arccadius Sedek

Prokuror/e: Danilo Ceccareli

I/E pandehur: Azem Sylja, Shaban Sylja, Shpresim Uka, Fahredin Gashi, Hajrullah Berisha, Ramdan Uka, Arton Vila, Avdyrrahman Brajshori, Ilaz Sylja, Ljubisha Vujoviq, Gazmend Gashi, Nuhi Uka, Sabedin Haxhiu, Avni Maxhuni, Shqipe Maxhuni, Eleheme Uka, Lumnije Sopjani, Nyrtene Brajshori, Sami Maqedonci, Ndue Palushi, Ramadan Mavraj dhe Mustafë Haliti

Prokurori i EULEX-it më 30 prill 2014, kishte marr Aktvendim për fillimin e hetimeve kundër Azem Sylës, Nuhi Ukës dhe të tjerëve. Më 24 tetor 2016, Prokuroria kishte ngritur aktakuzë kundër Azem Sylës, Nuhi Ukës dhe 20 të tjerëve për veprat penale “Krim i organizuar”, “marrje e mitos”, “pastrim i parave”, “mashttrim në detyrë”, “mashttrim i rëndë”, “keqpërdorim të detyrës zyrtare”, “nxjerrje të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore”, “legalizim i përmbajtjes së falsifikuar” dhe “evazion fiskal”. Gjithashtu sipas aktakuzës të pandehurit akuzohen se në bashkëpunim, përmes veprimtarive kriminale i kanë privuar Kosovës pronat shoqërore, duke përfshirë falsifikimin e vendimeve dhe dokumenteve zyrtare, mashttrim dhe veprime tjera korruptive. Hetimet në këtë rast janë bërë në bashkëpunim me Prokurorinë e lartë për Krim të Organizuar në Beograd.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar në rastin kundër Azem Sylës, Nuhi Uka dhe të tjerëve ishte caktuar më 12 dhjetor 2016, por seanca ishte shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarit, Hajrullah Berisha.⁶⁶ Seanca e dytë lidhur me shqyrtimin fillestar në këtë rast është mbajtur më 15 dhjetor 2016. Edhe në këtë seancë gjyqësore mungesa e dy të akuzuarve Hajrullah Berishës dhe Mustafë Halilit, shkaktoi diskutim të gjatë në gjykatore. Pavarësisht kërkesës së avokatëve mbrojtës për veçim të procedurës ndaj këtyre dy të akuzuarve, kjo nuk paraqiti problem për gjyqtarin Arcadius Sedek, që të vazhdon

⁶⁶ Raport nga monitorimi i rastit kundër Azem Sylës dhe të tjerëve, më 12 dhjetor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/hapet-per-media-rasti-toka-shtyhet-seanca-ne-mungese-te-njerit-nga-te-akuzuarit/>



procedurën edhe në mungesë të pandehurve Berisha, i cili gjendet në Republikën e Maqedonisë dhe të pandehurit Halili, i cili gjendet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.⁶⁷ Neni 245 paragrafi 1 i KPPK, përcakton se gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit. Edhe në fund të marsit 2017, rasti kundër Azem Sylës dhe të tjerëve nuk ka arritur që të përfundoj shqyrtimin fillestar lidhur me këtë rast.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka pasur kërkesa.

⁶⁷ Raport nga monitorimi i rastit kundër Azem Sylës dhe të tjerëve, me 15 dhjetor 2016, <http://betimiperdrejtesi.com/rasti-toka-deklarohen-te-pafajshem-azem-syla-dhe-te-tjeret/>



Rasti Agim Bahtiri: Kryetar i Komunës së Mitrovicës

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Numri i lëndës: PKR.nr.20/16

Vepra penale: "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" dhe
"Marrëveshje për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender"

Kryetari i Trupit Gjykses: Beqir Halili

Prokuror: Agron Bajrami

I pandehur: Agim Bahtiri, Haxhimet Ferati dhe Gazmend Kelmendi

Avokat: Mahmut Halimi, Fatbardh Makolli dhe Dastid Pallaska

Policia e Kosovës më 18 nëntor 2015, ka parashtruar kallëzim penal kundër Agim Bahtirit, Kryetar i Komunës së Mitrovicës. PSRK më 4 shkurt 2016, kishte marr aktvendim për fillim të hetimeve ndaj të njëjtit. Kurse më 1 mars 2016, PSRK ka ngritur aktakuzë kundër Agim Bahtirit për kryerjen e veprave penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar".

PSRK akuzon Agim Bahtirin se si Kryetar i Mitrovicës, së bashku me Haxhimet Feratin, shef i zyrës së prokurimit të kësaj Komune, kanë tejkaluar kompetencat me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm. Këtë përfitim pretendohet se e kanë sjellë për operatorin ekonomik "HESALIGHT A/S, ku drejtor për Kosovë është i akuzuari Gazmend Kelmendi. Ata kanë nënshkruar kontratën me titull "Furnizim, montim dhe mirëmbajtje e ndriçimit publik eficiente në të gjitha rrugët e qytetit të Mitrovicës", ofertë kjo e bazuar në marrëveshje të kundërligjshme, qëllimi i të cilës ishte kufizimi i konkurrencës së lirë. Tutje sipas prokurorisë, Komuna e Mitrovicës ka pranuar ofertën e paraqitur nga Kelmendi me çmim prej 767.940.00 euro, dëm ky i shkaktuar Komunës, gjegjësisht buxhetit të Kosovës. Në këtë mënyrë të pandehurit kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke mos e njoftuar KRPP-në. Poashtu te njëjtit nuk e kanë publikuar njoftimin për dhënie të kontratës me qëllim që të shpërblehet operatori ekonomik në fjalë, përkundër faktit se ka pasur edhe operatorë tjerë lidhur me ofrimin e shërbimeve të njëjta.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Aktakuza kundër Agim Bahtirit është ngritur më 1 mars 2016, ndërsa shqyrtimi i parë i caktuar për 22 qershor 2016, ishte shtyrë për 15 korrik 2016. Në seancën e mbajtur më 15 korrik 2016, në GjTh në Mitrovicë, të pafajshëm u deklaruan Agim Bahtiri, Haxhimet Ferati, shef i prokurimit në Mitrovicë, dhe Gazmend Kelmendi, drejtor për Kosovë i operatorit ekonomik "Hesalight". Pasi që prokurori Agron Bajrami lexoi aktakuzën,



i pandehuri Bahtiri tha se këtë gjykim e konsideron politik dhe se aktakuza nuk ka të bëjë aspak me të.⁶⁸

Mirëpo që nga ajo kohë, kjo lëndë është duke u zvarritur, dhe as pas pothuajse 8 muaj nuk ka arritur që të konfirmohet apo të hudhet poshtë aktakuza. Pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, mbrojtësi i Kryetarit të Mitrovicës, avokati Mahmut Halimi, kishte parashtruar kundërshtimet e tij lidhur me provat e cekura në aktakuzë. Gjyqtari Beqir Halili kishte hedhur poshtë kundërshtimet e mbrojtjes dhe kishte konfirmuar aktakuzën. Ndaj këtij aktvendimi, mbrojtja kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Kjo e fundit i kishte aprovuar ankesat e mbrojtjes, dhe lëndën e kishte rikthyer në rivendosje. Megjithatë, edhe pas rikthimit të lëndës në rivendosje, gjyqtari Halili nuk u kishte dhënë të drejtë mbrojtjes, dhe kishte hedhur poshtë ankesat e tyre, duke konfirmuar edhe një herë tjetër aktakuzën.⁶⁹ Por, Gjykata e Apelit në Prishtinë, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27 shkurt 2017, ka aprovuar si të bazuara ankesat e të pandehurve, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke e rrëzuar aktakuzën pasi ka konsideruar se nuk ka pasur prova që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat ngarkohen.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Në rastin kundër Agim Bahtirit, sipas prokurorisë Komuna e Mitrovicës e ka pranuar ofertën e paraqitur nga Gazmend Kelmendi me çmim prej 767.940.00 euro, dëm ky i shkaktuar Komunës, gjegjësisht buxhetit të Kosovës. Edhepërkundër këtij dëmi, aktakuza e paraqitur nga Prokuroria, nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me veprat penale të ngritura në aktakuzë.

⁶⁸ Raport nga monitorimi i seancën gjyqësore në rastin kundër Agim Bahtirit, në: <http://betimiperdrejtesi.com/agim-bahtiri-deklarohet-i-pafajshem-per-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/>

⁶⁹ Raport lidhur me monitorimin e rastit për korrupsion ndaj Agim Bahtirit, Kryetar i Komunës së Mitrovicës, në: <http://betimiperdrejtesi.com/kane-kaluar-afer-8-muaj-nga-shqyrtimi-fillestar-zvarritet-ceshtja-penale-ndaj-kryetarit-te-komunes-se-mitrovices-agim-bahtiri/>

Rasti Sokol Bashota: Kryetar i Komunës së Klinës

Numri i lëndës: PKR.nr.168/16

Vepra penale: "Keqpërdorim i pozitës apo autorizimeve",
"Mos-raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave,
i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare"



Kryetari i Trupit Gjykses: Sylë Lokaj

Prokurore: Valeria Bolici

I pandehur: Sokol Bashota, Esat Rraci, Enver Berisha dhe Fadil Gashi

Më 25 nëntor 2013, Agjencia Kundër Korrupsion kishte parashtruar informatë lidhur me dyshimet për keqpërdorim në Komunën e Klinës. Më 24 shkurt 2014, Prokuroria kishte marr aktvendim për fillim të hetimeve, kurse më 4 gusht 2016, prokurori i EULEX-it kishte ngritur aktakuzë kundër Sokol Bashotës, Kryetar i Klinës dhe tre të tjerëve për "Keqpërdorim i pozitës apo autorizimeve", "Mos-raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare".

Sipas aktakuzës, gjatë procesit të ndarjes së banesave me qira, në pronësi të Komunës së Klinës, kanë bërë marrëveshje politike (PDK, LDK, AAK DHE LDD), për shpërndarjen e banesave. Pas kësaj marrëveshje, të pandehurit kanë ndikuar në procesin e vendimmarrjes, ku kanë anashkaluar aplikantët me gjendje të rëndë ekonomike dhe kanë shpërblyer shokët e tyre partiak me banesa. Sipas prokurorisë, dy të pandehurit Esat Rraci dhe Fadil Gashi, duke shfrytëzuar dispozitat e Ligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, kishin paraqitur kërkesa me shkrim për blerjen e banesave, të cilat u ishin ndarë atyre. Por, si rezultat i hetimeve, procesi i blerjes ishte pezulluar. Prokuroria akuzon të pandehurin Sokol Bashota poashtu se në periudhën janar 2009 deri në qershor 2016, në cilësi të Kryetarit të Klinës, ka falsifikuar me qëllim ose nuk ka përfshirë të dhënat ose informacionet, kur ka paraqitur deklaratimet e tij pasurore në Agjencinë Kundër Korrupsionit.



Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

PSRK kishte ngritur aktakuzë me 4 gusht 2016, kurse shqyrtimi fillestar ishte caktuar në GjTh në Pejë vetëm më 12 dhjetor 2016, apo më shumë se katër muaj pas ngritjes së aktakuzës. Shqyrtimi i dytë lidhur me këtë rast ishte caktuar më 23 janar 2017, por ishte shtyrë për arsye se prokurorja Valeria Bolici, ka deklaruar në seancë gjyqësore se nuk ka pranuar asnjë shkresë tjetër lidhur me kundërshtimet e provave të paraqitura nga palët, përveç ato të të akuzuarit Bashota.⁷⁰

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Aktakuza e paraqitur nga Prokuroria, nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me veprat penale të ngritura në aktakuzë.

⁷⁰ Raport nga monitorimi i seancës gjyqësore në rastin kundër Sokol Bashota, kryetar i Komunës së Klinës, në: <http://betimiperdrejtesi.com/prokurorja-nuk-i-ka-pranuar-te-gjitha-shkresat-per-kundershtimin-e-provave-shtyhet-shqyrtimi-i-dyte-ne-rastin-e-kryetarit-te-klines-dhe-tre-te-akuzuarve-tjere/>



Rasti Salim Jenuzi: Kryetar i Komunës së Dragashit

Gjykata Themelore në Prizren

Numri i lëndës: PKR.nr.131/16

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autorizimeve”;

“Mos-raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Kryetari i Trupit Gjykes: Ajser Skenderi

Prokuror/e: Sefer Morina

I pandehur: Salim Jenuzi, Bean Haxhihasani, Vetim Hasani dhe Nexhat Selaj

Avokat: Nuk kanë

Policia e Kosovës më 25 prill 2016, ka ngritur kallëzim penal kundër Salim Jenuzi, Kryetar i Komunës së Dragashit, dhe Vetim Hasanit dhe Nexhat Selaj, drejtor komune, respektivisht inspektor komune. PTh në Prizren më 1 qershor 2016, kishte nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve në këtë rast, kurse më 10 gusht 2016, kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prizren kundër tyre për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autorizimeve” dhe “Mos-raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”.

Salim Jenuzi, akuzohet se si Kryetar i Dragashit, në periudhën 2009-2016, ia ka mundësuar Nexhat Selajt, përvetësimin e pronës komunale, të cilën ky e kishte uzurpuar paraprakisht. Bean Haxhihasani, akuzohet se në cilësinë e drejtorit të urbanizmit në Komunën e Dragashit, ka leshur vendim me të cilin i është lejuar Nexhat Selajt, që të ndërtojë objektin afarist në pronë komunale. Vetim Hasani, akuzohet se duke qenë inspektor i ndërtimit në Komunën e Dragashit, nuk ka vepruar për të ndërprerë ndërtimin e objektit afarist të Nexhat Selajt, me material të përhershëm.

Nexhat Selaj akuzohet se gjatë periudhës 2009-2016, ka uzurpuar në mënyrë të paligjshme pronën komunale të Komunës së Dragashit, në të cilën ka ndërtuar objekt afarist me karakter të përhershëm, megjithëse kishte leje për shfrytëzim të përkohshëm.



Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Gjykata në këtë rast ka caktuar shqyrtimin fillestar më 2 shtator 2016, dhe shqyrtimin e dytë më 4 tetor 2016 në pajtim me afatet ligjore të përcaktuara me KPPK. Shqyrtimi kryesor në këtë rast është mbajtur më 12 dhjetor 2016.⁷¹ Që nga kjo kohë nuk është mbajtur seancë gjyqësore lidhur me këtë rast.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Në këtë rast nuk është paraqitur kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.

⁷¹ Raporte nga monitorimi i seancave gjyqësore në rastin kundër Salim Jenuzi, në: <http://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-dragashit-kundershton-akuzen-per-keqperdorim-te-detyres-zyrtare/>
<http://betimiperdrejtesi.com/komuna-e-dragashit-si-pale-e-demtuar-nuk-i-bashkengjitet-ndjekjes-penale-ndaj-kryetarit-te-komunes-salim-jenuzi-dhe-zyrtareve-te-tjere/>

Rasti Blerim Rama dhe Kenan Hasani: Policë të akuzuar për 3 pako cigare

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Numri i lëndës: PKR.nr.57/16

Vepra penale: "Marrje e ryshfetit"

Kryetari i Trupit Gjykses: Burim Ademi
Prokuror: Njazi Rexha
I pandehur: Blerim Rama dhe Kenan Hasani

Policia e Kosovës më 8 mars 2011 kishte parashtruar kallëzim penal ndaj Blerim Rama dhe Kenan Hasani. PTh në Mitrovicë më 5 maj 2014, kishte nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve, kurse më 19 qershor 2014, kishte ngritur aktakuzë kundër tyre, për veprë penale të "Marrje ryshfetit". Sipas aktakuzës, Blerim Rama dhe Kenan Hasani kanë marrë përfitim material nga i dëmtuari Arbër Sylejmani në mënyrë që të mos kryenin një veprim, i cili binte në kuadër të autorizimeve të tyre. Ata këtë e kanë bërë në atë mënyrë që kanë ndaluar të dëmtuarin dhe kanë konstatuar se automjeti të cilin ai e drejtonte i kishte skaduar regjistrimi. Pas kësaj, kanë kërkuar nga i dëmtuari që t'ua blejë 3 pako në cigare Marlboro, që të njëjtin mos ta dënojnë. Tre pako cigare Marlboro në treg kushtojnë afërsisht gjashtë (6) Euro.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar në këtë rast është caktuar pas gati një viti e gjysmë, përktësisht më 4 nëntor 2015, e cila seancë gjyqësore poashtu ishte shtyrë për gjashtë muaj dhe ishte mbajtur vetëm me 17 mars 2016. Shqyrtimi kryesor lidhur me këtë rast është mbajtur më 8 nëntor 2016.⁷² Më 9 nëntor 2016, GjTh në Mitrovicë ka shpallur aktgjykim dënues ku Blerim Rama dhe Kenan Hasani janë dënuar me nga 6 muaj dënim me burgim me kusht.⁷³

⁷² Raport monitorimi i rastit kundër Blerim Rama dhe Kenan Hasani, në: <http://betimiperdrejtesi.com/mbahet-shqyrtimi-fillestar-ndaj-dy-policeve-te-akuzuarve-per-tre-paketa-marlboro-ryshfet/>
<http://betimiperdrejtesi.com/fillon-gjykimi-ndaj-policeve-te-akuzuar-per-shkak-se-moren-3-pako-cigare-nga-nje-vozites-ne-komunikacion/>

⁷³ Raport nga monitorimi i shqiptimit të dënimit në rastin kundër Blerim Rama dhe Kenan Hyseni, në: <http://betimiperdrejtesi.com/dy-police-t-moren-ryshfet-3-pako-cigare-denohen-me-nga-6-muaj-denim-me-kusht/>

Rasti Haxhi Morina dhe Skender Osaj: Policë të akuzuar për 2 euro

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.507/16

Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Kryetari i Trupit Gjykses: Shashivar Hoti
Prokurore: Fikrije Fejzullahu
I pandehur: Haxhi Morina dhe Skënder Osaj

Më 15 gusht 2016, Inspektorati Policor i Kosovës, kishte ngritur kallëzim penal kundër zyrtarëve policor Haxhi Morina dhe Skender Osaj. PTh në Prishtinë më 16 gusht 2016, lidhur me këtë rast kishte nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve. Ndërsa më 5 shtator 2016, kjo prokurori kishte ngritur aktakuzë kundër Haxhi Morina dhe Skender Osaj për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Dy policët, akuzohen se më 13 dhe 14 gusht 2016, derisa ishin në vendin e tyre të punës në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”, kanë marrë gjësendet e konfiskuara nga sigurimi i aeroportit. Këto veprime të pandehurve janë vërejtur nga kolegët e të pandehurve, përmes kamerave të sigurisë, meqë vendi është i monitoruar nga kamerat.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Seanca e shqyrtimit fillestar ishte më 27 tetor 2016, është shtyrë për arsye se i pandehuri Skënder Osaj ka kërkuar përfaqësim sipas detyrës zyrtare.⁷⁴ Në shqyrtimin e dytë gjyqësor të mbajtur me datë 1 dhjetor 2016, mbrojtësit e zyrtarëve të Policisë së Kosovës, të akuzuarve për “keqpërdorim të detyrës zyrtare” Haxhi Morinës dhe Skënder Osajt, e kundërshtuan aktakuzën ndaj klientëve të tyre, duke e cilësuar si të pa bazuar në ligj. Mbrojtësit e të akuzuarve kanë konsideruar se kjo është vepër e rëndësisë së vogël, vlera e së cilës nuk e kalon shumë mbi 2 euro.⁷⁵ Nuk ka informacion se çfarë vendimi ka marrë gjykata në lidhje me këtë rast.

⁷⁴ Raport nga monitorimi i shqyrtimit të parë në rastin Hasan Morina dhe Skënder Qosaj, 27 tetor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/policet-pranojne-kryerjen-e-veprimeve-por-nuk-pranojne-kualifikimin-juridik-te-vepres-penale/>

⁷⁵ Raport nga monitorimi i shqyrtimit të dytë në rastin Hasan Morina dhe Skender Qosaj, 1 dhjetor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/mbrojtësit-e-policeve-te-akuzuar-thone-se-aktakuza-ben-fjale-vlere-qe-nuk-e-kalon-shumen-mbi-2-euro/>

Rasti i Universitetit të Prishtinës: Studentët e akuzuar për dallavere

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.119/16

Vepra penale: "Marrje e ryshfetit", "Ushtrim i ndikimit" dhe
"Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar"

Kryetari i Trupit Gjykses: Shadije Gërguri

Prokuror/e: Janë ndërruar disa.

Prokurori që ka përpiluar aktakuzën është Abdurrahim Islami

I/E pandehur: Esat Belaj, Rajan Zeneli, Kemajl Gashi, Arian Janova, Leonard Bytyqi, Kushtrim Morina, Mevlyn Beqiri, Gazmend Maliqaj, Arton Hoti, Albion Haxhijaha, Muhamed Maliqi, Shaqir Reqica dhe Amonda Orllati

Avokat/Mbrojtës: Kemajl Gashi, Ahmet Gjinovci, Ibrahim Dobrna, Emrush Kastrati, Azdren Hoxha, Skender Musa, Muhamet Humolli, Haxhi Millaku, Rexhep Kabashi, Bahrije Gjuriqi

Policia e Kosovës më 13 dhjetor 2013, ka ngritur kallëzim penal kundër 12 personave, studentë të Universitetit të Prishtinës për veprën penale "Marrje e ryshfetit", "ushtrim i ndikimit" dhe "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar". Prokuroria në të njëjtën ditë kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve. Kurse më 3 dhjetor 2014, kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë.

Sipas aktakuzës së ngritur nga prokuroria të akuzuarit prej vitit 2009 deri në vitin 2012, kishin vepruar në bashkëveprim, duke ju kryer studentëve të Universitetit të Prishtinës favore të ndryshme në kryerjen e provimeve, regjistrimin si student pa kaluar provimin pranues dhe duke ndikuar në personat zyrtar në UP për favore të ndryshme ndaj studentëve, me ç'rast kanë kryer veprat penale të marrjes

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar me 3 shkurt 2015, apo dy muaj pas ngritjes së aktakuzës, kurse shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 5 qershor 2015, apo afërisht me 3 muaj vonesë.



Shqyrtimi kryesor në këtë rast ishte caktuar me vonesë prej afërisht tetë muajsh, apo vetëm në vitin 2016, më 9 shkurt, seancë kjo që ishte shtyrë, për shkak të mungesës së njërit nga të akuzuarit.⁷⁶ Në këtë rast janë caktuar edhe 14 seanca gjyqësore tjera, prej të cilave janë shtyrë 6 seanca gjyqësore për arsye të ndryshme, si mungesa e prokurorit apo të akuzuarve.⁷⁷

Në seancën gjyqësore të mbajtur më 10 mars 2017, si rezultat i zvarritjes së trajtimit të këtij rasti, ka ardhur edhe te parashkrimi i ndjekjes penale ndaj katër të akuzuarve për disa pika të caktuara të aktakuzës.⁷⁸

Sekuestrimi dhe konfiskimi

Nuk ka kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë.

⁷⁶ Raport nga monitorimi i seancës gjyqësore në rastin e Universitetit, me 9 shkurt 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-gjyqesore-ndaj-13-te-akuzuarve-per-korrupsion-ne-up/>

⁷⁷ Raport nga monitorimi i seancave gjyqësore në rastin e Universitetit, në: <http://betimiperdrejtesi.com/pritet-precizimi-i-aktakuzes-ndaj-te-akuzuarve-per-dallavere-ne-up-disa-lirohen-per-shkak-te-parashkrimit/>
<http://betimiperdrejtesi.com/lenda-kalon-prej-prokurorit-ne-prokuror-rrezikohet-parashkrimi-i-veprave-penale-ndaj-te-akuzuarve-per-dallavere-ne-up/>
<http://betimiperdrejtesi.com/sterzgjatet-procesi-gjyqesor-ne-rastin-e-dallavereve-ne-up-serish-shtyhet-seanca/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmon-zyrtarja-e-larte-e-fakultetit-te-mjekesise-ne-rastin-e-studenteve-te-up-se/>
<http://betimiperdrejtesi.com/mungon-njeri-nga-te-akuzuarit-ne-rastin-e-studenteve-te-up-se-shtyhet-serish-seanca/>
<http://betimiperdrejtesi.com/per-rastin-e-up-se-deshmon-valbona-jakupi-esat-belaj-mi-kishte-kerkuar-250-euro-per-kalimin-e-provimit/>
<http://betimiperdrejtesi.com/deshmitaret-ne-rastin-e-dallavereve-ne-up-deklaruan-se-askujt-nuk-i-kane-dhene-para-per-regjistrimin-e-tyre-ne-fakultet/>
<http://betimiperdrejtesi.com/ne-rastin-e-up-se-mbrojtesit-kane-verejtje-ne-provat-e-prokurorise-avokati-hoxha-tha-se-sms-et-e-klientit-te-tij-jane-nxjerr-ne-menyre-te-kunderligjshme/>
<http://betimiperdrejtesi.com/ne-mungese-te-prokurores-ikramije-bojaxhiu-shtyhet-seanca-ndaj-studenteve-te-up-se/>
<http://betimiperdrejtesi.com/mungon-i-akuzuari-esat-belaj-shtyhet-seanca-ndaj-studenteve-te-up-se/>
<http://betimiperdrejtesi.com/parashkruhen-disa-nga-veprat-penale-ne-rastin-ndaj-studenteve-te-up-se/>

⁷⁸ Raport nga monitorimi i seancës gjyqësore në rastin Univeristetit, me 10 mars 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/parashkruhen-disa-nga-veprat-penale-ne-rastin-ndaj-studenteve-te-up-se/>

Rasti Imri Iseni: Qytetar i akuzuar për 4 euro

Gjykata Themelore në Ferizaj
Numri i lëndës: PKR.nr.119/16
Vepra penale: "Dhënia e ryshfetit"



Gjykata Themelore në Ferizaj
Numri i lëndës: PKR.nr.119/16
Vepra penale: "Dhënia e ryshfetit"

Më 17 maj 2016, ishte ngritur kallëzim penal ndaj qytetarit Imri Iseni për dyshimin e kryerjes së veprës penale "Dhënia e ryshfetit". Më 14 korrik 2016, PTh në Ferizaj, kishte ngritur aktakuzë kundër Imri Isenit, pasi më 2 maj 2016, në Ferizaj, në mënyrë të drejtpërdrejtë i kishte ofruar përfitim personit policit Besim Rashiti që mos të veprojë në pajtim me detyrat zyrtare. Iseni akuzohet se përmes telefonit të tij, i kishte dërguar 4 euro mbushje telefonike policit. Iseni akuzohet se këtë vepër penale e ka kryer me qëllim që polici pastaj t'ia jep lejen e qarkullimit të kamionit transportues, e cila leje i ishte marrë nga po i njëjti polic më 28 prill 2016, për shkak të kundërvajtjes që kishte kryer.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore


Shqyrtimi fillestar lidhur me këtë rast është mbajtur pas gati pesë muajve në kundërshtim me ligjin, përkatësisht më 16 nëntor 2016, ndërsa më 12 janar 2017, aktakuza e ngritur ndaj Imri Isenit për dhënie të ryshfetit, është hedhur poshtë me aktvendim nga kryetari i trupit gjykues, gjyqtari Sahit Krasniqi. Krasniqi ka aprovuar kërkesën e të pandehurit për hüdhen e aktakuzës me arsyetimin se vepra penale është e rëndësisë së vogël dhe se aktakuza nuk është e bazuar në prova dhe fakte relevante.

Iseni, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 16 nëntor 2016 në GjTh në Ferizaj, pas leximit të akuzës nga ana e prokurorit të çështjes Shukri Jashari është deklaruar i pafajshëm dhe nuk ka pranuar fajësinë. Ndërkaq ka deklaruar se është e vërtetë që ai kishte dërguar një mbushje të telefonit zyrtarit policor Besim Rashiti, mirëpo siç ka thënë këtë mbushje i'a ka dërguar gabim sepse ai mbushjen ka dashur të i'a dërgoj dikujt tjetër.⁷⁹

⁷⁹Raport nga monitorimi i rastit kundër Imri Isenit, 12 janar 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/hudhet-aktakuza-ndaj-te-akuzuarit-per-kater-euro-ryshfet/>


8. ANALIZË KRAHASUESE E TRAJTIMIT TË RASTEVE TË KORRUPSIONIT MES VITIT 2014, 2015 DHE 2016

Në PSh në fund të vitit 2014 kanë mbetur të papërfunduara 520 lëndë nga vitet paraprake me 1556 persona të përfshirë. Kurse në fund të vitit 2015, ky numër ishte rrit në 538 lëndë me 1640 persona të përfshirë. Kurse në fund të vitit 2016, ky numër ka rënë në 462 lëndë me 1227 persona të përfshirë në raste të korrupsionit. Shih në grafikun më poshtë krahasimet e trendit të rasteve të pazgjidhura në tri vitet e fundit.



Grafika 3 - Krahasim i trajtimit të rasteve në vitet 2014, 2015 dhe 2016

PSh gjatë vitit 2014 ka zgjidhur 444 raste me 1011 persona të përfshirë, në vitin 2015 ka zgjidhur 403 raste me 864 persona, ndërsa në vitin 2016, Psh ka zgjidhur 409 raste me 1037 persona. Shih në grafikun më poshtë krahasimet e trendit të rasteve të zgjidhura në tri vitet e fundit.



Grafika 4 - Krahasim i numrit të rasteve të zgjidhura të korrupsionit ndër vite

9. LLOGARIDHËNIA E PROKURORËVE

a) Hetimet disiplinore pas gjetjeve të raporteve të IKD-së

Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) ka të angazhuar stafin e inspektorëve në trajtimin e gjetjeve të raporteve periodike të IKD-së. Si rezultat i gjetjeve të IKD-së të publikuara në shtatë raporte, ZPD deri më tash ka përfshirë 406 raste në hetime preliminare ndaj prokurorëve. Prej tyre janë përfshirë në hetime disiplinore 25 lëndë të prokurorëve, ku përfshihen 17 raste. Prej tyre 9 raste me shkelje të vërtetuara disiplinore nga ZPD janë dërguar në Komisionin Disiplinor të KPK-së. Nga rastet e iniciuara nga gjetjet e IKD-së, 4 hetime disiplinore janë mbyllur me gjetje, 4 hetime disiplinore janë në procedurë të hetimit, 39 lëndë janë refuzuar, 60 lëndë janë refuzuar pas hetimit preliminar.⁸⁰ Vetëm për dy raportet e fundit të publikuara nga IKD, ZPD ka iniciuar hetime preliminare në 257 lëndë të korrupsionit të trajtuara nga prokurorët.⁸¹ Vendimet e Komisionit nuk janë bërë publike as nga ZPD e as nga Komisioni Disiplinor i KPK-së.⁸²

Sa i përket gjetjeve të raportit V “Luftimi i korrupsionit, prioritet në letër”, të publikuar nga IKD më 10 dhjetor 2015, ZPD ka njoftuar se kryer hetime preliminare për të gjitha rastet e evidentuara (56 lëndë) dhe ka marr një numër të madh të deklaratave nga prokurorët, të cilët kanë qenë të ngarkuar me lëndët e përshkruara si në raport. Pas grumbullimit të informacioneve, shqyrtimit dhe analizimit të tyre, ZPD ka të gjitha gjetjet e shkeljeve ligjore i ka dërguar për vlerësim në Komisionin për Shqyrtimin e Performacës së Prokurorëve në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Veprimi i tillë është bërë nga ZPD sepse të gjeturat pretendohet se, kanë të bëjnë me performacën e prokurorëve në punë. Pasi që raporti me të gjetura është dërguar në Komisionin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve në Këshillin Prokurorial të Kosovës, ZPD

⁸⁰ *Burimi*: Të dhënat zyrtare të ZPD-së të ofruara përmes postës elektronike për IKD. Mars 2017.

⁸¹ *Burimi*: Drejtori i ZPD-së, z. Zef Prendrecaj në një përgjigje me shkrim përmes postës elektronike ka njoftuar se vetëm për dy raportet e fundit të IKD-së, janë iniciuar 257 hetime preliminare në lëndët e korrupsionit të trajtuara nga prokurorët. “Raporti i VI – Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo promovimi i korrupsionit (27.04.2016) Në lidhje me të gjeturat nga ky raport, ZPD ka kryer hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 111 lëndëve) për të gjitha rastet e evidentuara dhe ka marr një numër të madh të deklaratave nga prokurorët (22 deklarata) të cilët kanë qenë të ngarkuar me lëndët e përshkruara si në raport. Është kërkuar nga prokurorët të deklarohen me të gjeturat e IKD-së, përkatësisht ZPD-së. Raporti i VII – Korrupsioni në Kosovë: Retorika në luftimin e Korrupsionit (27.10.2016) Në lidhje me të gjeturat nga ky raport, ZPD është duke ndërmarr hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 146 lëndëve). Pas grumbullimit të informacioneve, shqyrtimit dhe analizimit të tyre, ZPD, do t’ju mbajë të informuar me epilogun e rasteve dhe të gjeturat.” IKD intervistë me z. Zef Prendrecaj, Drejtor i ZPD-së. Mars 2017.

⁸² IKD ka bërë kërkesa për të marr të dhëna statistikore në lidhje me vendosjen e këtyre lëndëve nga ZPD dhe Komisioni Disiplinor i KPK-së, por nuk ka marr përgjigje. Kërkesat për të dhëna janë bërë në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por këto institucione nuk kanë respektuar afatet dhe detyrimet ligjore. IKD do të ndjekë rrugët ligjore për sigurimin e këtyre të dhënave statistikore.

është informuar nga Kryesuesi i KPK-së se, raportin e ka dërguar për vlerësim në Komisionin e lartë cekur.⁸³

Sidoqoftë, ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor të KPK-së, ZPD ka njoftuar se ka ushtruar ankesa. Gjithashtu, sipas informacioneve të ZPD-së, prej gjetjeve të raporteve të IKD-së, aktualisht në fazën e vendosjes në Komision Disiplinor gjenden 286 raste ndaj prokurorëve.

RASTET E HETIMEVE NGA ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR TË INICUARA PREJ RAPORTEVE TË IKD-SË									
Raportet e publikuara të IKD-së	Lëndë të përfshira në hetime preliminare	Lëndë të përfshira në hetime disiplinore	Raste të përfshira në hetime disiplinore	Hetimet disiplinore të dërguara në Komisionin Disiplinor	Hetime disiplinore të mbylltura me gjetje	Hetime disiplinore në procedurë të hetimit	Lëndë të përfshira në refuzim	Refuzim pas hetimit preliminar	Rastet në fazën e vendosjes
Korrupsioni në Kosovë - I -	26	21	14	6	4	4	5	1	
Korrupsioni në Kosovë - II -	16	1	1	1			15	1	
Korrupsioni në Kosovë - III -	29								29
Korrupsioni në Kosovë-IV -	22	3	2	2			19	2	
V Luftimi i korrupsionit në Kosovë-Prioritet në letër (10.12.2015)	56							56	
VI Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo promovimi i korrupsionit (27.04.2016)	111								111
VII Retorika në luftimin e korrupsionit (27.10.2016)	146								146
Total:	406	25	17	9	4	4	39	60	286

Tabela 9 - Rastet e hetimeve të iniciuara nga ZPD prej gjetjeve të raporteve të IKD-së.

ZPD tashmë po sfidohet në punën e saj për zhvillimin e hetimeve në rastet e gjetjeve nga raportet e IKD-së. Gjetjet e IKD-së vazhdimisht trajtohen me prioritet nga inspektorët e ZPD-së. Kjo zyre ka vështirësi në sigurimin e dosjeve dhe informacioneve relevante sepse prokuroritë/prokurorët, të cilët nuk përgjigjen shpejt dhe kështu vonohet procesi i shqyrtimit dhe vendosjes në masë të konsiderueshme duke marrë

⁸³ IKD intervistë me z. Zef Prendrecaj, Drejtor i ZPD-së. Mars 2017.

parasysh faktin se, dosjet/informacionet duhet të sigurohen gati në të gjitha Prokuroritë e Kosovës⁸⁴.

Drejtuesit e ZPD-së vlerësojnë se pas grumbullimit të shkresave, informacioneve dhe veprimeve tjera që ka ndërmarrë bazuar në gjetjet e raporteve të IKD-së kanë vërejtur se ka filluar të përmirësohet puna për rastet e ngjashme (të gjeturat në raporte) përkatësisht të ngritët llogaridhënia. Disa bartës të funksioneve prokuroriale janë nervozuar me gjetjet e IKD-së dhe veprimet e ZPD-së ku kanë shkuar deri në atë masë sa që kanë tentuar të bëjnë veprime hakmarrëse ndaj stafit të ZPD-së, vetëm pse janë rekomanduar në Komision Disiplinor.⁸⁵

Kjo qasje e prokurorëve është tejet shqetësuese dhe përbën në vete keqpërdorim të detyrës dhe sjellje të pahijshme profesionale dhe etike. Në fakt, ZPD me ligj është autoritet i pavarur, i cili duhet të veprojë në këto raste dhe secilën sjellje të tillë të prokurorëve apo gjykatësve ta hetojë dhe të njëjtat t'i dërgon në Komisionet Disiplinore të Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor. IKD vlerëson se në të gjitha këto raste organet prokuroriale duhet të ngrisin zërin dhe të ndërjmarrin veprime konkrete në drejtim të ruajtjes së pavarësisë së ZPD-së në ushtrimin e funksioneve të veta për të rritur llogaridhënien ndaj prokurorëve dhe gjykatësve.

⁸⁴ IKD intervistë me z. Zef Prendrecaj, Drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Shtator 2016.

⁸⁵ IKD intervistë me z. Zef Prendrecaj, Drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Shtator 2016.

10. MONITORIMI I PROCESVEVE GJYQËSORE NË RASTET E KORRUPSIONIT NGA IKD

IKD nga qershori 2015, monitoron rastet e korrupsionit në të gjitha Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës. Ekipi i monitoruesve të IKD-së, prej qershorit 2015, në mënyrë sistematike kanë vizituar të gjitha Gjykatat dhe Kryetarët e Gjykatave Themelore për të monitoruar për së afërmi secilin proces gjyqësor që ndërlidhet me veprat penale kundër korrupsionit. Monitorimi ka përfshirë procesin e identifikimit të rasteve të korrupsionit në punë, caktimin dhe ndarjen në punë të lëndëve, informacionet se në cilën fazë të procedurës gjenden këto raste në gjykata dhe raportimin e tyre për publikun në baza ditore përmes uebfaqes.⁸⁶ Sfidat në identifikimin e rasteve të korrupsionit dhe sigurimin e orarit të seancave gjyqësore kanë qenë dhe mbesin të vazhdueshme për monitoruesit e IKD-së.⁸⁷ Sidoqoftë, IKD dhe KGJK kanë nënshkruar edhe Memorandum të Bashkëpunimit⁸⁸, i cili ka lehtësuar qasjen e monitoruesve të IKD-së në gjykata, komunikimin, bashkëpunimin dhe koordinimin.


Gjykatat në fillim të vitit 2016 kanë pasur 407 lëndë të pazgjidhura të korrupsionit me 956 persona të përfshirë. Gjatë këtij viti gjykatësit kanë pranuar në punë 232 lëndë të reja me 502 persona, që rezulton se gjykatata gjatë vitit 2016 kanë pasur në punë 639 lëndë të korrupsionit me 1458 persona. Gjatë vitit 2016 gjykatat kanë zgjidhur 284 lëndë me 594 persona, ndërsa më 31 dhjetor 2016 kanë mbetur 355 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 864 persona.

Monitoruesit e IKD-së, nga 1 janari e deri më 31 dhjetor 2016 kanë monitoruar 1,505 seanca gjyqësore, ku përfshihen 383 raste të korrupsionit me 989 persona. Shih tabelën më poshtë.

⁸⁶ IKD në bashkëpunim me Radio Televizionin Publik bashkëprodhojnë emisionin e specializuar për fushën e sundimit të ligjit "Betimi për Drejtësi". Krahas kësaj, është zhvilluar edhe portali "Betimi për Drejtësi", në të cilin përveç hulumtimeve, analizave dhe debateve që zhvillohen në emision, publikohen në baza të përditësuara edhe raportet e monitoruesve të IKD-së për të gjitha rastet e korrupsionit. Raportimi bëhet në rubrikën e veçantë të portalit, të cilat gjenden në këtë link <http://betimiperdrejtesi.com/lajme/>

⁸⁷ GjTh-të ende nuk kanë një sistem efikas dhe efektiv të azhurnimit të bazës së të dhënave për orarin e mbajtjes së seancave gjyqësore në përgjithësi dhe në veçanti për rastet e korrupsionit. Fillimisht, IKD ka vendosur komunikim përmes Kryetarëve të GjTh-ve dhe më pas përmes zëdhënësve të këtyre gjykatave, të cilët kanë informuar monitoruesit e IKD-së për orarin e caktimit të seancave gjyqësore për rastet e korrupsionit. Megjithatë, kjo praktikë nuk ka funksionuar në mënyrën më të mirë, sepse zëdhënësit kanë dërguar tek monitoruesit e IKD-së informacione jo të plota dhe jo të sakta për orarin e seancave, gjë që ka shkaktuar probleme për monitorimin e tyre. Ky komunikim përditë ka avancuar, megjithatë ende ka probleme praktike që ndërlidhen me orarin e seancave gjyqësore në rastet e korrupsionit. Duke parë këto sfida, IKD duke shfrytëzuar legjislacionin pozitiv për të pasur qasje në të gjitha informatat e nevojshme rreth këtyre rasteve, ka nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit KGJK, përmes të cilit mundësohet një qasje, konukimin, bashkëpunim dhe koordinim më i mirë në mes të monitoruesve të IKD-së dhe KGJK-së, përkatësisht të gjitha niveleve të Gjykatave dhe Kryetarëve.

⁸⁸ Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të KGJK-së dhe IKD-së është aprovuar unanimisht nga të gjithë anëtarët e KGJK-së në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2016, ndërsa është nënshkruar mes drejtuesve të KGJK-së dhe IKD-së më 7 prill 2016. Prishtinë, 7 prill 2016.




Grafika 5 - Rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD (1 janar - 31 dhjetor 2016)

a) Analiza e rasteve të monitoruara gjatë vitit 2016

Në këtë raport, subjekt i hulumtimit dhe analizës janë rastet e korrupsionit të monitoruara gjatë vitit 2016. Gjatë vitit 2016, IKD ka monitoruar 1,505 seanca gjyqësore, ku përfshihen 383 raste të korrupsionit me 989 persona të përfshirë⁸⁹. Në grafikonin më poshtë janë paraqitur numri i seancave dhe rasteve të korrupsionit të monitoruara nga IKD. Gjithashtu janë paraqitur edhe numri i seancave të mbajtura dhe të shtyra.

⁸⁹ *Sqarim:* IKD përgjatë muajit janar ka monitoruar 89 seanca gjyqësore, ku përfshihen 65 raste të korrupsionit me 157 persona. Gjatë muajit shkurt janë monitoruar 99 seanca gjyqësore, ku përfshihen 83 raste të korrupsionit me 203 persona. Gjatë muajit mars janë monitoruar 168 seanca gjyqësore, ku përfshihen 104 raste të korrupsionit me 229 persona. Gjatë muajit prill janë monitoruar 134 seanca gjyqësore, ku përfshihen 102 raste të korrupsionit me 263 persona. Gjatë muajit maj janë monitoruar 128 seanca gjyqësore, ku përfshihen 96 raste të korrupsionit me 230 persona. Gjatë muajit qershor janë monitoruar 131 seanca gjyqësore, ku përfshihen 114 raste të korrupsionit me 304 persona. Gjatë muajit korrik janë monitoruar 97 seanca gjyqësore, ku përfshihen 70 raste të korrupsionit me 163 persona. Gjatë muajit gusht janë monitoruar 32 seanca gjyqësore, ku përfshihen 26 raste të korrupsionit me 135 persona. Gjatë muajit shtator janë monitoruar 131 seanca gjyqësore, ku përfshihen 95 raste të korrupsionit me 320 persona. Gjatë muajit tetor janë monitoruar 140 seanca gjyqësore, ku përfshihen 94 raste të korrupsionit me 283 persona. . Gjatë muajit nëntor janë monitoruar 164 seanca gjyqësore, ku përfshihen 104 raste të korrupsionit me 394 persona. Ndërkaq, gjatë muajit dhjetor janë monitoruar 192 seanca gjyqësore, ku përfshihen 121 raste të korrupsionit me 361 persona. Megjithatë, marr parasysh faktin se një rast i monitoruar në janar, ka vazhduar edhe gjatë njëmbëdhjetë muajve të tjerë, nga kjo del se analiza e raportit për këtë muaj do të përfshijë 383 raste të korrupsionit me 989 persona.



Grafika 6 - Rastet e monitoruara gjyqësore në periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2016.

Numri më i madh i seancave gjyqësore të monitoruara përfshinë:

- GjTh në Prishtinë, me 632 seanca të monitoruara, prej tyre 430 seanca janë mbajtur, ndërsa 202 seanca janë shtyrë.
- GjTh në Prizren pason me 233 seanca gjyqësore të monitoruara, prej tyre 185 seanca janë mbajtur, 48 seanca janë shtyrë. Gjth në Gjilan janë monitoruar 186 seanca gjyqësore, prej tyre 148 seanca janë mbajtur, 38 seanca janë shtyrë.
- GjTh në Ferizaj me 145 seanca gjyqësore të monitoruara prej të cilave 118 seanca janë mbajtur ndërsa 27 seanca janë shtyrë.
- GjTh në Pejë me 117 seanca gjyqësore të monitoruara prej të cilave 99 seanca janë mbajtur ndërsa 18 seanca janë shtyrë. GjTh në Gjakovë me 103 seanca gjyqësore të monitoruara prej të cilave 88 seanca janë mbajtur ndërsa 15 seanca janë shtyrë.
- GjTh në Mitrovicë me 89 seanca gjyqësore të monitoruara ku 71 seanca janë mbajtur ndërsa 18 seanca janë shtyrë

Përgjatë seancave gjyqësore të monitoruara nga IKD gjatë kësaj periudhe raportuese janë identifikuar parregullsi të ndryshme. Nga 1,505 seanca të monitoruara, 1,139 prej tyre janë mbajtur, ndërkaq si pasojë e mosplotësimit të kushteve ligjore për mbajtjen e seancave 366 prej tyre janë shtyrë. Arsyet e shtyrjes së 366 seancave gjyqësore janë:

- Mungesa e të pandehurve/akuzuarve
- Mosdorëzimi i shkresave të lëndës nga Prokuroria
- Mungesa e Prokurorit

- Mungesa e Trupit Gjykues
- Mungesa e avokatëve
- Mungesa e palës së dëmtuar dhe dëshmitarit
- Mungesa e të pandehurit/ës dhe Prokurorit
- Kërkesa e palëve në procedurë

IKD ka identifikuar parregullësi edhe në seancat e proceduara. Prej 1,139 seancave të mbajtura, 313 prej tyre kanë filluar me mbi 15 minuta vonesë dhe atë:

- 151 raste në GJTh Prishtinë
- 42 raste në GJTh Ferizaj
- 30 raste në GJTh Pejë
- 28 raste në GJTh Gjilan
- 28 raste në GJTh Gjakovë
- 18 raste në GJTh Prizren
- 16 raste në GJTh Mitrovicë

Si arsye më të shpeshta të vonesës janë identifikuar vonesa e: Gjykatësit/Trupit Gjykues, Prokurorit, në disa raste Avokatit/Mbrojtësit dhe Dëshmitarëve.

Gjatë monitorimit janë vërejtur edhe parregullsi tjera që kanë penguar zhvillimin e seancave gjyqësore. Prej 1,139 seancave të mbajtura, në 197 prej tyre monitoruesit e IKD-së kanë gjetur shkeljet si në vijim:

- Mosrespektimi i veshjes së uniformës nga gjyqtarët, prokurorët dhe mbrojtësit (78 raste)
- Mbajtja e seancave në zyrë (42 raste)
- Mosprania gjatë shqyrtimit gjyqësor e trupit gjykues dhe procesmbajtësve (4 raste)
- Caktimi i dy seancave të ndryshme në të njejtën kohë nga i njejtë gjyqtar (3 raste)
- Caktimi i dy seancave të ndryshme në të njejtën kohë nga i njejtë prokuror (3 raste)
- Hapja e telefonit gjatë seancës nga pala e akuzuar (7 raste)
- Hapja e telefonit gjatë seancës nga pala e dëmtuar (1 rast)
- Hapja e telefonit gjatë seancës nga gjyqtarët (6 raste)
- Hapja e telefonit gjatë seancës nga prokurorët (9 raste)
- Hapja e telefonit gjatë seancës nga mbrojtësit (6 raste)
- Mosshënimi në procesverbal i deklaratave të palëve (2 raste)
- Mossigurimi i shkresave të lëndës për mbrojtësit, nga ana e prokurorit (4 raste)

- Fillimi i mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor pa praninë e prokurorit në gjykatore (6 raste)
- Fillimi i mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor pa plotësimin e trupit gjykues (11 raste)
- Mungesa e Kryetarit të trupit gjykues gjatë shpalljes së aktgjykimit (2 raste)
- Mospërputhja e dispozitivit të Aktakuzës me provat e lëndës që gjykata posedon (1 rast)
- Asistimi nga mbrojtësi drejt të akuzuarit gjatë marrjes në pyetje (1 rast)
- Vazhdimi i marrjes në pyetje të dëshmitarit pa praninë e të akuzuarit në sallë (1 rast)
- Leximi i provës në gjuhën jo amëtare të të akuzuarve (1 rast)
- Qëndrimi i njërit nga të akuzuarve në sallë gjatë marrjes në pyetje të të akuzuarit tjetër (1 rast)
- Mosleximi i të drejtave të akuzuarve para marrjes në pyetje (5 raste)
- Mosleximi i të drejtave të dëshmitarëve para marrjes në pyetje (2 raste)
- Shpallja e aktgjykimit nga anëtari i trupit gjykues (1 rast).

b) Vonesat e prokurorive në procedimin e aktakuzave në gjykata

IKD gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit në prokurori dhe gjykata ka vërejtur në praktikë fenomenin e zvarritjes së dërgimit të aktakuzave nga prokurorët në gjykata. IKD ka identifikuar dhjetë (10) raste të tilla në të gjitha gjykatat e Kosovës. IKD, sjell sipas tabelës së më poshtme rastet në të cilat prokurorët me vonesë i kanë dërguar aktakuzat në gjykatë.

Në rastin e PTh në Prishtinë (Dega në Podujevë), me numër të aktakuzës PP.nr. 600-14/2006, është konstatuar vonesë prej 400 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Prizren, me numër të aktakuzës PP.nr. 154/2015, është konstatuar vonesë prej 41 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Gjilan, me numër të aktakuzës PP.I.nr. 50/15, është konstatuar vonesë prej 31 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Ferizaj, me numër të aktakuzës PP.I. 57/15, është konstatuar vonesë prej 34 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë

Në rastin e PTh në Prishtinë, me numër të aktakuzës PP.nr. 218-7/08, është konstatuar vonesë prej 26 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Prishtinë, me numër të aktakuzës PP.Nr. 642-1/2012, është konstatuar vonesë prej 17 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Gjakovë, me numër të aktakuzës PP.nr. 121/2013 , është konstatuar vonesë prej 15 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Prishtinë, me numër të aktakuzës PP.nr.5345-4/11, është konstatuar vonesë prej 13 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Prishtinë, me numër të aktakuzës PP.I.nr.112/2016, është konstatuar vonesë prej 12 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Prishtinë, me numër të aktakuzës PP.nr.268-7/10, është konstatuar vonesë prej 10 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Zvarritjet e prokurorëve në procedimin e aktakuzave në gjykata					
Gjykatat Themelore dhe Degët e Gjykatave Themelore	Nr. i Aktakuzës	Data e përpilimit të Aktakuzës nga Prokuroria	Data e ngritjes së aktakuzës në Gjykatë	Vonesa	
1 Prishtinë (Dega Podujevë)	PP.nr. 600-14/2006	14.05.2012	18.06.2012	400 ditë	
2 Prizren	PP.nr.154/2015	12.02.2016	25.03.2016	41 ditë	
3 Gjilan	PP.I.nr.50/15	05.10.2015	05.11.2015	31 ditë	
4 Ferizaj	PP.I. 57/15	29.09.2015	02.11.2015	34 ditë	
5 Prishtinë	PP.nr.218-7/08	17.09.2008	13.10.2008	26 ditë	
6 Prishtinë	PP.Nr. 642-1/2012	14.01.2014	31.01.2014	17 ditë	
7 Gjakovë	PP.nr. 121/2013	18.11.2013	03.12.2013	15 ditë	
8 Prishtinë	PP.nr.5345-4/11	26.10.2011	08.11.2011	13 ditë	
9 Prishtinë	PP.I.nr. 112/2016	16.09.2016	28.09.2016	12 ditë	
10 Prishtinë	PP.nr.268-7/10	08.06.2010	18.06.2010	10 ditë	

Tabela 10 - Zvarritjet prokurorëve në procedimin e aktakuzave në gjykata

c) Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore

Dështimet në respektimin e afateve ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit paraqiten në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë, përfshi zvarritjet në polici, prokurori dhe gjykata.⁹⁰ Zvarritjet në zgjidhjen e rasteve ndikojnë drejtpërdrejt në shkeljen e të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës,⁹¹ të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.⁹²

IKD përmes monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në prokurori dhe gjykata, përfshi të gjitha fazat e procedurës penale, paraqet gjendjen reale se sa kohë iu merr institucioneve përgjegjëse për trajtimin e një lënde të korrupsionit, prej kohës së inicimit të kallëzimit penal deri në shpalljen e aktgjykimit, si dhe vonesat dhe shkeljet e identifikuar gjatë trajtimit të rasteve.

Prej 1,505 seancave gjyqësore të monitoruara në shtatë GjTh, ku për analizë përfshihen 383 raste të korrupsionit, IKD ka identifikuar shkelje në të gjitha fazat e procedurës penale. IKD ka vendosur disa indikatorë për të matur në secilën fazë të procedurës penale kohën e kaluar për trajtimin e rastit përfshi:

Kohën e trajtimit të kallëzimit penal deri në fillimin e hetimeve⁹³ 2) kohën e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve; 3) kohën e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës⁹⁴; 4) kohën e trajtimit prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës; 5) kohën e trajtimit prej ngritjes së kallëzimit penal deri në ngritjen e aktakuzës; 6) koha prej ngritjes së aktakuzës deri në caktimin e shqyrtimit fillestar⁹⁵; 7) koha prej shqyrtimit fillestar deri në caktimin e shqyrtimit të

⁹⁰ Mihtaraj E. dhe Musliu B. "Luftimi i korrupsionit në Kosovë, prioritet në letër". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, 10 dhjetor 2015.

⁹¹ Raporti i vjetor i punës 2014, Nr.14. Fq. 137. Avokati i Popullit. Prishtinë 2015. (Shih linkun http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/RAPORTI_2014_-_SHQIP_932837.pdf). (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2016).

⁹² Neni 31 "E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm". Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 15 qershor 2008.

⁹³ Neni 82, "Hudhja e kallëzimit penal të policisë". 1. Prokurori i shtetit me aktvendim e hudh kallëzimin penal të pranuar nga policia apo burime tjera brenda tridhjetë (30) ditëve, nëse nga raporti është e qartë se: 1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer vepër penale; 1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale; 1.3. vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje; 1.4. i dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është miratuar nga organi kompetent; ose 1.5. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

⁹⁴ Neni 159, "Afatet kohore të hetimit", 1. Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

⁹⁵ Neni 242, "Procedura për ngritjen e aktakuzës"; Paragrafët 4 dhe 5; 4. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës. 5. Nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo

dytë⁹⁶; 8) koha prej shqyrtimit të dytë deri në caktimin e shqyrtimit kryesor; 9) numri i seancave të mbajtura dhe 10) koha e trajtimit prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë⁹⁷.

Bazuar në këta indikatorë, IKD ka bërë matjen e 353⁹⁸ rasteve të korrupsionit të monitoruara në këtë periudhë raportuese (janar – dhjetor 2016). Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, gjetjet e IKD-së tregojnë se prokurorët dhe gjykatësit vazhdimisht shkelin afatet e përcaktuara ligjore në KPPRK-së. Në tabelën më poshtë, IKD ka paraqitur të gjithë indikatorët e fazave të caktuara të procedurës penale dhe mesataren e kohës së kaluar për secilën fazë si rezultat i monitorimit dhe hulumtimit praktik dhe analizës ligjore.⁹⁹

më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.


⁹⁶ Neni 245, "Shqyrtimi fillestar", paragrafi 5. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012

⁹⁷ Kapitulli XIX, SHQYRTIMI GJYQËSOR, Neni 285 Caktimi i shqyrtimit gjyqësor, paragrafi 2) 2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton fillimin e shqyrtimit gjyqësor brenda një (1) muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga urdhri i fundit i lëshuar nga neni 254, paragrafi 5. i këtij Kodi. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

Neni 314, "Koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor"; 1. Përveç në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shtyn shqyrtimin gjyqësor nga neni 310 i këtij Kodi, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda këtyre afateve kohore: 1.1. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjëres prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni; 1.2. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda njëqindnjëzet (120) ditësh, përveç nëse trupi gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjëres prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni. 2. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet me aktvendimin të arsyetuar nga paragrafi 1. i këtij neni kur ekzistojnë rrethana të cilat kërkojnë më shumë kohë, përfshirë por pa u kufizuar në: 2.1. numër të shumtë të dëshmitarëve; 2.2. dëshmia e një apo më shumë dëshmitarëve është shumë e gjatë; 2.3. numri i provave është jashtëzakonisht i madh; 2.4. siguria e shqyrtimit gjyqësor bën të nevojshme vazhdimin. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 3. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet për tridhjetë (30) ditë për secilin aktvendim nga paragrafi 1. i këtij neni.

⁹⁸ *Sqarim*: Në këtë analizë nuk janë përfshirë 30 rastet e korrupsionit të kthyer në rigjykim, pasi për këto raste është bërë analizë e vecantë .

⁹⁹ *Shënim*: Matjet e realizuara për secilin indikatorë në secilën fazë dallojnë për sa i përket numrit të rasteve. IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të kompletoj të dhënat për secilën fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë.



Grafika 7 - Mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale në rastet e monitoruara të korrupsionit

Siç vërehet në tabelë, nga mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale në 353¹⁰⁰ rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezultojnë se prokuroritë dhe gjykatat në faza të ndryshme të procedurës penale nuk respektojnë¹⁰¹ afatet ligjore të përcaktuara në KPPRK-së.

¹⁰⁰Sqarim: IKD bën të qartë se për secilin indikatorë, për të cilët është nxjerrë mesatarja, është bazuar në rastet në të cilat janë kompletuar të dhënat dhe numri i rasteve për secilin indikatorë ndryshon. Pra, siç mund ta vëreni në tabelë, kalkulimet janë bërë vetëm për numrin e rasteve për të cilat ekzistojnë të gjitha të dhënat.

¹⁰¹Shënim: Bazuar në procedurën e re penale, prej kohës së paraqitjes së kallëzimit penal, prokurori ka kohë që brenda 30 ditëve të vendos nëse do të fillojë hetimin apo të hudhë kallëzimin penal. Ky kufizim i afatit kohor nuk ka qenë i përcaktuar në procedurën e vjetër penale dhe kjo ju ka krijuar mundësi të keqpërdorimit prokurorëve, të cilët me dekada nuk kanë ndërmarr asnjë veprim ligjor në trajtimin e kallëzimeve penale. Koha prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve mund të marr kohë 24 muaj, eventualisht nëse rasti është i komplikuar hetimi mund të zgjatet nga Gjykata edhe për gjashtë (6) muaj. 2. Prokurori i shtetit menjëherë një kopje të aktvendimit sipas paragrafit 1. të këtij neni ia dërgon policisë.3. Prokurori i shtetit brenda tetë (8) ditësh nga hudhja e kallëzimit njofton të dëmtuarin për hudhjen e kallëzimit dhe arsyet për këtë. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

- Në 288 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit të kallëzimit penal nga prokurorët është 205 ditë.
- Në 293 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve është 192 ditë.
- Në 294 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës është 196 ditë.
- Në 301 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës është 1 ditë.
- Në 40 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit të kallëzimit penal deri në ngritjen e aktakuzës së drejtpërdrejtë është 336 ditë.
- Në 319 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej ngritjes së aktakuzës deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar është 274 ditë.
- Në 165 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej seancës fillestare deri në mbajtjen e shqyrtimit të dytë është 56 ditë.
- Në 134 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej shqyrtimit të dytë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor është 112 ditë.
- Në 372 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e seancave të mbajtura për secilin rast është 6 seanca.
- Në 142 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit është 220 ditë.

Në vazhdim është analizuar mesatarja e kohës së kaluar në secilën fazë të procedurës penale, për të gjitha rastet e monitoruara për secilën prokurori dhe gjykatë.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë në trajtimin e kallëzimeve penale janë PTh në Mitrovicë, PTh në Ferizaj dhe PTh në Prishtinë. Mesatarja e trajtimit të kallëzimit penal deri në vendimin për fillimin e hetimeve nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

- PTh në Mitrovicë për 27 raste të monitoruara ka marr kohë 395 ditë.
- PTh në Ferizaj për 27 raste të monitoruara ka marr kohë 284 ditë.
- PTh në Prishtinë për 116 raste të monitoruara ka marr kohë 271 ditë.
- PTh në Pejë për 18 raste të monitoruara ka marr kohë 88 ditë.
- PTh në Gjakovë për 24 raste të monitoruara ka marr kohë 85 ditë.
- PTh në Prizren për 36 raste të monitoruara ka marr kohë 85 ditë.
- PTh në Gjilan për 40 raste të monitoruara ka marr kohë 65 ditë.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë në hetimet penale janë PTh në Mitrovicë, PTh në Gjakovë dhe PTh në Ferizaj. Mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

- PTh në Mitrovicë për 27 raste të monitoruara ka marr kohë 272 ditë.
- PTh në Gjakovë për 25 raste të monitoruara ka marr kohë 272 ditë.
- PTh në Ferizaj për 27 raste të monitoruara ka marr kohë 238 ditë.
- PTh në Pejë për 18 raste të monitoruara ka marr kohë 204 ditë.
- PTh në Prizren për 36 raste të monitoruara ka marr kohë 197 ditë.
- PTh në Prishtinë për 120 raste të monitoruara ka marr kohë 174 ditë.
- PTh në Gjilan për 40 raste të monitoruara ka marr kohë 99 ditë.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzave janë PTh në Mitrovicë, PTh në Gjakovë dhe PTh në Ferizaj. Mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

- PTh në Mitrovicë për 27 raste të monitoruara ka marr kohë 273 ditë.
- PTh në Gjakovë për 25 raste të monitoruara ka marr kohë 273 ditë.
- PTh në Ferizaj për 27 raste të monitoruara ka marr kohë 239 ditë.
- PTh në Pejë për 18 raste të monitoruara ka marr kohë 205 ditë.
- PTh në Prizren për 36 raste të monitoruara ka marr kohë 199 ditë.
- PTh në Prishtinë për 121 raste të monitoruara ka marr kohë 182 ditë.
- PTh në Gjilan për 40 raste të monitoruara ka marr kohë 101 ditë.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës janë PTh në Gjakovë dhe PTh në Gjilan. Mesatarja e trajtimit prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

- PTh në Gjakovë për 25 raste të monitoruara ka marr kohë 2 ditë.
- PTh në Gjilan për 40 raste të monitoruara ka marr kohë 2 ditë.
- PTh në Ferizaj për 27 raste të monitoruara ka marr kohë 1 ditë.
- PTh në Prizren për 36 rast të monitoruara ka marr kohë 1 ditë.
- PTh në Mitrovicë për 27 raste të monitoruara ka marr kohë 1 ditë.
- PTh në Prishtinë për 127 raste të monitoruara ka marr kohë 1 ditë.
- PTh në Pejë për 19 raste të monitoruara ka marr kohë 1 ditë.

Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej ngritjes së aktakuzës deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar janë GjTh në Mitrovicë, GjTh në Prishtinë dhe GjTh në Gjilan. Mesatarja e kohës prej ngritjes së aktakuzës deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:

- GjTh në Mitrovicë për 35 raste të monitoruara ka marr kohë 545 ditë.
- GjTh në Prishtinë për 128 raste të monitoruara ka marr kohë 322 ditë.
- GjTh në Gjilan për 41 raste të monitoruara ka marr kohë 250 ditë.
- GjTh në Pejë për 22 raste të monitoruara ka marr kohë 231 ditë.
- GjTh në Ferizaj për 30 raste të monitoruara ka marr kohë 188 ditë.
- GjTh në Gjakovë për 27 raste të monitoruara ka marr kohë 155 ditë.
- GjTh në Prizren për 36 raste të monitoruara ka marr kohë 56 ditë.

Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej seancës fillestare deri në mbajtjen e shqyrtimit të dytë janë GjTh në Mitrovicë, GjTh në Prishtinë dhe GjTh në Gjilan. Mesatarja e kohës prej seancës fillestare deri në mbajtjen e shqyrtimit të dytë nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:

- GjTh në Mitrovicë për 4 raste të monitoruara ka marr kohë 100 ditë.
- GjTh në Prishtinë për 80 raste të monitoruara ka marr kohë 61 ditë.
- GjTh në Gjilan për 17 raste të monitoruara ka marr kohë 52 ditë.
- GjTh në Ferizaj për 4 raste të monitoruara ka marr kohë 51 ditë.
- GjTh në Gjakovë për 19 raste të monitoruara ka marr kohë 48 ditë.
- GjTh në Prizren për 28 raste të monitoruara ka marr kohë 48 ditë.
- GjTh në Pejë për 13 raste të monitoruara ka marr kohë 42 ditë.

Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej shqyrtimit të dytë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor janë GjTh në Gjilan, GjTh në Pejë dhe GjTh në Prishtinë. Mesatarja e kohës prej shqyrtimit të dytë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:

- GjTh në Gjilan për 16 raste të monitoruara ka marr kohë 149 ditë.
- GjTh në Pejë për 9 raste të monitoruara ka marr kohë 142 ditë.
- GjTh në Prishtinë për 62 raste të monitoruara ka marr kohë 118 ditë.
- GjTh në Ferizaj për 4 raste të monitoruara ka marr kohë 111 ditë.
- GjTh në Mitrovicë për 3 raste të monitoruara ka marr kohë 93 ditë.
- GjTh në Prizren për 25 raste të monitoruara ka marr kohë 86 ditë.
- GjTh në Gjakovë për 15 raste të monitoruara ka marr kohë 78 ditë


Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit janë GjTh në Prishtinë, GjTh në Prizren dhe GjTh në Gjakovë. Mesatarja e kohës prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:

- GjTh në Prishtinë për 37 raste të monitoruara ka marr kohë 402 ditë.
- GjTh në Prizren për 18 raste të monitoruara ka marr kohë 237 ditë.
- GjTh në Gjakovë për 18 raste të monitoruara ka marr kohë 195 ditë.
- GjTh në Gjilan për 21 raste të monitoruara ka marr kohë 164 ditë.
- GjTh në Ferizaj për 20 raste të monitoruara ka marr kohë 163 ditë.
- GjTh në Pejë për 11 raste të monitoruara ka marr kohë 116 ditë.
- GjTh në Mitrovicë për 17 raste të monitoruara ka marr kohë 39 ditë.

d) Kohëzgjatja e rasteve të korrupsionit deri në shpalljen e aktgjykimit në 181 raste të monitoruara nga IKD

Gjatë monitorimit të IKD-së në vitin 2016, Gjykatat kanë shpallur 181 aktgjykime për rastet e korrupsionit. Në të gjitha këto raste, në të cilat janë shpallur aktgjykimet, IKD ka analizuar kohëzgjatjen e secilës fazë të procedurës penale dhe respektimin e afateve ligjore të përcaktuara në KPPRK-së. Në tabelat në vijim janë paraqitur dy faza të rëndësishme për të matur kohëzgjatjen e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, prej fillimit të kallëzimit penal dhe prej ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë. Shih tabelat në vazhdim.


Kohëzgjatja prej kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit



Grafika 8 - Kohëzgjatja prej trajtimit të kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit në 93¹⁰² raste të monitoruara nga IKD gjatë periudhës janar-qershor 2016.

¹⁰² Shënim: IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të kompletoj të dhënat për këtë fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë.

Kohëzgjatja prej kallëzimit penal deri në shpalljen e aktgjykimit




Grafika 9 - Kohëzgjatja prej trajtimit të kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit në 88¹⁰³ raste të monitoruara nga IKD gjatë periudhës korrik-dhjetor 2016.

Sipas grafikës më lartë shihet se koha më e shkurtë e trajtimit të rastit të korrupsionit nga koha e paraqitjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit është 68 ditë, përderia rasti që ka marr më së shumti kohë deri në shpallje të aktgjykimit është 4917 ditë apo mbi 13 vjet. Grafika e më poshtme paraqet kohëzgjatjen prej ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit. Sipas rasteve të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se koha më e shkurtë ka qenë 27 ditë, ndërsa rasti që ka marr më së shumti kohë është në 3816 ditë apo mbi 10 vjet.


¹⁰³ *Shënim:* IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të kompletoj të dhënat për këtë fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë.

Kohëzgjatja prej ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit



Grafika 10 – Kohëzgjatja prej ngritjes së aktakuzës deri në shpallje të aktgjykimit në 93 raste të monitoruara nga IKD gjatë periudhës janar-qershor 2016.

Kohëzgjatja prej ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit




Grafika 11 – Kohëzgjatja prej ngritjes së aktakuzës deri në shpallje të aktgjykimit në 88¹⁰⁴ raste të monitoruara nga IKD gjatë periudhës korrik-dhjetor 2016.

¹⁰⁴ Shënimi: IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të kompletoj të dhënat për këtë fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë.

e) Monitorimi i rasteve të korrupsionit të kthyer në rigjykim

Gjatë monitorimit të 383 rasteve të korrupsionit në periudhën njëvjeçare (janar-dhjetor 2016), monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar 30 raste të cilat janë kthyer në rigjykim. Nga këto 30 raste, 6 raste i përkasin GjTh në Prishtinë, 2 raste GjTh në Ferizaj, 5 raste GjTh në Prizren, 8 raste GjTh në Gjiilan, 5 raste GjTh në Pejë, 3 raste GjTh në Gjakovë dhe 1 rast GjTh në Mitrovicë.

IKD edhe në këto raste ka vendosur indikatorët për matjen e kohës së kaluar për trajtimin e rastit në secilën fazë të procedurës penale, mirëpo fokusi kryesor ka qenë në këto tri faza: 1) kohën e ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit të parë; 2) kohën nga shpallja e aktgjykimit të parë deri në aktvendimin për kthimin e lëndës në gjykatë dhe 3) kohën nga aktvendimi për kthimin e lëndës në gjykatë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor. Gjetjet e IKD-së tregojnë që gjyqtarëve dhe prokurorëve i'u duhen vite për të filluar apo përfunduar një rast. Në grafikën më poshtë, IKD ka paraqitur indikatorët e tre fazave të lartpërmendura me mesatarën e kohës së kaluar për secilën fazë¹⁰⁵.



Grafika 12- Mesatarja e kohëzgjatjes së tre fazave të procedurës penale në 30 rastet e korrupsionit të kthyer në rigjykim

¹⁰⁵ Shënim: Matjet e realizuara për secilin indikatorë në secilën fazë dallojnë për sa i përket numrit të rasteve. IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të kompletoj të dhënat për secilën fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë, e që gjatë kësaj periudhe raportuese, këto të dhëna janë kompletuar për 28 raste.

Siç vërehet në grafikë, nga mesatarja e kohëzgjatjes së tre fazave të procedurës penale në 30 rastet e korrupsionit të kthyer në rigjykim, e të cilat janë monitoruar nga IKD, del se duhet të kalojnë së paku gati 10 muaj për të zhvilluar një fazë të procedurës.

- Në 28 raste të kthyer në rigjykim, rezulton se mesatarja e trajtimit prej ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit është 797 ditë.
- Në 28 raste të kthyer në rigjykim, rezulton se mesatarja e trajtimit prej shpalljes së aktgjykimit të parë deri në aktvendimin për kthimin e lëndës në gjykatë është 330 ditë.
- Në 28 raste të kthyer në rigjykim, rezulton se mesatarja e trajtimit prej aktvendimit për kthimin e lëndës në gjykatë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor është 291 ditë.

Nga 30 rastet e kthyer në rigjykim, për 25¹⁰⁶ prej tyre është shpallur aktgjykimi i dytë. Mesatarja e kohës së kaluar nga shqyrtimi kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit për 24 raste prej tyre është 202 ditë.

Gjetjet e IKD-së, nga procesi i monitorimit të rasteve të korrupsionit të kthyer në rigjykim, tregojnë se në 24 rastet me 42 persona ndaj të cilëve është marr aktgjykim i dytë, një person ka marr dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj, një person dënim me kusht në kohëzgjatje prej 3 muaj, dy persona dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, një person dënim me kusht në kohëzgjatje prej 8 muaj, shtatë persona¹⁰⁷ kanë marr dënim me kusht në kohëzgjatje prej 12 muaj secili, dy persona kanë marr dënim me kusht në kohëzgjatje prej 24 muaj secili, dy persona kanë marr dënim me kusht në kohëzgjatje prej 36 muaj secili, për njëzetënjë persona është shpallur aktgjykim lirues, për një person¹⁰⁸ është hudhur aktakuza për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme se është kryer vepra penale, ndërsa gjykatësit ndaj katër personave kanë hudhur aktakuza për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit.

Ndërkaq, nga 30 rastet e analizuara, 1 rast është kthyer për të dytën herë në rigjykim. Pas shpalljes së aktgjykimit të dytë, Gjykatës së Apelit i'u janë dashur 451 ditë për ta kthyer atë përsëri në rigjykim, ndërkaq Gjykatës Themelorë në Prizren i'u janë dashur 359 ditë nga data e rikthimit deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor. Ndërkaq, nga

¹⁰⁶ *Sqarim:* Përkundër kërkesave dhe përpjekjeve të shumta të monitoruesve të IKD-së për të siguruar të dhënat për një lëndë të kthyer në rigjykim në GjTh në Mitrovicë, deri më tani nuk është marrë asnjë përgjigje konkrete.


¹⁰⁷ *Shënim:* Dy nga personat e dënuar me nga 12 muaj burgim me kusht, i toakojnë profilin të lartë, pasi janë dy ish-ministra të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

¹⁰⁸ *Shënim:* Personi ndaj të cilit është hudhur poshtë aktakuza, i takon profilin të lartë, pasi është kryetari i Komunës së Kllokotit.

mbajtja e shqyrtimit kryesor janë dashur 566 ditë për të përfunduar lënda për të tretën herë.

a) Profili i personave të gjykuar në rastet e korrupsionit të monitoruar nga IKD gjatë vitit 2016

Profili i 989 personave të akuzuar në këto 383 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD gjatë kësaj periudhe raportuese (*janar-dhjetor 2016*) është i kryesisht i ulët dhe i mesëm dhe një numër i kufizuar i personave të akuzuar i takon profilit të lartë.



Grafika 13 - Profili i 989¹⁰⁹ personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në Gjykata Themelore gjatë periudhës raportuese (*janar-dhjetor 2016*)

¹⁰⁹ *Sqarim:* Shtatë persona të akuzuar prej të cilëve dy i takojnë profilit të ulët dhe pesë profilit të lartë, janë të përfshirë në më shumë se 1 rast.

Profili i lartë i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në muajt janar-dhjetor 2016	Prishtinë	Prizren	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Ferizaj	Gjakovë	Total:
Kryetar Gjykatë	2 ¹¹⁰	1 ¹¹¹	0	0	0	0	0	3
Kryeprokurorë	0	0	0	1	0	0	0	1
Kryetarë Komune	3	1	1	4 ¹¹²	2	0	1	12
Deputetë	3	0	0	0	0	0	0	3
Ministra	4 ¹¹³	0	0	0	0	0	0	4
Sekretar i Përhershëm në Ministri	1	0	0	0	0	0	0	1
Kryetar i OSHP-së	1 ¹¹⁴	0	0	0	0	0	0	1
Kryeshef i Ekzekutivit të PTK	1	0	0	0	0	0	0	1
Rektor në Universitet	0	1	0	0	0	0	0	1

Tabela 11 - Profili i lartë i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në muajt janar-dhjetor 2016.

¹¹⁰ *Sqarim:* Një nga personat e akuzuar në këtë rast në cilësi të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, është i akuzuar edhe në një rast tjetër në cilësi të Rektorit të Universitetit të Prishtinës.

¹¹¹ *Sqarim:* Personi i akuzuar në këtë rast në cilësi të kryetarit të GjTh të Prishtinës, është i akuzuar edhe në një rast tjetër në GjTh në Prishtinë.

¹¹² *Sqarim:* Një nga personat e akuzuar në këtë rast, në cilësi të kryetarit të Komunës së Klllokotit, është i akuzuar edhe në tre raste të tjera në GjTh në Gjilan.

¹¹³ *Sqarim:* Një nga personat e akuzuar në këtë rast në cilësi të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, është i akuzuar edhe në një rast tjetër në GjTh në Prishtinë.

¹¹⁴ *Sqarim:* Personi i akuzuar në këtë rast në cilësi të kryetarit Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), është i akuzuar edhe në tre raste të tjera në GjTh në Prishtinë.

Profili i mesëm i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në muajt janar-dhjetor 2016	Prishtinë	Prizren	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Ferizaj	Gjakovë	Total
Prokurorë	1	0	0	1	0	0	0	2
Gjyqtarë	3	2	0	0	0	1	0	6
Zyrtarë në Ministri	33	1	0	3	0	4	3	44 ¹¹⁵
Zyrtarë në Komunë	56	23	14	29	15	19	18	174 ¹¹⁶
Zyrtarë në Gjykatë Kushtetuese	1	0	0	0	0	0	0	1
Zyrtarë në Polici	30	4	4	8	5	5	1	57 ¹¹⁷
Zyrtarë në Doganë	10	1	1	2	3	0	0	17
Drejtor i Pallat. Rinisë dhe Sporteve	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor në kompani publike	0	0	0	0	2	1	0	3
Drejtor në RTK	3	0	0	0	0	0	0	3
Drejtor në Teatër Kombëtar	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor i prokurimit në UP	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor i Institutit	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor në Bibliotekë Kombëtare	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor në OJQ	0	0	0	0	0	1	0	1
Drejtor në Klub futbollistik	0	1	0	0	0	0	0	1
Kryetar në Sindikatë	2	0	0	0	0	0	0	2 ¹¹⁸
Kryetar në Shoqatë	0	0	2	0	0	0	0	2
Zyrtarë në KEK	3	0	0	0	0	0	0	3 ¹¹⁹
Zyrtarë në KEDS	8	0	0	0	0	1	1	10
Zyrtarë në Agjenci	23	0	0	1	1	0	0	25 ¹²⁰
Zyrtarë në OSHP	2	0	0	0	0	0	0	2
Zyrtarë në Ambasadë	2	0	0	0	0	0	0	2 ¹²¹
Zyrtarë në PTK	6	0	0	0	0	0	0	6 ¹²²
Zyrtarë në shkollë publike	1	6	1	4	0	1	2	15 ¹²³
Zyrtarë në Spitale dhe QMF	0	1	0	1	3	2	0	7 ¹²⁴
Zyrtarë në QKUK	3	0	0	0	0	0	0	3 ¹²⁵
Zyrtarë në Borde	4	0	0	0	0	0	0	1
Avokatë	3	2	0	0	0	0	1	6 ¹²⁶

Tabela 12 – Profili i mesëm i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në muajt janar-dhjetor 2016.

¹¹⁵ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë një shef i kabinetit, pesë drejtorë, dy sekretar të përgjithshëm, një menaxher, shtatë inspektorë dhe njëzetetë zyrtarë tjerë.

¹¹⁶ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë tridhjetenëntë drejtorë, dy shefa të inspeksionit, njëzetetë inspektorë, një anëtar në Kuvend, katër këshilltar në Asamble, tre asambleistë dhe nëntëdhjeteshtatë zyrtarë tjerë.

¹¹⁷ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë një shef në polici dhe pesëdhjetegjashtë zyrtarë.

¹¹⁸ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë një kryetar në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) dhe një kryetar në Sindikatën e Shërbyesve Civil.

¹¹⁹ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë një drejtor dhe dy zyrtarë të prokurimit.

¹²⁰ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë një drejtor në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), nëntë zyrtarë në AKP, një drejtor në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA), tre zyrtarë në AKA, dy inspektorë në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), një zyrtar në Agjencionin Pyjor të Kosovës (APK), një kryeshef ekzekutiv në Agjencionin e Kosovës për Produkte Medicinale (AKPM), dy drejtorë në AKPM, një drejtor në Agjencionin Kundër Korrupsionit (AKK), një drejtor në Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), një drejtor në Agjencionin e Kosovës për inteligjencë (AKI), një drejtor në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar (AAPSM) dhe një Kryeinspektor i Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës.

¹²¹ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë një konsull dhe një zyrtar.

¹²² Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë dy drejtorë dhe katër zyrtarë tjerë.

¹²³ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë trembëdhjetë drejtorë dhe dy zëvendës drejtorë.

¹²⁴ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë katër drejtorë në spital rajonal, një shef i zyrës së prokurimit në spital rajonal, një zyrtar i prokurimit në spital rajonal dhe një drejtor në Qendrën e Mjekësisë Familjare.

¹²⁵ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë një drejtoreshë në barnatore, një menaxher i prokurimit dhe një zyrtar.

¹²⁶ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë tre avokatë privat dhe pesë avokatë publik (njëri i përfshirë në dy lëndë).

Tabela 13 - Profili i ulët i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në muajt janar-dhjetor 2016	Pristinë	Prizren	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Ferizaj	Gjakovë	Total:
Biznesmen	69	1	4	1	3	1	0	79
Qytetarë	80	10	2	5	7	6	2	112
Drejtor në kompani private	8	2	0	1	3	1	1 ¹²⁷	16
Zyrtarë në bankë	11	7	0	1	3	3	3	28
Zyrtarë në auto shkollë	3	3	0	2	1	0	0	9 ¹²⁸
Zyrtarë në OJQ	4	0	0	0	0	1	0	5
Zyrtarë në BSPK	2	0	0	0	0	0	0	2
Zyrtarë në Kolegj privat	1	1	0	0	0	0	0	2
Zyrtarë në shkollë publike	0	11	1	2	0	0	2	16 ¹²⁹
Zyrtarë në Universitet	0	2	0	0	0	0	0	2
Zyrtarë në Qendrën për Patentë Shofer	0	0	2	0	1	0	0	3
Zyrtarë në KEP Trust	0	0	0	0	0	0	1	1
Zyrtarë në kompani publike	0	0	1	0	0	0	0	1
Punëtorë në kompani private	22	0	1	0	6	6	4	39
Punëtorë në kompani publike	0	0	0	4	2	2	0	7
Punëtorë në Institucione Shtetërore	9	1	0	3	3	1	6	23 ¹³⁰
Punëtorë në spital rajonal	0	0	0	0	0	2	0	2
Punëtorë në QMF	1	1	0	0	0	0	0	2
Punëtorë sigurimi	3	0	0	0	0	0	0	3
Punëtorë në PTK	6	0	0	0	1	0	0	7
Punëtorë në KEDS	8	0	0	3	0	0	0	11
Punëtorë në KEK	3	0	1	0	4	0	0	8
Punëtorë në Bibliotekë Kombëtare	1	0	0	0	0	0	0	1
Punëtorë në Agjenci	8	0	0	0	0	0	0	8 ¹³¹
Punëtorë në Shoqatë	2	0	1	0	1	0	0	4
Punëtorë në PK	1	0	1	0	0	0	0	2
Punëtor në park nacional	0	1	0	0	0	0	0	1
Punëtorë në Teatër Kombëtar	1	0	0	0	0	0	0	1
Punëtorë në Stacion të Autobusëve	1	0	0	0	0	0	0	1
Këshilltar politik	1	0	0	0	0	0	0	1
Noter	0	1	0	0	0	0	0	1
Përmbaues privat	1	0	0	0	0	0	0	1
Ekspert mjeko-ligjor	0	0	0	0	0	1	0	1
Oficer Korrektues	7	1	3	0	0	0	0	11
Doktor	70	0	2	2	1	0	2	77 ¹³²
Farmacist	1	0	0	0	0	0	0	1
Inxhinierë	5	0	0	0	1	0	0	6
Producentë	2	0	0	0	0	0	0	2
Inkasantë	0	5	0	0	0	35	0	40
Roje pylli	5	5	1	1	0	0	0	12
Pylltar	0	0	1	0	2	0	0	3
Vozitës	0	0	0	2	0	1	0	3
Konduktorë	4	0	0	0	0	0	0	4
Komisioner në zgjedhje	0	0	0	1	0	0	0	1

¹²⁷ Sqarim: Personi i akuzuar në këtë rast, është i akuzuar edhe një rast tjetër në GjTh në Gjakovë.

¹²⁸ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë shtatë instruktorë dhe dy egzaminer.

¹²⁹ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë dy sekretarë, dymbëdhjetë mësimdhënës dhe dy zyrtarë tjerë.

¹³⁰ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë dymbëdhjetë punëtorë në Komunë, dy punëtorë në Doganë, një punëtor në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe tetë punëtorë në Gjykatë.

¹³¹ Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë pesë punëtorë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe dy punëtorë në Agjencionin Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës.

¹³² Sqarim: Në këtë kategori janë të përfshirë tre mjekë dhe një infermiere në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), një mjek në spital regional, tre kirurgë në spital rajonal, katër mjek dhe një infermiere në ordinancë private, një kardiolog dhe gjashtëdhjetë mjekë të tjerë.

11.POLITIKA E DËNIMEVE NË RASTET E KORRUPSIONIT

a) Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit gjatë vitit 2016

IKD si rezultat i monitorimit të rasteve të korrupsionit në fazën e e shpalljës së aktgjykimit denues, gjen se se politika e dënimeve në rastet e korrupsionit është e butë. Në 181 aktgjykime të shpallura në shkallë të parë në rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se gjykatësit kryesisht zbatojnë politikë të butë ndëshkimore, ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit. Në vazhdim është paraqitur tabela, e cila pasqyron vendimet e shqiptuara nga ana e gjykatësve në këto 181 aktgjykime për rastet e korrupsionit. Shih tabelën.

Dënim me burg		Dënim me kusht		Dënim me gjobë		Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Hudhje aktakuzës - parashkrim
Persona	Muaj	Persona	Muaj	Persona	Shuma në euro	Persona	Persona	Persona
63 ¹³³	878	61 ¹³⁴	710	22	47,450	115	79	26

a) Tabela 14 - Rastet e aktgjykimeve të monitoruara nga IKD.

Gjetjet e IKD-së, nga procesi i monitorimit të rasteve të korrupsionit, tregojnë se në rastet ndaj 366 personave ndaj të cilëve është marr aktgjykim në shkallë të parë, ndaj 63 personave kanë marr aktgjykim me dënim me burg, në total prej tetëqindeshtatëdhjetëetë (878) muajve apo shtatëdhjetëetë (73) vite e dy (2) muaj për të gjithë personat e dënuar.

Nga 63 personat e dënuar dy persona janë dënuar me nga 2 muaj burg, dy persona janë dënuar me nga 3 muaj burg, dy persona janë dënuar me nga 4 muaj burg, pesë persona¹³⁵ janë dënuar me nga 5 muaj burg, dhjetë persona¹³⁶ janë dënuar me nga 6 muaj burg, katër persona¹³⁷ janë dënuar me nga 7 muaj burg, dy persona¹³⁸ janë dënuar

¹³³ Sqarim: Nga 63 personat e dënuar me burg, 17 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 15,600 euro.

¹³⁴ Sqarim: Nga 61 personat e dënuar me kusht, 10 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 6,550 euro.

¹³⁵ Sqarim: Një nga pesë personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 5 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 200 euro

¹³⁶ Sqarim: Një nga dhjetë personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 400 euro

¹³⁷ Sqarim: Tre nga katër personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 7 muaj, janë të njëjtit të cilëve i'u është shqiptuar edhe dënimi me gjobë, dy prej tyre në vlerë prej nga 600 euro dhe të tretit dënimi në vlerë 400 euro.

me nga 8 muaj burg, dy persona janë dënuar me nga 10 muaj burg, pesëmbëdhjetë persona¹³⁹ janë dënuar me nga 12 muaj burg, një person është dënuar me 14 muaj burg, një person është dënuar me 16 muaj burg, tre persona janë dënuar me nga 18 muaj burg, tre persona janë dënuar me nga 20 muaj burg, dy persona¹⁴⁰ janë dënuar me nga 24 muaj burg, një person është dënuar me 27 muaj burg, katër persona janë dënuar me nga 30 muaj burg, tre persona janë dënuar me nga 36 muaj burg dhe një person është dënuar me 84 muaj burg.

Gjykatësit ndaj 61 personave kanë shqiptuar dënime me kusht prej 710 muajve. Ndaj një personi¹⁴¹ kanë marr aktgjykim me dënim me kusht për 1 muaj, ndaj tre¹⁴² personave dënim me kusht nga 2 muaj, ndaj tre personave¹⁴³ dënim me kusht nga 3 muaj, ndaj një personi dënim me kusht për 4 muaj, ndaj trembëdhjetë personave¹⁴⁴ dënim me kusht nga 6 muaj, ndaj pesë¹⁴⁵ personave dënim me kusht nga 8 muaj, ndaj dy personave dënim me kusht nga 10 muaj, ndaj shtatëmbëdhjetë¹⁴⁶ personave dënim me kusht nga 12 muaj, ndaj pesë personave dënim me kusht nga 18 muaj, ndaj tre personave dënim me kusht nga 22 muaj dhe ndaj tetë personave¹⁴⁷ dënim me kusht nga 24 muaj.

Dështimi i aktakuzave në shqyrtim kryesor:

IKD gjatë procesit të monitorimit të rasteve të korrupsionit në shqyrtim kryesor dhe gjatë shpalljës së aktgjykimit ka gjetur, se shumica e aktakuzave të ngritura nga prokuroria nuk po mund të mbrohen dhe provohen në gjykatë. Kjo vë në pikpyetje profesionalizmin e prokurorëve në hetimin, grumbullimin e dëshmive dhe forcon

¹³⁸ *Sqarim:* Një nga dy personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 8 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 600 euro

¹³⁹ *Sqarim:* Nëntë nga pesëmbëdhjetë personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 12 muaj, janë të njëjtit të cilëve i'u është shqiptuar edhe dënimi me gjobë, për një prej tyre dënimi në vlerë prej 200 euro, për gjashtë prej tyre nga 1,000 euro, për një prej tyre dënimi në vlerë prej 1,500 euro, ndërsa të nëntit dënimi në vlerë prej 2,000 euro.

¹⁴⁰ *Sqarim:* Një nga dy personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 24 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 3,000 euro.

¹⁴¹ *Sqarim:* Personi i dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 1 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 500 euro.

¹⁴² *Sqarim:* Një nga tre personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 2 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 150 euro.

¹⁴³ *Sqarim:* Një nga tre personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 3 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 300 euro.

¹⁴⁴ *Sqarim:* Një nga trembëdhjetë personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 500 euro.

¹⁴⁵ *Sqarim:* Një nga pesë personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 8 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 2,000 euro.

¹⁴⁶ *Sqarim:* Tre nga shtatëmbëdhjetë personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 12 muaj, janë të njëjtit të cilëve i'u është shqiptuar edhe dënimi me gjobë, për dy prej tyre nga 200 euro, ndërsa të tretit dënimi në vlerë prej 700 euro.


¹⁴⁷ *Sqarim:* Dy nga tetë personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 24 muaj, janë të njëjtit të cilëve i'u është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 1,000 euro.

akuzat publike për ngritje të aktakuzave pa bazë dhe sipas agjendave të grupeve të interesit. Statistikat e më poshtme e dëshmojnë këtë.

Gjykatat gjatë vitit 2016, kanë shpallur aktgjykime ndaj 366 personave subjekt të procedurave penale të korrupsionit. Në aktgjykimet e shpallura ndaj 366 personave, 220 prej janë liruar nga përgjegjësia penale përmes aktgjykimeve liruese, refuzuese apo për shkak të parashkrimit. Respektivisht, mbi 60% të personave janë liruar nga përgjegjësia penale apo prokuroria ka dështuar të provojë përgjegjësinë penale ndaj tyre në gjykatë. Kjo dukuri padyshim së është shqetësuese sepse kjo dëshmon osë jokompetencën e prokurorëve për të trajtuar rastet e korrupsionit në mënyrë profesionale apo kemi të bëjme me aktakuza përmes së cilave qytetarët e Kosovës persekutohen. Shqetësim është edhe parashkrimi i lëndëve të korrupsionit.

Gjykata ndaj 146 personave ka shpallur aktgjykim denues, me kusht apo me gjobë. Si rezultat i monitorimit IKD, ka gjetur se Gjykatat kanë dënuar me burg efektiv 63 persona apo 17,2 % të personave të akuzuar, ndaj 61 personave kanë shqiptuar dënime me kusht apo ndaj 16,6%, të personave të akuzuar, dhe me gjobë 22 persona.

Në këto raste të korrupsionit në të cilat ka pasur shpallje të aktgjykimit, janë përfshirë të gjitha profilet e personave të akuzuar. Prej tyre, 229 persona i takojnë profilit të ulët, 128 persona profilit të mesëm dhe 9 persona i takojnë të profilit të lartë.



Grafika 14 - Profili i 366 personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, për të cilët është shpallur aktgjykim në Gjykata Themelore gjatë periudhës raportuese (janar-dhjetor 2016)



Tabela 15 – Profili i lartë i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, për të cilët është shpallur aktgjykim në Gjykata Themelore gjatë periudhës raportuese (janar-dhjetor 2016)

IKD pa dashur të komentoj meritën e vendimmarrjes në rastet gjyqësore të korrupsionit, shpreh shqetësimin se politika ndëshkimore që zbatohet nga gjykatësit në rastet e korrupsionit, nuk është duke dërguar mesazh të qartë të kryesit potencial të këtyre veprave penale. Praktika e tillë ndëshkimore, duke shqiptuar dënime të buta më burg apo dënime me kusht dhe me gjobë, përçon mesazh negativ tek qytetarët dhe publiku. Po ashtu, këto dënime të buta të shqiptuara nuk mund të arrijnë qëllimin e vet për të cilat është shqiptuar dënimi, qoftë atë të karakterit ndëshkimor ndaj atyre, të cilët janë gjetur fajtor se kanë kryer vepra penale të korrupsionit, apo të karakterit preventiv, i cili ka për qëllim për të dërguar mesazhin e qartë tek personat të cilët mund të jenë subjekt i kryerjes së veprave penale të korrupsionit.

b) Analizë krahasuese e politikës së dënimeve në rastet e korrupsionit 2014, 2015, 2016

Në tabelën në vazhdim është paraqitur një krahasim rreth efikasitetit të trajtimit të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2014, 2015 dhe 2016 nga GjTh në Kosovë.¹⁴⁸

Gjykatat në fillim të vitit 2016 kanë pasur 407 lëndë të pazgjidhura të korrupsionit me 956 persona të përfshirë. Gjatë këtij viti gjykatësit kanë pranuar në punë 232 lëndë të reja me 502 persona, që rezulton se gjykatata gjatë vitit 2016 kanë pasur në punë 639 lëndë të korrupsionit me 1458 persona. Gjatë vitit 2016 gjykatat kanë zgjidhur 284 lëndë 594 persona, ndërsa më 31 dhjetor 2016 kanë mbetur 355 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 864 persona.


Për dallim nga viti 2016, në fillim të vitit 2015, gjykatat kanë pasur 391 lëndë të pazgjidhura të korrupsionit me 932 persona të përfshirë. Gjatë këtij viti gjykatësit kanë pranuar në punë 238 lëndë të reja me 436 persona, që rezulton se gjykatata gjatë vitit 2015 kanë pasur në punë 629 lëndë të korrupsionit me 1368 persona. Gjatë vitit 2015 gjykatat kanë zgjidhur 200 lëndë 326 persona, ndërsa më 31 dhjetor 2015 kanë mbetur 429 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 1042 persona.

Ndërsa, në fillim të vitit 2014, Gjykatat kanë pasur 389 lëndë të pazgjidhura të korrupsionit me 820 persona të përfshirë. Gjatë këtij viti gjykatësit kanë pranuar në punë 266 lëndë të reja me 486 persona, që rezulton se gjykatata gjatë vitit 2014 kanë pasur në punë 655 lëndë të korrupsionit me 1306 persona. Gjatë vitit 2014 gjykatat kanë zgjidhur 229 lëndë 307 persona, ndërsa më 31 dhjetor 2014 kanë mbetur 426 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 999 persona.

IKD vlerëson se ky trend, dëshmon se nuk ka pasur vullnet të sistemit gjyqësor për të trajtuar me prioritet absolut lëndët e korrupsionit, përkundër politikave të miratuara dhe sfidave objektive që kanë me numrin e kufizuar të gjykatësve.

¹⁴⁸ *Burimi*: Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Mars 2017.

Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore (Viti 2014, 2015 dhe 2016)



Grafika 16¹⁴⁹ - Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore gjatë viteve 2014, 2015, 2016.

Në tabelën në vazhdim është paraqitur mënyra e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2016 nga GjTh në Kosovë. Në bazë të kësaj tablele vërehet trendi i efikasitetit të sistemit gjyqësor në trajtimin e këtyre lëndëve gjatë vitit 2016.

Gjykatat gjatë vitit 2016 kanë shqiptuar dënime me burg në 47 lëndë ndaj 60 personave, dënime me gjobë në 33 lëndë ndaj 41 personave, dënime me kusht në 52 lëndë ndaj 67 personave, kurse në 3 lëndë ndaj 3 personave kanë shqiptuar dënime tjera. Gjatë vitit 2016, Gjykatat në 70 lëndë ndaj 146 personave kanë shpallur aktgjykim lirues, në 31 lëndë ndaj 70 personave kanë shpallur aktgjykim refuzues, ndërsa në 48 lëndë ndaj 207 personave lëndët janë zgjidhur ndryshe.


¹⁴⁹ Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Mars 2017.

Për dallim nga viti 2016, në vitin 2015, Gjykatat kanë shqiptuar dënime me burg në 31 lëndë ndaj 41 personave, dënime me gjobë në 31 lëndë ndaj 35 personave, dënime me kusht në 33 lëndë ndaj 45 personave, kurse në 2 lëndë ndaj 2 personave kanë shqiptuar dënime tjera. Gjatë vitit 2015, Gjykatat në 32 lëndë ndaj 58 personave kanë shpallur aktgjykim lirues, në 29 lëndë ndaj 63 personave kanë shpallur aktgjykim refuzues, ndërsa në 42 lëndë ndaj 82 personave lëndët janë zgjidhur ndryshe.

Ndërsa, gjatë vitit 2014 Gjykatat kanë shqiptuar dënime me burg në 38 lëndë ndaj 35 personave, dënime me gjobë në 37 lëndë ndaj 41 personave, dënime me kusht në 43 lëndë ndaj 54 personave, kurse në 2 lëndë ndaj 2 personave kanë shqiptuar dënime tjera. Gjatë vitit 2014, Gjykatat në 41 lëndë ndaj 58 personave kanë shpallur aktgjykim lirues, në 20 lëndë ndaj 40 personave kanë shpallur aktgjykim refuzues, ndërsa në 48 lëndë me 77 persona lëndët janë zgjidhur ndryshe.

IKD pa dashur të komentoj meritën e vendimmarrjes në rastet gjyqësore të korrupsionit, vlerëson se politika ndëshkimore në këto raste është e butë dhe nuk arrin qëllimin e dënimit. Për më tepër, për këtë politikë ndëshkimore përgjegjës janë edhe Gjykata e Apelit në Prishtinë, e cila duhet të përkujdeset që të ketë politike adekuate ndëshkimore dhe të njëjtën kohë të bëj unifikimin e politikës së dënimeve.

Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore (Viti 2014, 2015 dhe 2016)



Grafika 17 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore gjatë viteve 2014, 2015, 2016.

12.KONFISKIMI I PASURIVE TË FITUARA PËRMES VEPRAVE PENALE TË KORRUPSIONIT

IKD gjatë kësaj periudhe ka monitoruar aktivitetet e prokurorëve dhe gjykatësve në zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale të korrupsionit. Nga 383 rastet e korrupsionit të monitoruara në të gjitha Gjykatat Themelore, IKD ka gjetur se prokurorët në raste shumë të rralla zbatojnë në praktikë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me kërkesat për sekuestrim apo konfiskim ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit. KKLKE gjatë raportimit të tij lidhur me aktivitetet e tij lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme, ka dështuar të ofroj informacion para KPK-së lidhur me kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë të fituar përmes veprave penale kundër korrupsionit. Ende nuk ka informacion nëse nga pasuritë e sekuestruara apo konfiskuara, ka të atillë që i takon veprave penale kundër korrupsionit edhe pse një gjë e tillë ishte kërkuar nga KPK.

Sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit, Kryeprokurori i Shtetit më 14 janar 2014, kishte nxjerr Udhëzim¹⁵⁰ lidhur me veprimet e prokurorëve në zbatimin e dispozitave ligjore në këtë fushë. Gjetjet e monitorimit të IKD-së në rastet e korrupsionit, dëshmojnë për një numër të kufizuar të rasteve kur prokurorët kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim të aseteve, në aktakuzat e paraqitura para gjykatave për korrupsion. Më poshtë janë të listuara veprimet e prokurorëve në drejtim të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të evidentuara gjatë monitorimit të IKD-së.

GJTh në FERIZAJ:

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 33 raste të korrupsionit në GjTh në Ferizaj. Në këto 33 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **2 raste**, ku prokurori ka paraqitur kërkesë për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë është paraqitur rasti konkret:

- **PKR.nr.1503/12:** Karta identifikuuese të qytetarëve, çertifikita të lëshuara nga Kryqi i Kuq.
- **PKR.nr.96/16:** Kartëmonedha në vlerë 100 euro.

¹⁵⁰ Udhëzim Nr. 26/2014, i datës 14 janar 2014, lidhur me veprimet e prokurorëve në zbatimin e dispozitave ligjore për sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Kryeprokurori i Shtetit. (Shih linkun http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.26.2014-Udhezim_lidhur_me_veprimet_e_prokuroreve_lidhur_me_sendet_e_sekuestruara.pdf). (qasur për herë të fundit me 09 tetor 2016).

GJTh në GJILAN:

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 52 raste të korrupsionit në GjTh në Gjilan. Në këto 52 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **5 raste**, ku prokurorët kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë janë paraqitur rastet konkrete:

- **PKR.nr. 27/15:** Në aktakuzën e Prokurorisë themelore në Gjilan është propozuar të lexohen si prova: Vërtetimi mbi konfiskimin e provave materiale - kartmonedhat e konfiskuara (200 euro), urdhëresa për çkyçje nga rrjeti elektrik lëshuar nga KEDS në Viti, si dhe fotodokumentacioni i kartmonedhave;
- **PKR.nr. 496/13:** Ka pasë dënim plotësues për konfiskim të sendeve: Vërtetim mbi sekuestrimin e mallrave-akcizor të dt.17.04.2013 ndaj M.M, vërtetim mbi sekuestrimin e mallrave akcizor të dt.16.04.2013 ndaj S.M, vërtetim për sekuestrimin e mallrave akcizor të dt.17.04.2013 ndaj I.S;
- **PKR.nr. 114/15:** Në aktakuzën e Prokurorisë themelore në Gjilan është propozuar të lexohet si provë: Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve-telefon - Samsung PSC 5. Poashtu, propozimi i kësaj prokurorie ka qenë që të konfiskohet karta e identitetit e Policisë së Kosovës në emër të të akuzuarit A.A., telefoni "Samsung";
- **PKR.nr.47/14:** Kartëmonedha në vlerë 50 euro;
- **PKR.nr.185/15:** Kartëmonedha në vlerë 20 euro;

GJTh në PRISHTINË:

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 160 raste të korrupsionit në GjTh në Prishtinë. Në këto 160 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **13 raste**, ku prokurorët kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë janë paraqitur rastet konkrete:

- **PKR.nr. 612/14:** Makina private e të akuzuarit e tipit Mercedes;
- **PKR.nr. 344/15:** Kërkesë në aktakuzë që të konfiskohen sendet e sekuetruara: Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve Raporti i policit i dt.08.05.2015, vërtetim mbi konfiskimin e përkohshëm të gjëseneve i dt.08.05.2015, vërtetim mbi marrjen e përkohshme të gjëseneve i dt.12.05.2015;
- **PKR.nr. 341/15:** Kundër të pandehurit I.H PSRK ka propozuar:-KONFISKIMI i automjetit të markës Audi Q7, me targa 01-900FG, prodhuar në vitin 2008 në vlerë prej 37.000,00€, veturën e markës VW Golf me targa 01-326-FP, prodhuar në vitin 2009 në vlerë prej 12.500€ dhe një veturë tjetër e markës VW Golf me targa 01-421-FL, e prodhuar në viti 2009, në vlerë prej 16.800,00€ dhe parat në shumë

prej 11.000,00€, si dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprave penale; - Kundër të pandehurit Skender Canolli KONFISKIMI i automjetit e markës VW Passat, me targa 01-714-FL, prodhuar në vitin 2008, në vlerë prej 20.000,00€, parat në shumë prej 10.560,00 Franga zvicerane, 2.600,00\$ amerikan dhe 1.880,00€, si dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprave penale; - Kundër të pandehurit Mërgim Shala KONFISKIMI i banesës në lagjën "Kalabria" Lamela 2, kati II, banesa nr. 07 me sipërfaqe prej 76.3m², në shumë prej 38.150,00€; si dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprave penale; si dhe ARMËT: nga i pandehuri Ismet Haliti-Pistoleta e markës CZ.99 e kalibrit 9mm me nr.121623 më një karikatorë pa fishek dhe nga i pandehuri Skender Canolli-Pistoletë e markës Broving e kalibrit 9mm, me një karikator me tetë fishekë dhe një Pushkë Karabinë me nr.serik 85269, prodhim Crvena Zastava- Kragujevc, e kalibrit 8x57mm, si dhe njëzet e dy fishek të kësaj pushke.

Sendet e sekuestruara:

Sendet e sekuestruara nga i pandehuri I.H: a. 11,000.00€ (njëmbëdhjetë mijë euro), 22 kartëmonedha 500€; Vetura VW "Golf", i prodhuar në vitin 2009, me ngjyrë të zezë metalike, me tabela të regjistrimit 01-326-FP, ID nr.

ËVËZZZ1KZP453134, i regjistruar në emër të I.H; Vetura VË "Golf", e prodhuar në vitin 2009, ngjyrë hiri, metalike, me tabela të regjistrimit 01-421-FL, ID nr.

ËVËZZZ1KZ9Ë578466, e regjistruar në emër të F.H (i biri i të pandehurit I.H); Vetura Audi Q7, me ngjyrë të zezë, me tabela të regjistrimit 01-900-FG, numri i identifikimit ËAUZZZ4L69D025641, i prodhuar në vitin 2008, i regjistruar në emër A.P, ku hetimi ka zbuluar se pronar faktik i këtij automjeti është i pandehuri I.H.

Sendet e sekuestruara nga i pandehuri S.C - 10,560CHF (dhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë franga zvicerane) - 1,880€ (një mijë e tetëqind e tetëdhjetë euro), - 2,600\$ USD (dy mijë e gjashtëqind dollar amerikan); Vetura VW "Passat", me ngjyrë të zezë metalike, me numër të regjistrimit 01-714-FL, e prodhuar në vitin 2008, ID nr. WVWZZZ3CZ9E520573, e regjistruar në emër të L.C (i biri i të pandehurit S.C)

Prona e sekuestruar nga i pandehuri M.Sh. banesa nr. 8 me sipërfaqe prej 76.3m², në lamelën 2, hyrja 1, kati 2 në lagjen Kalabria;

- **PKR.nr. 161/14:** Letra në të cilën shihet pagesa e të hollave;
- **PKR.nr. 652/15:** Sekuestrim i 5000 eurove nga të akuzuarit;
- **PKR.nr. 190/14:** Faturë 4.200 euro; Faturë 3000 euro; Faturë 3000 euro; 09.04.2013 - Vërtetim mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve: Vendim i MAPD - OJQ; Autorizimi 02.04.2010; 06.01.2010 - Vërtetim mbi marrjen e përkohshme të

gjësendeve: Licença e OJQ-së; Certifikatë e NRF; Statuti; Paragona; 02.05.2013 - Vërtetim mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve: Libri i arkës 2010; Libri i arkës 2010; 28.12.11 – Vërtetim mbi konfiskimin e gjësendeve: Një bllok (Dëftesë pagese); Një fasikëll prej 14 fletëve;

- **PKR.nr. 305/16:** Kompjuteri;
- **PKR.nr.214/13:** Konfiskimi i parave në vlerë prej 100 euro;
- **PKR.nr.243/13:** Konfiskimi i kartëmonedhës në shumën prej 10 euro;
- **PKR.nr.222/15:** Konfiskimi i kartëmonedhës në shumën prej 50 euro;
- **PKR.nr.303/16:** Marrja e përkohshme e: Kontratës VR.nr.5687/1997 e dt.28.01.1990, kontratës së shitblerjes së paluajtshmërisë e dt.20.03.2012.
- **PKR.nr.932/13:** Shtëpiza kompjuterike.
- **PKR.nr.178/16:** Konfiskimi i kartëmonedhës në shumën prej 50 euro;

GJTh në PRIZREN:

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 42 raste të korrupsionit në GjTh në Prizren. Në këto 42 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **1 rast**, ku prokurori ka paraqitur kërkesë për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë është paraqitur rasti konkret:

- **P.nr. 149/14:** Pleh artificial në sasi prej 28 ton dhe 125 thasë të peshës prej 50 kg.

GJTh në GJAKOVË:

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 30 raste të korrupsionit në GjTh në Gjakovë. Në këto 30 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **2 raste**, ku prokurorët kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë janë paraqitur rastet konkrete:

- **PKR.nr. 10/14:** Propozim për të konfiskuar 7.800 dhe 134.753.71 euro për njërin të akuzuar H.B., ndërsa për të akuzuarin tjetër Z.K., 1.835.36 euro.
- **PKR.nr. 193/15:** Shuma në vlerë prej 6,620 euro.

13. PËRZGJEDHJA E SHËNJESTRAVE TË TOP RASTEVE

Në shtator të vitit 2014, sistemi prokurorial i Kosovës kishte prezantuar Planin Strategjik për Bashkëpunim Ndërinstitucional mes Prokurorit të Shtetit dhe agjencive që zbatojnë ligjin në Kosovë në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për përzgjedhjen e Shënjestrave të Krimeve të Rënda.¹⁵¹

Objekti i PSV-ve ka qenë parandalimi, zbulimi, hetimi dhe ndjekja e veprave më të rënda, përmes koordinimit dhe harmonizimit të veprimeve të autoriteteve kompetente. Qëllimi i këtij mekanizmi ishte caktimi i 50 rasteve më të rënda në sistemin e drejtësisë në Kosovë, të cilat do të trajtohen me urgjencë nga të gjitha agjencitë që zbatojnë ligjin.

Një prej kriterëve për aplikimin e përzgjedhjes së shënjestrave është që veprat e dyshuara të tjera të rënda dhe që hetimet penale të kërkojnë një përpjekje të përbashkët të dy apo më shumë institucioneve publike, për të qenë në gjendje arrestimi i të dyshuarve, ndalimi i aktivitetit kriminal, marrja, sekuestrimi dhe konfiskimi i përfitimeve të krimit.

Me qëllim të monitorimit të rasteve të shënjestruara sipas PSV, KPK kishte ndërtuar databazën elektronike ku janë të regjistruara të gjitha rastet e shënjestruara e cila data bazë azhurnohet me informata lidhur me çdo veprim që merret nga institucionet përkatëse në hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e këtyre rasteve.

Aktualisht në data-bazë, janë evidentuar 34 raste të shënjestruara¹⁵², nga të cilat 4 (katër) raste kanë përfunduar prej të cilave në 2 (dy) raste janë pushuar hetimet, kurse 2 (dy) raste janë hudhur aktakuzat.

Nga 29 lëndë të shënjestruara që janë në punë, 4 raste janë në procedurë hetimore, kurse 25 lëndë janë me aktakuza të paraqitura në gjykata.

Prej lëndëve të paraqitura në gjykata aktualisht janë në këto faza të procedurës:

- dy lëndë nuk është caktuar shqyrtimi fillestar;
- tre lëndë është caktuar shqyrtimi fillestar;
- tre lëndë vazhdohet me shqyrtimin e dytë;
- njëmbëdhjetë lëndë janë në fazën e shqyrtimit gjyqësor;
- dy lëndë janë përfunduar në shkallën e parë
- katër lëndë janë të formës së prerë.

¹⁵¹ Miftaraj, E dhe Musliu B, Instituti i Kosovës për Drejtësi, tetor 2016, faqe 29, Luftimi i korrupsionit-Retorika në luftimin e korrupsionit, në: <http://kli-ks.org/ep-content/uploads/2016/10/1.-Retorika-ne-luftimin-e-korrupsionit-27.10.2016.pdf>

¹⁵² Burimi: Agim Maliqi, Koordinator i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për rastet e shënjestruara. Mars 2017.

Sa i përket shtrirjes territoriale në gjykata aktualisht lëndë të kësaj natyre me aktakuza të ngritura janë:

- GjTh në Prishtinë 15 lëndë (një e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë dhe një e përfunduar në shkallën e parë);
- GjTh në Prizren katër lëndë (një e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë);
- GjTh në Gjakovë dy lëndë (të përfunduara me aktgjykim të formës së prerë)
- GjTh në Gjilan dy lëndë (njëra e përfunduar në shkallë të parë);
- GjTh në Mitrovicë dy lëndë;

Nga lëndët e përfunduara, 2 lëndë kanë përfunduar në shkallë të parë, ndërsa 4 lëndë kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë. Në asnjërën prej këtyre lëndëve, nuk ka lëndë të profilit të lartë apo lëndë ku ka pasur sukses në sekuestrim apo konfiskim. Vlen të theksohet se te rastet e përfunduara me aktgjykim të formës së prerë, përfshihet rasti me nofkën "Prokurori", i cili ka të bëjë me dënimin e prokurores Vahide Badivuku.

Më poshtë janë evidentuar lëndët konkrete të shënjestruara:

"KLLOKOTI 1": (aktgjykim dënues për një vepër penale- dënim me kusht 10 muaj me periudhë të verifikimit për dy vjet, kurse aktgjykim lirues për dy vepra penale)

"KONTRATA": (aktgjykim dënues për dy persona, njëri është dënuar me gjashtë muaj burgim, kurse tjetri me dhjetë muaj burgim, aktgjykim lirues për një të akuzuar, aktgjykim refuzues për dy të akuzuar.);

Katër lëndë janë të formës së prerë:

"PROKURORI": (aktgjykim dënues për një të akuzuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite dhe dënim me gjobë 5000,00 euro, aktgjykim dënues për një të akuzuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 vit e 6 muaj, aktgjykim dënues për një të akuzuar dënim me gjobë 3000,00 euro)

"AVOKATI 1", "AVOKATI 2": (aktgjykim dënues dënim me gjobë 3000,00 euro, kurse për dy vepra tjera aktgjykim lirues);

"SUHAREKA": (aktgjykim refuzues për pesë persona pasi që Prokurori i Shtetit është tërhequr nga akuza).

14.ANEX: DËSHTIMET KONKRETE TË PROKURORËVE NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË KORRUPSIONIT - GJASHTË MUJORI I DYTË 2016

Në vijim janë paraqitur rastet e hudhjes poshtë të kallëzimeve penale në kundërshtim me dispozitat e Kodit të ri të Procedurës Penale. Për dallim prej procedurës së vjetër penale, e cila ka qenë në fuqi deri më 1 janar 2013, në procedurale e re penale janë përcaktuar afate strikte kohore për trajtimin e kallëzimeve penale. IKD ka analizuar të gjitha rastet e zgjidhura të siguruara përmes të dhënave të Mekanizmit Përcjellës si dhe akteve juridike prokuroriale të siguruara nga disa prokurori (*për periudhën 01.07.2016 – 31.12.2016*) dhe ka identifikuar shkeljet e prokurorëve sa i përket respektimit të afateve ligjore për trajtimin e kallëzimeve penale. Shkelja e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, rezulton me shkelje të të drejtave të njeriut, duke i mbajtur qytetarët si subjekte në evidencat penale të prokurorisë në rastet kur ndaj tyre nuk ka asnjë bazë që zhvillohen hetime penale. IKD gjatë analizimit të akteve juridike prokuroriale, ka identifikuar raste të parashkruara dhe shkelje të afateve ligjore për të vendosur në rastet e korrupsionit. IKD për herë të parë pas më shumë se tri vite bashkëpunim me Prokuroritë, ka marrë përgjigje negative nga disa Kryeprokurorët, të cilët nuk kanë bashkëpunuar për të ofruar aktet prokuroriale me qëllim të monitorimit dhe analizimit të respektimit të afateve ligjore nga ana e prokurorëve në rastet e korrupsionit. Përmes kësaj mbyllje të Prokurorive, krerët e tyre kanë dëshmuar mungesën e vullnetit për të rritur transparencën dhe llogaridhënien publike përmes monitorimit nga akterë të jashtëm të shoqërisë civile. Për më tepër, përmes kësaj forme të monitorimit dhe analizimit profesional të gjetjeve nga IKD, ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e llogaridhënies së prokurorëve.¹⁵³

RASTET E PARASHKRIMIT TË NDJEKJES PENALE

PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN

1.Lënda PP/I.nr.47/2016 vendosur më 15.09.2016. *Aktvendim për pushim të hetimeve*, të parashtruar nga BpB në Prishtinë. Vepra penale **“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”** nga neni 422 i KPK-së.¹⁵⁴

¹⁵³ IKD intervistë me z. Zef Prendrecaj, Drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

¹⁵⁴ Sipas aktvendimit të datës 15.09.2016, PTh në Prizren duke u bazuar në nenin 158, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të KPP-së, kishte vendosur ti pushoj hetimet për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit” nga neni 422, paragrafi.1 lidhur me paragrafin 2 të ish KPRK-së dhe veprës penale “Keqpërdorimi I autorizimeve në ekonomi” nga neni 236 paragrafi 1, me arsyetimin se ndaj të akuzuarëve ka arritur parashkrimi relative i ndjekjes penale.

PROKURORIA THEMELORE NË MITROVICË

1.Lënda me numër PP.I.nr.314/2015 vendosur më 14 shtator 2016. *Aktvendim për hudhje të kallëzimit penal*, të parashtruar nga Policia e Kosovës për veprën penale “Dhënia e ryshfetit” nga neni 344 par.1 të KPK-së¹⁵⁵

2.Lënda me numër PP.I.nr.232/2012 vendosur më 29 gusht 2016. *Aktvendim për hudhje të kallëzimit penal*, të parashtruar nga Policia e Kosovës për veprën penale “Shpërdorimi i detyres zyrtare ose autorizimit” nga neni 339 par.2 të KPK-së.¹⁵⁶

3.Lënda me numër PP.I.nr.360/2015 vendosur më 29 korrik 2016. *Aktvendim për hudhje të kallëzimit penal*, të parashtruar nga Policia e Kosovës për veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 i KPK-së; “Shpërdorimi i detyres zyrtare ose autorizimit” nga neni 339 par.1 të KPK-së; “Ushtrim i ndikimit” nga neni 345 par.1 të KPK-së; “Falsifikimi I dokumentit zyrtar” nga neni 348 par.1 të KPK-së.¹⁵⁷

RASTET E SHKELJEVE SË AFATEVE LIGJORE PËR VENDOSJE

PROKURORIA SPECIALE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Rasti me numër 43/12-pps, i parashtruar nga Qytetari, i pranuar në Prokurori me 29 shtator 2011, ku përfshihen shtatë (7) persona për veprën penale *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*. Vendimi për *hudhjen e kallëzimit penal* është marrë më 7 korrik 2016. Mirëpo në të njëjtën kohë figuron se ndaj këtij personi më 7 korrik 2016 është marrë Aktvendim pas zhvillimit të hetimeve.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 29.09.2011, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 07.07.2016. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1743 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PSRK ka shkelur këtë afat ligjor

¹⁵⁵ Sipas aktvendimit të datës 14.09.2016, PTh në Mitrovicë duke u bazuar në nenin 82 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së, kishte vendosur ta hudh kallëzimin penal për veprën penale “Dhënia e ryshfetit”, me arsyetimin se lëndën a kanë pranuar të parashkruar.

¹⁵⁶ Sipas aktvendimit të datës 28.09.2016, PTh në Mitrovicë duke u bazuar në nenin 82 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së, kishte vendosur ta hudh kallëzimin penal për veprën penale “Shpërdorimi i detyres zyrtare ose autorizimit” nga neni 339 par.2 të KPK-së, me arsyetimin se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

¹⁵⁷ Sipas aktvendimit të datës 29.07.2016, Pth në Mitrovicë duke u bazuar në nenin 82 par. 1 nënpar 1.2 të KPPK-së, kishte vendosur ta hudh kallëzimin penal për veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 i KPK-së; “Shpërdorimi i detyres zyrtare ose autorizimit” nga neni 339 par.1 të KPK-së; “Ushtrim i ndikimit” nga neni 345 par.1 të KPK-së; “Falsifikimi I dokumentit zyrtar” nga neni 348 par.1 të KPK-së, me arsyetimin se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale

meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1283 ditëve, apo 1253 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

2.Rasti me numër 120/15-PPN, e parashtruar nga Policia e Kosovës, i pranuar në Prokurori me 15 tetor 2015, ku përfshihe një (1) person për veprën penale **Keqpëdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit** është marrë më 28 nëntor 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 15.10.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllur me raport më 28.11.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PSRK ka shkëlur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 410 ditëve, apo 380 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

3.Lënda PPS.nr.89/2015 vendosur më 01 prill 2016. **Aktvendim për hudhjen e kallëzimit penal**, të parashtruar nga NJHKEK në Prishtinë. Vepra penale **Keqpëdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar**.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 31.03.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllur me raport më 01.04.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PSRK ka shkëlur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 367 ditëve, apo 337 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË

1. Rasti me numër 16/13-IPR, i parashtruar nga Agjencia Kundër Korrupsion, i pranuar në Prokurori me 31 dhjetor 2012, ku përfshihen pesë (5) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 21 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 31.12.2012, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 21.07.2016. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1359 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkëlur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1297 ditëve, apo 1267 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

2.Rasti me numër 24/13-IPR, i parashtruar nga i dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 29 nëntor 2011, ku përfshihen tre (3) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 15 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 29.11.2011, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 15.08.2016. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1620 ditë nga data e pranimin të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1322 ditëve, apo 1292 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

3.Rasti me numër 65/15-IPR, i parashtruar nga i dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 22 janar 2015, ku përfshihen tre (3) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 1 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 22.01.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 01.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 526 ditëve, apo 496 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

4.Rasti me numër 737/14-IPR, i parashtruar nga i dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 10 korrik 2014, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 11 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 10.07.2014, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 11.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 732 ditëve, apo 702 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

5.Rasti me numër 98/16-IPR-KE, i parashtruar nga Inspektorati Policor i Kosovës, i pranuar në Prokurori me 15 prill 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 13 korrik 2016.

***IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 15.04.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 13.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 89 ditëve, apo 59 ditë pas afatit të lejuar ligjor.*

6.Rasti me numër 99/16-IPR-KE, i parashtruar nga Policia e Kosovës, i pranuar në Prokurori me 19 prill 2016, ku përfshihen tre (3) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 4 korrik 2016.

***IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 19.04.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 04.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 76 ditëve, apo 46 ditë pas afatit të lejuar ligjor.*

7.Rasti me numër 30/13-IPR, i parashtruar nga Titullari i Pronës – OP të dëmtuar, i pranuar në Prokurori me 15 nëntor 2012, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 11 korrik 2016.

***IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 15.11.2012, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 11.07.2016. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1334 ditë nga data e pranimin të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1287 ditëve, apo 1257 ditë pas afatit të lejuar ligjor.*

8.Rasti me numër 724/14-IPR, i parashtruar nga Titullari i Pronës – OP të dëmtuar, i pranuar në Prokurori me 10 korrik 2014, ku përfshihen dy (2) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 15 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 10.07.2014, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 15.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 736 ditëve, apo 706 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

9.Rasti me numër 114/16-IPR-KE, i parashtruar nga Agjencia Kundër Korrupsion, i pranuar në Prokurori me 8 qershor 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 13 shtator 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 08.06.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 13.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 97 ditëve, apo 67 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

10.Rasti me numër 967/13-IPR, i parashtruar nga Agjencia Kundër Korrupsion, i pranuar në Prokurori me 3 tetor 2013, ku përfshihen tre (3) persona, 2 persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar** dhe 1 person për veprën penale **Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 6 shtator 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 03.10.2013, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 06.10.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1069 ditëve, apo 1039 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

11. Rasti me numër 667/15-IPR, i parashtruar nga i dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 24 gusht 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 22 shtator 2016.

***IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 24.09.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 22.10.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 394 ditëve, apo 364 ditë pas afatit të lejuar ligjor.*

12. Rasti me numër 114/14-IPR, i parashtruar nga Prokurori me vetëiniciativë, i pranuar në Prokurori me 3 shkurt 2013, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 7 shtator 2016.

***IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 03.02.2013, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 07.09.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1312 ditëve, apo 1282 ditë pas afatit të lejuar ligjor.*

13. Rasti me numër 898/15-IPR, i parashtruar nga Qytetari, i pranuar në Prokurori me 17 nëntor 2015, ku përfshihen tre (3) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 15 shtator 2016.

***IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 17.11.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 15.09.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 303 ditëve, apo 273 ditë pas afatit të lejuar ligjor.*

14.Rasti me numër PPN.409/11-IPR, i parashtruar nga Administrata Tatimore e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 28 tetor 2011, ku përfshihen katër (4) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 12 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 28.10.2011, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 12.07.2016. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1719 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1288 ditëve , apo 1258 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

15.Rasti me numër 419/13-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari, e pranuar në Prokurori me 15 shtator 2009, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 28 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 15.09.2009, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 28.07.2016. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 2507 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1304 ditëve , apo 1274 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

16.Rasti me numër PPN.346/15-IPR, E pranuar në kompetencë, e pranuar në Prokurori me 21 korrik 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 28 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 21.07.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 28.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 373 ditëve, apo 343 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

17.Rasti me numër PPN.109/15-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 2 mars 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale ***Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar***. Vendimi për ***hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport*** është marrë më 1 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 02.03.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 01.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 487 ditëve, apo 457 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

18.Rasti me numër PPN.110/15-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 2 mars 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale ***Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar***. Vendimi për ***hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport*** është marrë më 29 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 02.03.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 29.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 515 ditëve, apo 485 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

19.Rasti me numër PPN.506/15, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 28 tetor 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale ***Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar***. Vendimi për ***hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport*** është marrë më 27 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 28.10.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 27.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 273 ditëve, apo 243 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

20.Rasti me numër PPN.967/13-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 8 nëntor 2013, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 22 korrik 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 08.11.2013, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 22.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 987 ditëve, apo 957 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

21.Rasti me numër PPN.4/13-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari , e pranuar në Prokurori me 14 janar 2013, ku përfshihen dy (2) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë 25 gusht 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 14.01.2013, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 25.08.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1319 ditëve, apo 1289 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

22.Rasti me numër 110/16-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 1 mars 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë 17 gusht 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 01.03.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 17.08.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 169 ditëve, apo 139 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

23.Rasti me numër 73/16-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 18 qershor 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 19 gusht 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 18.06.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 19.08.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 428 ditëve, apo 398 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

24.Rasti me numër PPN.190/15-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 7 prill 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Shmangja nga tatimi**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 30 gusht 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 07.04.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit pena/mbyllje me raport më 30.08.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 511 ditëve, apo 481 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

25.Rasti me numër PPN.228/15-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 16 korrik 2012, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 25 gusht 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 16.07.2012, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 25.08.2016. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1504 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1335 ditëve, apo 1305 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

26.Rasti me numër PPN.232/16-IPR-K, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 27 qershor 2016 ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 17 gusht 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 27.06.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 17.08.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 51 ditëve, apo 21 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

27.Rasti me numër PPN.571/15-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 25 nëntor 2015 ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Marrje rryshfeti**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 30 gusht 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 25.11.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 30.08.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 274 ditëve, apo 244 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

28.Rasti me numër PPN.629/15-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 15 dhjetor 2015 ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 15 gusht 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 15.12.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 15.08.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 244 ditëve, apo 214 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

29. Rasti me numër PPN.136/15-IPR, i parashtruar nga Qytetari, e pranuar në Prokurori me 1 janar 2015 ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 15 gusht 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 01.01.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 15.08.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 592 ditëve, apo 562 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

30. Rasti me numër PPN.27/16-IPR, i parashtruar nga Qytetari, e pranuar në Prokurori me 21 janar 2016 ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 24 gusht 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 21.01.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 30.08.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 216 ditëve, apo 186 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

31. Rasti me numër 2717/09-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari, e pranuar në Prokurori me 11 dhjetor 2009, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Përdorimi i paautorizuar i pasurisë**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë më 16 shtator 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 11.12.2009, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 16.10.2016. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 2471 ditë nga data e pranimit të njëjtë. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1354 ditëve, apo 1324 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

32.Rasti me numë PPN.260/16-IPR-K, i parashtruar nga I dëmtuari, e pranuar në Prokurori me 28 korrik 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë 7 shtator 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 28.07.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 07.10.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 71 ditëve, apo 41 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

33.Rasti me numër PPN.263/15-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari, e pranuar në Prokurori me 10 prill 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë 13 shtator 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 10.04.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 13.09.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 522 ditëve, apo 492 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

34.Rasti me numër PPN.183/16-IPR-K, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 22 prill 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë 8 shtator 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 22.04.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 08.09.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 505 ditëve, apo 475 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

35.Rasti me numër PPN.234/16-IPR-K E, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 30 qershor 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë 5 shtator 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 30.06.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 05.09.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 67 ditëve, apo 37 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

36.Rasti me numër PPN.252/16-IPR-K E, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 22 korrik 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë 27 shtator 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 22.07.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 27.09.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 62 ditëve, apo 32 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

37.Rasti me numër PPN.258/16-IPR-K E, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 26 korrik 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë 8 shtator 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 26.07.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 08.09.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 44 ditëve, apo 14 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

38.Rasti me numër PPN.264/16-IPR-K E, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 5 gusht 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë 9 shtator 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 05.08.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 09.09.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 35 ditëve, apo 5 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

39.Rasti me numër PPN.38/16-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, e pranuar në Prokurori me 22 janar 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal/është mbyllur me raport** është marrë 27 shtator 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 22.01.2016, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal/mbyllje me raport më 27.07.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 216 ditëve, apo 186 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

40.Rasti me numër 291/12-IPR, i parashtruar nga Agjencia Kundër Korrupsion, i pranuar në Prokurori me 24 prill 2014, ku përfshihet një (1) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 10 tetor 2016 .

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 24.04.2014, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 10.10.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëjë brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 900 ditëve, apo 870 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

41. Rasti me numër 694/13-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 25 korrik 2013, ku përfshihet një (1) persona për veprën penale **Dhënie e ryshfetit**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 27 tetor 2016.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 25.07.2013, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 27.10.2016. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1190 ditëve , apo 1160 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

42.Rasti me numër 145/11-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, i pranuar në Prokurori me 25 janar 2011, ku përfshihet një (1) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 21 tetor 2016.

